

**Qeveria e Republikës së Kosovës**

**Ministria e Drejtësisë**

**Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë**

**2016-2019**

**(Drejtësi dhe Punë të Brendshme)**

Maj, 2014

## PËRMBAJTJA

<b>1.</b>	<b>Shkurtesat</b> -----	<b>5</b>
<b>2.</b>	<b>Hyrje e përgjithshme</b> -----	<b>7</b>
<b>3.</b>	<b>Qëllimi</b> -----	<b>9</b>
<b>4.</b>	<b>Metodologjia</b> -----	<b>11</b>
<b>5.</b>	<b>Sfondi Analitik</b> -----	<b>12</b>
<b>5.1.</b>	Çështjet e drejtësisë -----	<b>14</b>
<b>5.2.</b>	Çështjet e punëve të brendshme -----	<b>20</b>
<b>5.3.</b>	Çështjet e qasjes në drejtësi -----	<b>27</b>
<b>6.</b>	<b>Lidhja me dokumente strategjike</b> -----	<b>30</b>
<b>6.1.</b>	Lidhja me DPPA 2014-2016 dhe KASH 2014-2016 -----	<b>30</b>
<b>6.2.</b>	Lidhja me Strategjinë për Integrim Evropian– Kosova 2020 -----	<b>30</b>
<b>6.3.</b>	Lidhja me Dokumentin Strategjik Shumëvendësh -----	<b>30</b>
<b>6.4.</b>	Lidhja me Strategjinë e BE-së për zgjerim dhe sfidat kryesore 2012-2013 -----	<b>30</b>
<b>6.5.</b>	Lidhja me Dokumentin Strategjik Vendor -----	<b>31</b>
<b>6.6.</b>	Lidhja me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2013 -----	<b>31</b>
<b>7.</b>	<b>Qasja strategjike</b> -----	<b>32</b>
<b>8.</b>	<b>Vizioni</b> -----	<b>34</b>
<b>9.</b>	<b>Misioni</b> -----	<b>34</b>
<b>10.</b>	<b>Objektivat Strategjike</b> -----	<b>34</b>
<b>10.1.</b>	<b>Objektivi strategjik 1:</b> Përmirësimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit, llogaridhënies dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë -----	<b>34</b>
<b>10.2.</b>	<b>Objektivi strategjik 2:</b> Përmirësimi i parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë trafikimit me qenie njerëzore dhe narkotikë, krimit ekonomik dhe shpërlarjes së parave, kontrabandës me armë, krimit kibernetik dhe terrorizmit -----	<b>36</b>
<b>10.3.</b>	<b>Objektivi Strategjik 3:</b> Përmirësimi i qasjes në drejtësi -----	<b>38</b>
<b>11.</b>	<b>Programimi i asistencës</b> -----	<b>41</b>
<b>11.1.</b>	Kontributet e donatorëve dhe misioneve ndërkombëtare -----	<b>41</b>
<b>11.1.1.</b>	BE -----	<b>41</b>
<b>11.1.2.</b>	EULEX -----	<b>42</b>
<b>11.1.3.</b>	GIZ -----	<b>42</b>
<b>11.1.4.</b>	Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë -----	<b>42</b>
<b>11.1.5.</b>	OSBE -----	<b>42</b>
<b>11.1.6.</b>	SWISS International Cooperation -----	<b>42</b>
<b>11.1.7.</b>	UNDP -----	<b>43</b>
<b>11.1.8.</b>	UNICEF -----	<b>43</b>
<b>11.1.9.</b>	UNOPS -----	<b>43</b>
<b>11.1.10.</b>	USAID -----	<b>43</b>
<b>11.1.11.</b>	ICITAP -----	<b>44</b>
<b>12.</b>	<b>Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi</b> -----	<b>45</b>
<b>13.</b>	<b>Indikatorët e progresit</b> -----	<b>47</b>

<b>14.</b>	<b>Supozimet dhe rreziqet</b> -----	<b>49</b>
<b>15.</b>	<b>Qëndrueshmëria</b> -----	<b>50</b>
<b>16.</b>	<b>Shtojcat</b> -----	<b>51</b>
<b>16.1.</b>	Tabela e projekt-ideve sipas prioriteteve, buxhetit dhe sekuencimit -----	<b>51</b>
<b>16.2.</b>	Plani i Veprimit me përshkrimin e projekt-ideve -----	<b>55</b>
<b>16.2.1.</b>	<b>Përshkrimi i projekt-ideve të Objektivit Strategjik 1</b> -----	<b>55</b>
1.1.	Mbështetje për Prokurorinë Speciale të Kosovës -----	<b>55</b>
1.2.	Përforcimi i kapaciteteve në hartimin e politikave dhe legjislacionit si dhe monitorimin e zbatimit të tyre -----	<b>57</b>
1.3.	Përforcimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit gjyqësor në Kosovë -----	<b>59</b>
1.4.	Mbështetje për zhvillim të mëtejshëm të profesioneve të lira ligjore në Kosovë -----	<b>61</b>
1.5.	Avancimi i arsimit ligjor 1 -----	<b>62</b>
1.6.	Strategjia për sektorin e Sundimit të ligjit -----	<b>64</b>
1.7.	Strategji gjithëpërfshirëse për Teknologji Informativ (IT) dhe Interoperabilitet (Ndërveprim) -----	<b>65</b>
1.8.	Përmirësimi i drejtësisë civile -----	<b>67</b>
1.9.	Përmirësimi i çështjeve pronësore -----	<b>68</b>
1.10.	Përmirësimi i infrastrukturës fizike në sistemin e drejtësisë -----	<b>70</b>
1.11.	Rishikimi gjithëpërfshirës i drejtësisë penale -----	<b>71</b>
1.12.	Përmirësimi i kapaciteteve për matjen e performancës dhe mbikqyrjen e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve -----	<b>73</b>
1.13.	Arsimi ligjor 2: Mbështetje për Fakultetin Juridik -----	<b>74</b>
1.14.	Rritja e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar -----	<b>77</b>
1.15.	Regjistrimi dhe menaxhimi i të dhënave penale -----	<b>76</b>
1.16.	Mbështetje për mekanizmat mbikëqyrës në sistemin e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme -----	<b>78</b>
<b>16.2.2.</b>	<b>Përshkrimi i projekt-ideve të Objektivit Strategjik 2</b> -----	<b>81</b>
2.1.	Arsimi Ligjor 3: Përforcimi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike-----	<b>81</b>
2.2.	Përforcimi i menaxhimit efektiv të migracionit dhe azilit në Kosovë -----	<b>83</b>
2.3.	Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda -----	<b>85</b>
2.4.	Rritja e llogaridhënies dhe parandalimi i keqpërdorimit të parasë publike në institucionet e Kosovës -----	<b>86</b>
2.5.	Përmirësimi i sistemit penitenciar (shërbimet korrektuese dhe sprovuese) -----	<b>88</b>
2.6.	Avancimi i mbrojtjes së dëshmitarëve -----	<b>91</b>
2.7.	Përmirësimi i Sistemit IT të Menaxhimit të Kufirit -----	<b>92</b>
2.8.	Mbështetje për parandalimin dhe luftimin e krimeve komplekse (krimet ekonomike, financiare, ekonomia joformale, krimi kibernetik, shpërlarja e parave, terrorizmi) -----	<b>94</b>
2.9.	Avancimi i shërbimeve forenzike -----	<b>96</b>
2.10.	Përmirësimi i sistemit të emergjencave -----	<b>97</b>

2.11.	Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore -----	99
2.12.	Përmirësimi i infrastrukturës së IT-së në Policinë e Kosovës -----	100
2.13.	Përmirësimi i infrastrukturës fizike të Policisë së Kosovës -----	102
2.14.	Avancimi i shërbimeve doganore -----	102
2.15.	Avancimi i sigurisë së dokumenteve personale dhe mbrojtjes së të dhënave personale -----	104
<b>16.2.3.</b>	<b>Përshkrimi i projekt-ideve të Objektivit Strategjik 3 -----</b>	<b>107</b>
3.1.	Ngritja e kapaciteteve monitoruese dhe avokuese të shoqërisë civile -----	107
3.2.	Përmirësimi i komunikimit brenda-institucional, ndërinstitucional dhe atij me shoqërinë civile dhe mediat-----	108
3.3.	Implementimi i plotë i Konventës për të Drejtat e Njeriut për interesin më të mirë të fëmijëve -----	109
3.4.	Parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje -----	111
3.5.	Parandalimi i dhunës në shkolla -----	112
3.6.	Mbështetje për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të krimit -----	114
3.7.	Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe keqpërdorimi seksual -----	115
3.8.	Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna -----	116
3.9.	Mbështetje për përkthyesit, interpretët dhe gjuhëtarët ligjorë -----	118
<b>16.3.</b>	<b>Matrica e Kornizës Logjike -----</b>	<b>120</b>
<b>16.4.</b>	<b>Dokumentet e konsultuara -----</b>	<b>123</b>
<b>16.5.</b>	<b>Webfaqet e konsultuara -----</b>	<b>125</b>

## 1. SHKURTESAT

<b>AAPSK</b>	Agjencioni për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar/Konfiskuar
<b>AKK</b>	Agjencia Kundër Korrupsionit
<b>AKP</b>	Agjencia e Kosovare e Privatizimit
<b>AKSP</b>	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
<b>AME</b>	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
<b>AMRSB</b>	Agjencia për Menaxhimin e Rrezatimit dhe Sigurisë Bërthamore
<b>ANJF</b>	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
<b>APK</b>	Agjencia e Pronave të Kosovës
<b>ARBK</b>	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare
<b>ARC</b>	Agjencia për Regjistrim Civil
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>CEPEJ</b>	Komisioni Evropian për Efiçencën në Drejtësi
<b>CRC</b>	Convention on the Rights of the Child
<b>CSP</b>	Country Strategy Paper
<b>DK</b>	Dogana e Kosovës
<b>DPPA</b>	Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016
<b>EULEX</b>	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
<b>FAK</b>	Forcat e Armatosura të Kosovës
<b>GIZ</b>	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
<b>ICITAP</b>	International Criminal Investigative Training Assistance Program
<b>IGJK</b>	Instituti Gjyqësor i Kosovës
<b>IPA</b>	Instrumenti i Para-Anëtarësimit
<b>IPH</b>	Instituti për Planifikim Hapësinor
<b>KASH</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KP</b>	Kodi Penal
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>KPP</b>	Kodi i Procedurës Penale
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
<b>MCSP</b>	Multi Country Strategy Paper
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MIK</b>	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

<b>NJIF</b>	Njësia për Inteligjencë Financiare
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>SIME</b>	Sistemi i Integruar për Menaxhimin e Emergjencave
<b>SHKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>SHSP</b>	Shërbimi Sprovues i Kosovës
<b>UNDP</b>	United Nations Development Programme
<b>UNICEF</b>	United Nations Children's Fund
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
<b>UNOPS</b>	United Nations Office for Project Services
<b>USAID</b>	United States Agency for International Development

## **2. HYRJE E PËRGJITHSHME**

Që nga shpallja e pavarësisë, janë ndërmarrë një sërë reformash për konsolidimin e institucioneve dhe shtetit të Kosovës. Prej tyre, njëra ndër reformat më komplekse të ndërmarra është ajo e Sektorit të Sundimit të Ligjit në përgjithësi dhe e sistemit gjyqësor në veçanti. Dihet se procesi i reformimit dhe përforcimit të sektorit të Sundimit të Ligjit në Kosovë ka qenë i ndërlikuar nëse shihet në horizontin kohor prej pasluftës e deri te shpallja e pavarësisë dhe nga pavarësimi i Kosovës e deri më sot.

Siç dihet, prej vitit 1999 deri në 2008 sektori i Sundimit të Ligjit është drejtuar kryesisht prej UNMIK-ut, ndërsa nga 2008 e deri më sot udhëhiqet nga Institucionet e Kosovës, me përjashtim të disa përgjegjësive të kufizuara ekzekutive të ushtruara nga EULEX-i. Përpos këtyre zhvillimeve, Sundimi i Ligjit nuk ka mundur të shtrihet në masën e duhur në pjesën veriore të Kosovës. Kjo sfidë e ka përcjellur këtë sektor përgjatë këtyre viteve, çështje këto të adresuara gjatë Dialogut Kosovë-Serbi i ndërmjetësuar prej BE-së. Prandaj, për shkak të këtyre ndryshimeve, lëvizjeve të përgjegjësive dhe sfidave nuk ka mundur të arrihet niveli i dëshirueshëm i progresit në drejtim të forcimit të këtij sektori.

Ashtu sikurse vendet e rajonit, edhe Kosova gëzon perspektivë evropiane. Në kuadër të kësaj, Kosova është duke kaluar nëpër dy procese të rëndësishme të Integritimit Evropian (IE). Në njërin anë është negociimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), ndërsa në anën tjetër është Procesi i Liberalizimit të Vizave me BE-në. Krahas këtyre, Institucionet e Kosovës kanë qenë dhe janë përfituese direkte të asistencës së BE-së përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA) I dhe II për periudhën 2007-2020.

Përpos BE-së, sektori i Sundimit të Ligjit është mbështetur vazhdimisht nga një sërë donatorësh tjerë bilateral dhe multilateral. Dinamikat e donatorëve dhe Institucioneve të Kosovës jo çdo herë janë përputhur, dhe si rrjedhojë efektet e asistencës kanë mundur të jenë më të mëdha. Në kuadër të këtij angazhimi, kanë filluar reformat në sistemin e drejtësisë, çështjet e brendshme dhe qasjes në drejtësi. Reformat kryesisht konsistojnë në hartimin e politikave dhe ligjeve si dhe në krijimin e mekanizmave institucional për një funksionim më të mirë të rendit dhe ligjit në Kosovë. Kjo Strategji për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit 2016-2019 u atribuohet të gjithë donatorëve që mbështesin këtë sektor, sikundër që u lë donatorëve mundësinë e hapur që në bashkëpunim me institucionet e Sundimit të Ligjit të mbështesin projekte tjera që mund të mos jenë pjesë e kësaj strategjie.

Për të përcjellur dinamikën e procesit të Integritimit Evropian, proceset reformatore të sektorit të sundimit të ligjit kanë nevojë për asistencë të mëtejme ndërkombëtare. Asistenca kryesisht nevojitet në përmirësimin, harmonizimin dhe avancimin e politikave dhe legjislacionit, si dhe në përforcimin e mëtejme të mekanizmave institucional konform praktikave më të mira të BE-së. Duke parë domosdoshmërinë e forcimit të mëtejme të

Sundimit të Ligjit, Institucionet e Kosovës janë dhe do të jenë vazhdimisht të përkushtuara për të shfrytëzuar asistencën ndërkombëtare në mënyrën më të mirë të mundshme, sepse kështu do të avancohet në procesin e Integritit Evropian deri në anëtarësimin e plotë të Kosovës në BE, rrugë kjo e cila do të kushtojë shumë mund, resurse dhe përgjegjësi shtetërore.



### 3. QËLLIMI

Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë 2016-2019 definon qasjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës ndaj programimit shumëvjeçar për asistencë ndërkombëtare, bashkërendimit të donatorëve dhe mekanizmave bashkëpunues si dhe masave prioritare për përforcimin e sektorit të Sundimit të Ligjit, me fokus në drejtësi, dhe punë të brendshme.<sup>1</sup> **Objektiva e përgjithshme** e kësaj strategjie është përmirësimi i kushteve për sundim të qëndrueshëm të ligjit dhe, rrjedhimisht, avancimi në procesin e Integritit Evropian përmes planifikimit, programimit dhe përmirësimit të efektivitetit të asistencës së donatorëve në përputhje me prioritetet strategjike nacionale.

Kjo strategji është bazuar në prioritetet strategjike nacionale dhe objektivat afatmesme të dala nga to, duke përbërë kështu bazën kryesore për zhvillimin e projekteve të përshtatshme për financim nga komuniteti i donatorëve, dhe duke mos përfshirë projektet që do të realizohen ekskluzivisht nga buxheti vetanak i secilit institucion. Qëllimi specifik i kësaj strategjie është që të kontribuohet në implementimin e reformave në fushën e drejtësisë, punëve të brendshme dhe qasjes në drejtësi. Prandaj, ky dokument do të shfrytëzohet si instrumenti kryesor për lidhjen e kontributit të donatorëve me prioritetet nacionale në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme.

Duke marrë parasysh ristrukturimin e të prezencës së BE-së në fushën e Sundimit të Ligjit në Kosovë, përkatësisht mandatin e ri të EULEX-it, i cili do të përfundojë më 15 qershor 2016, kjo strategji bazohet në indikacionin se institucionet e Kosovës do të kenë përgjegjësi të plota në fushën e Sundimit të Ligjit pas vitit 2016. Parlamenti i Kosovës më 23 prill 2014 ka miratuar Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës dhe BE-së për vazhdimin e mandatit të ristrukturuar të EULEX-it deri në qershor 2016. Natyrisht se pas përfundimit të mandatit të EULEX-it kërkohet asistencë financiare, e cila do të plotësonte zbrastësimin dhe nevojat në fushën e Sundimit të Ligjit në Kosovë. Për më tepër, qëllimi i këtij dokumenti është që të krijohet një strategji sektoriale ashtu siç kërkohet edhe nga politikat e BE-së, në të cilën do të paraqiten nevojat kryesore për asistencë në fushën e Sundimit të Ligjit.

Për më tepër hartimi i kësaj strategjie ka rrjedhur nga takimet e Dialogut të Strukturuar të Sundimit të Ligjit mes BE-së dhe Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë<sup>2</sup>. Megjithatë, kjo strategji u mundëson të gjithë donatorëve në sektorin e Sundimit të Ligjit që të ofrojnë

---

<sup>1</sup> Kjo strategji e për asistencë në Sektorin të Sundimit të Ligjit në Kosovë përfshinë fushat e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Institucionet kryesoret në këto dy fusha janë: Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Policia e Kosovës (PK), Dogana e Kosovës (DK), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Gjykatat, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Prokuroritë, Instituti Gjyqësor Kosovës (IGJK), Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), etj. Në kuadër të këtyre institucioneve hynë një sërë institucioneve të varësisë të cilat poashtu janë pjesë e rendit dhe ligjit në Kosovë.

<sup>2</sup> Shih Konkluzionet e Takimit të Dialogut të Strukturuar për Sundimin e Ligjit në Kosovë, 16 Janar 2014

asistencën e tyre në përputhje me nevojat e Kosovës për zhvillimin dhe avancimin e këtij sektori kompleks.

Kriteret e përdorura për identifikimin e prioriteteve për asistencë ndërkombëtare për periudhën 2016-2019 janë si më poshtë: relevanca dhe përputhja e projekteve me synimet e përpiluara në dokumentet strategjike të Qeverisë; përputhja me reformat e deritanishme dhe kontributi i tyre në realizimin e objektivave strategjike dhe reformatore; bashkërendimi dhe konsultimi me partnerët kryesorë, përfshirë këtu komunitetin e donatorëve, shoqërinë civile, prioritetet e BE-së dhe donatorëve tjerë multilateral e bilateral; sinergjia në mes të projekteve; mësimet nga e kaluara, përfshirë këtu përvojat me projekte të suksesshme dhe ato më pak të suksesshme; potenciali i projekteve për të arritur rezultate konkrete dhe të prekshme; si dhe kapacitetet institucionale për të absorbuar fonde të donatorëve.

Për secilën fushë, dokumenti paraqet prioritetet e identifikuara për asistencë të jashtme për periudhën 2016-2019 si dhe një sërë masash përmes të cilave është paraparë të arrihen prioritetet përkatëse. Masat e parapara janë të përqendruara në përmirësimin, harmonizimin dhe avancimin e kornizës ligjore sipas praktikave më të mira të BE-së, implementimin e strategjive nën-sektoriale, aktivitetet për ndërtim dhe zhvillim insitucional, duke përfshirë përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të reja të resurseve njerëzore, përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe asaj të IT-së, përmirësimin e bashkëpunimit brenda-institucional, ndër-institucional dhe ndërkombëtar si dhe forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile. Këto masa janë paraparë të shërbejnë si bazë për identifikimin e projekteve që do të mund të financoheshin nga ndihma e jashtme gjatë periudhës 2016-2019.

Ky dokument përfshin, ndër të tjera, edhe asistencën e nevojshme për përforcimin e Sundimit të Ligjit në pjesën veriore të Kosovës, përkatësisht ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të rendit dhe ligjit në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, e paraparë në marrëveshjen e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Zbatimi i kësaj strategjie do të monitorohet e vlerësohet në baza të rregullta dhe sipas nevojës dhe zhvillimeve në sektorin e Sundimit të Ligjit do të rishikohet në baza vjetore në mënyrë që të reflektojë progresin dhe rezultatet e arritura, fondet e ofruara për financimin e projekteve prioritare, si dhe programet/projektet e reja prioritare.

#### **4. METODOLOGJIA**

Procesi i hartimit të kësaj strategjie ka qenë gjithëpërfshirës, duke përfshirë institucionet kryesore të Sundimit të Ligjit në Kosovë. Gjatë muajit mars dhe prill 2014, janë mbajtur një sërë takimesh me institucionet e Sundimit të Ligjit për të siguruar të dhënat e nevojshme për hartimin e kësaj strategjie. Në mungesë të një strategjie paraprake e cila do të pasqyronte progresin, mësimet e nxjerra dhe sfidat për të ardhmen në sektorin e Sundimit të Ligjit, janë analizuar të gjitha dokumentet strategjike relevante të Kosovës, të BE-së si dhe dokumente tjera ndërkombëtare si dhe analiza të OJQ-ve që vlerësojnë progresin dhe sfidat e Sundimit të Ligjit në Kosovë.

Pas analizimit të dokumenteve, institucionet e Sundimit të Ligjit kanë paraqitur projeksionet e tyre strategjike deri në vitin 2016 si dhe nevojat e tyre për asistencë për periudhën 2016-2019. Të gjitha këto gjetje fillestare janë elaboruar, analizuar dhe harmonizuar nëpër punëtori, grupe punuese, si dhe në intervista pasuese me përfaqësues të institucioneve kryesore të Sundimit të Ligjit në Kosovë, përfshirë shoqërinë civile dhe aktorë ndërkombëtarë të cilët veprojnë në Kosovë.

Pastaj, të gjitha rekomandimet e dala nga procesi konsultativ gjithëpërfshirës me aktorët relevant vendorë e ndërkombëtarë të këtij sektori janë përfshirë në tekstin përfundimtar të këtij dokumenti. Rrjedhimisht, projektet e dala nga kjo strategji janë ideuar dhe priorizuar në bazë të konsultimit gjithëpërfshirës, analizës së përparësive dhe mangësive të tyre, potencialit të tyre për sinergji, si dhe efektit të tyre në arritjen e rezultateve konkrete në sektorin e Sundimit të Ligjit, të matura përmes indikatorëve të mirëdefinuara dhe realist të kësaj strategjie.

Të gjitha projekt-idetë e dizajnuara në Planin e Veprimit të kësaj strategjie janë priorizuar, buxhetuar dhe sekuencuar. Sekuencimi i projekt-ideve është bërë në përputhje me kapacitetet absorbuese të institucioneve të Sundimit të Ligjit. Pra, qëllimi i sekuencimit është që projekt-idetë të kenë lidhje logjike mes vete ashtu që edhe implementimi i tyre të realizohet në mënyrë kronologjike. Të gjitha projekt-idetë kanë të përcaktuara kostot e përafërta, të cilat varësisht prej analizave dhe nevojave mund të ndryshojnë.

Projekt-idetë në këtë strategji janë gjithëpërfshirëse, duke lënë mundësinë e hapur që disa, ose shumica prej këtyre projekt-ideve, të mund të realizohen përmes një apo më shumë projekteve më specifike.

## 5. SFONDI ANALITIK

Përkundër progresit të arritur deri më tani, Kosova, sikurse edhe vendet e tjera të rajonit, vazhdon të përballet me vështirësi në sektorin e Sundimit të Ligjit, përkatësisht me mangësi të theksuara në sistemin gjyqësor, çështje të brendshme dhe qasje në drejtësi. Raportet e ndryshme ndërkombëtare dhe dokumentet strategjike nacionale vënë në pah nevojën për përkushtim shtetëror proaktiv në përmirësimin e efikasitetit të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit në përgjithësi, e veçanërisht në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Duke patur parasysh se zhvillimi socio-politik dhe ekonomik, marrëdhëniet me BE-në si dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës ndikohen thelbësisht nga përparimi në fushën e Sundimit të Ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës, me ndihmën e BE-së dhe partnerëve tjerë ndërkombëtarë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në reformimin dhe përforcimin e sektorit Sundimit të Ligjit në tërësinë e tij.

Në përputhje me nevojat e Kosovës për sektorin e Sundimit të Ligjit, dhe me kërkesë të institucioneve të Kosovës, më 9 dhjetor 2008 filloi Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), duke shënuar kështu misionin më të madh civil të jashtëm të BE-së. Krahas progresit të arritur në fushën e Sundimit të Ligjit, edhe misioni i EULEX-i në vitin 2012 ishte rikonfiguruar, ndërkohë që mandati i është vazhduar deri në qershor të vitit 2014. Me këtë mandat, misioni i EULEX-it operon me dy divizione: i) Divizioni Ekzekutiv, i cili punon në mandatin ekzekutiv të misionit; dhe ii) Divizioni i Fuqizimit, i cili përqendrohet në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e autoriteteve të Kosovës.

Së fundi, duke marrë parasysh progresin e arritur nga institucionet vendore gjatë kësaj periudhe, është vërejtur nevoja për rishikim të prezencës së BE-së në fushën e Sundimit të Ligjit në Kosovë. Dhe si rezultat i marrëveshjes në mes të BE-së dhe Republikës së Kosovës (2014) është vendosur që misioni i EULEX-it të vazhdojë fushëveprimin në Kosovë edhe për 2 vite, përkatësisht deri më 15 qershor 2016, me mandat të ristrukturuar, pra duke transferuar një numër të madh të përgjegjësive tek institucionet vendore. Kjo është bërë me qëllim që të përfundohen rastet që janë në proces dhe të realizohet transferimi i plotë i përgjegjësive tek institucionet vendore.

Për më shumë, me marrëveshjen në fjalë është paraparë krijimi i një Gjykate Speciale për gjykimin e personave potencialisht të akuzuar për veprat e aluduara në raportin e Këshillit të Evropës (CoE Report AS/Jur (2010) 46). Gjykata Gjykata Speciale do të ketë ulësen në Kosovë dhe do të ushtrojë veprimtarinë gjyqësore nën Juridiksionin e Kosovës dhe në përputhje me ligjet në fuqi. Gjykata në fjalë do të funksionojë në kuadër të sistemit të Drejtësisë në Kosovë por do të menagjohet nga Misioni i BE-së në Kosovë.

Ashtu sikurse vendet e tjera të rajonit, edhe Kosova që nga paslufta e deri me tani ka qenë përfituese e asistencës së BE-së dhe donatorëve tjerë. Mirëpo, duke patur parasysh kompleksitetin e sektorit të Sundimit të Ligjit dhe numrin e madh të projekteve në këtë sektor, konsiderohet se efektet dhe ndikimi i tyre kanë mundur të jenë më të mëdha. Sipas një vlerësimi të Gjykatës së Auditorëve të BE-së, të ndërmarrë në 2012, është theksuar se “asistenca e BE-së në fushën e Sundimit të Ligjit nuk ka qenë sa duhet efektive.... dhe në përgjithësi progresi në fushën e Sundimit të Ligjit ka qenë i ngadalshëm, sidomos sa i përket luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar mbi të gjitha në veri të Kosovës” (EU Court of Aditors Special Report, 2012). Me përfundimin e prezencës së misionit të BE-së në sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë nga viti 2016 e tutje, institucionet e Kosovës konsiderojnë që asistenca e BE-së duhet të përqendrohet në fushat ku institucionet e Kosovës do të sipërmarrin përgjegjësitë nga misioni i EULEX-it në Kosovë.

Në procesin e Integritimit Evropian, Qeveria e Republikës së Kosovës në maj të vitit 2012 ka filluar Dialogun e Strukturuar për Sundimin e Ligjit. Ky dialog është forumi i nivelit më të lartë dhe ka si qëllim këto fusha prioritare: i) definimin e prioriteteve për reforma në fushën e Sundimit të Ligjit; dhe ii) mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rregullt të progresit të Kosovës drejt përmbushjes së këtyre prioriteteve. Në kuadër të këtij forumi janë formuar nën-komisionet për Drejtësinë dhe për Punët e Brendshme. Bordi i Përbashkët për Koordinim në fushën e Sundimit të Ligjit është poashtu forum i një niveli më të ulët që bën koordinimin e veprimeve të përbashkëta mes EULEX-it dhe Institucioneve të Kosovës në fushën e rendit dhe ligjit dhe i cili shërben si forum përkrahës për Dialogun e Strukturuar për Sundimin e Ligjit.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës ka pasur përgjithësisht përparime në hartimin e politikave dhe ligjeve të cilat në masë të konsiderueshme janë në linjë me praktikën më të mira të BE-së. Por, zbatimi i legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar (përfshirë të gjitha llojet e krimeve të rënda), sikurse dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e Sundimit të Ligjit, vazhdojnë të mbeten sfida dhe pengesë për zhvillimin ekonomik dhe mbarëshoqëror të Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës, e përkrahur nga bashkësia ndërkombëtare, është e përkushtuar që të përmirësojë infrastruktuën ligjore e institucionale të Sundimit të Ligjit dhe të veprojë me vendosmëri për t’i parandaluar dhe luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Pas analizës së situatës së përgjithshme dhe dokumenteve të ndryshme, si dhe pas një konsultimi gjithëpërfshirës mes të gjithë aktorëve relevant në sektorin e Sundimit të Ligjit, janë identifikuar tri fusha kryesore për përmirësimin e të cilave kërkohet asistencë e donatorëve. Këto fusha janë: **1) Çështjet e drejtësisë; 2) Çështjet e brendshme; dhe 3) Çështjet e qasjes në drejtësi.**

## 5.1 ÇËSHTJET E DREJTËSISË

Krahas përmirësimit dhe avancimit të bazës ligjore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, gjatë periudhës 2008-2010 është kryer edhe procesi i **ri-emërimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve** me mandat të përhershëm. Ndërkohë që, pas miratimit të kornizës ligjore për sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial më 1 janar 2013, në Kosovë ka filluar funksionimi i strukturës së re të gjykatave dhe prokurorive.

Struktura e re e gjykatave përbëhet nga Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, ndërkohë që brenda juridiksionit të Gjykatës Themelore janë krijuar departamentet përkatëse. Ndërsa, krahas sistemit gjyqësor, më 1 janar 2013 ka filluar së funksionuari edhe sistemi i ri prokurorial i përbërë prej: Prokurive Themelore, Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Parimet kryesore të kësaj reforme janë pavarësia, paanshmëria, efikasiteti dhe llogaridhënia. Një vit pas fillimit të kësaj kornize ligjore është parë i nevojshëm amendamenti i kornizës ligjore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, për arsye se zbatimi praktik i kësaj reforme ka rezultuar të jetë jo i lehtë dhe janë evidentuar vështirësi si në aspektin legjislativ ashtu edhe në atë organizativ. Ministria e Drejtësisë, e mandatuar për hartimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e drejtësisë, ka filluar procesin e rishikimit të kësaj kornize.

Sistemi i gjykatave dhe prokurorive ka nevojë të përforcohet me gjykatës dhe prokurorë të profilizuar. Rol të veçantë në këtë kuptim pritet të merr Akademia e Drejtësisë, e cila do të organizojë trajnime të veçanta në shumë fusha specifike, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK-së). Përpjekje të mëtutjshme janë të nevojshme për të finalizuar procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, në plotësimin e pozicioneve të mbetura sidomos për pakicat, për të cilat legjislacioni i Kosovës rezervon një numër të caktuar të pozitive. Sfidë mbetet edhe integrimi në sistemin e drejtësisë së Kosovës i gjyqtarëve dhe prokurorëve serb të pjesës veriore.

Poashtu, është e nevojshme që të forcohen KPK dhe KGJK (përfshirë **Insitutet e Karrierës** së këtyre institucioneve) gjë që do të përmirësonte efikasitetin në punë të prokurorëve dhe gjyqtarëve gjatë avancimit të tyre në karrierë si dhe ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe veprave penale të tjera karakteristike. Për më tepër, është e nevojshme që mekanizmat për mbikqyrje të punës së prokurorëve nga kryeprokurorët, gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave të jenë shumë aktiv, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës së vartësve të tyre (prokurorë, gjyqtarë dhe staf administrativ).

Vëmendje e veçante duhet kushtuar edhe forcimit dhe ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK). Duke qenë se

kapacitetet e prokurorëve vendorë janë të limituara për t'u përballur me krime të rënda. PSRK drejtohet nga EULEX-i (më herët është drejtuar nga UNMIK-u) dhe përqendrimin kryesor të saj e ka në fushën e korrupsionit, krimeve të luftës, terrorizmit, krimin të organizuar dhe krimin financiar. Që nga themelimi i PSRK-së e deri më sot ka qenë e vështirë të matet niveli i ngritjes së kapaciteteve vendorë që janë pjesë e PSRK-së. Duke patur parasysh transferimin gradual të përgjegjësive të prokurorët vendorë, vërehet nevoja për ngritje të kapaciteteve të përgjithshme të stafit vendorë në PSRK dhe veqanërisht në profilizimin dhe specializimin e prokurorëve si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së PSRK-së.

Një nga sfidat tjera që e ka përcjellur gjyqësorin e Kosovës është **numri i rasteve të pazgjidhura**. Me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi, KGJK ka nxjerrë një strategji për zvogëlimin e rasteve të pazgjidhura, ndërkohë që numri i rasteve të pazgjidhura vazhdon të jetë i lartë. Edhe **ekzekutimi i aktivendimeve gjyqësore** ka pasur progres të limituar. Me qëllim të rritjes së besimit në sistemin gjyqësor, sistemi gjyqësor duhet të përqendrohet më shumë në rritjen e efikasitetit në zgjidhjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore brenda normave të parapara me ligje. Rastet e vjetra janë pengesë e madhe për efikasitetin e gjykatave. Për shkak të vjetërsisë së tyre dhe ndryshimit të situatës faktike, ato kërkojnë përkushtim të madh profesional, gjë që pengon zgjidhjen e rasteve akute dhe aktuale. Prandaj, për ta adresuar siç duhet këtë çështje kërkojnë veprime emergjente.

Edhe sa i përket **llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve** nevojiten përmirësime. Kjo në mes tjerash edhe për arsye se përkundër shqiptimit të masave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë vitit 2012 dhe 2013, këto masa nuk kanë rezultuar me largimin e ndonjërit nga puna. Në këtë aspekt kërkojnë që rregulloret e masave disiplinore të KPK-së dhe KGJK-së ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të përmirësohen në mënyrë që **masat disiplinore** dhe politikat ndaj luftës kundër korrupsionit në gjyqësor të japin rezultate konkrete. Në këtë aspekt, edhe krijimi dhe ngritja e kapaciteteve të Njësive për Analiza dhe Politika në KGJK dhe KPK, profesionalizimi i komisioneve disiplinore si dhe forcimi i **Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPS)** do duhej të kishin efekte pozitive. Kjo është veqanërisht e rëndësishme për faktin se me përfundimin e mandatit të tanishëm të Misionit të EULEX-it, më nuk ekziston mundësia ligjore dhe praktike që në rastet në fjalë përgjegjësia të kalojë te gjyqtarët përkatësisht prokurorët e EULEX-it.

Gjithashtu, deri më sot nuk është trajtuar mjaftueshëm **forcimi i mbështetjes profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët**. Mekanizmat e praktikës profesionale dhe punësimi të stafit profesional mbështetës kërkojnë vëmendje të shtuar. Profilet e bashkëpunëtorëve profesional duhet të fuqizohen. Përmes kësaj sigurohet sfondi profesional për gjyqtarë dhe prokurorë. Së këndejmi, përfshirja e hershme e studentëve përmes praktikës juridike si dhe angazhimi i kandidatëve për provime profesionale përmes

praktikës profesionale do të kishte efekt të ndjeshëm edukativ për praktikantët si dhe efekt shkarkues për gjykatat dhe prokuroritë. Puna e gjyqtarëve dhe prokurorëve varet në masë të konsiderueshme nga angazhimi i tyre profesional.

**Stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive** nuk ka arritur nivelin e dëshirueshëm të forcimit të kapaciteteve, andaj edhe paraqitet si pengesë në administrimin efikas të lëndëve. Për më tepër, numri i stafit administrativ është i pamjaftueshëm për t'u përballur me sfidat organizative të gjykatave dhe prokurorive. Prandaj, rritja e numrit të stafit si dhe aftësimi i tyre sa i përket ushtrimit të përgjegjësive menaxheriale si dhe trajnimi i tyre për përdorimin e aplikacioneve elektronike kërkon vëmendje të posaçme.

Duke filluar nga viti 2011, në Kosovë janë bërë hapa të rëndësishëm në zhvillimin e profesioneve të pavarura të drejtësisë. **Noteria** ka filluar punën për herë të parë në Kosovë. Licencimi i disa gjeneratave të noterëve ka përfunduar. Megjithatë, shërbimi noterial duhet të forcohet dhe profesionalisht. Krijimi i një sistemi elektronik për integrimin e të dhënave në sistemin e noterisë do të ndihmonte në shkëmbimin dhe komunikimin e të dhënave në mes të noterëve.

Në vitin 2011 ka filluar së funksionuari **profesioni i ndërmjetësimit** si procedurë jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve. Mbetet për tu vlerësuar në të ardhmen mundësia e integritit të ndërmjetësimit si institut i detyrueshëm për disa lloje të kontesteve. Sfidat kryesore të këtij profesioni janë ngritja e autoritetit përmes ngritjes së profesionalizmit dhe besueshmëria në paanësinë e këtij institucioni.

Profesioni i **arbitrazhit** është i ri dhe merret me zgjidhjen e kontesteve. Edhe ky profesion i lirë mbetet në fazat e para të zhvillimit, prandaj dhe duhet forcuar. Zgjidhja e kontesteve komerciale përmes arbitrazhit do të shkarkonte në masë të madhe gjyqësorin e Kosovës.

Që nga viti 2014 në Kosovë ka filluar së funksionuari profesioni i **përmbauesit privat**. Gjenerata e parë e përmbauesve privat është licencuar. Megjithatë, ky profesion është në fazat e para të ndërtimit dhe zhvillimit të tij si profesion i lirë ligjor. Prandaj, duke parë nivelin e ekzekutueshmërisë së lëndëve nëpër gjykata, funksionalizimi i përmbauesve privat do të duhej të ndodhte sa më shpejtë për të rritur ekzekutueshmërinë e aktivendimeve gjyqësore. Sfidat e këtij profesioni janë bashkëveprimi me gjykatat, aftësimi praktik i përmbauesve, organizimi dhe mbikqyrja e profesionit.

Në vitin 2013 është themeluar dhe profesioni i **administratorëve falimentues**. Administratorët e parë janë licencuar sikundër që është nxjerrë një numër aktesh nënligjore. Megjithatë, Gjykata Themelore, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk ka krijuar kapacitete të mjaftueshme për trajtimin e rasteve të falimentimit. Ashtu si në



profesionet tjera të lira, edhe këtu sfidë kryesore mbetet ngritja profesionale e administratorëve falimentues, trajnimi i gjyqtarëve për trajtimin e rasteve të falimentimit dhe kompletimi i akteve nënligjore.

Profesioni i **avokatisë** paraqet një ndër profesionet më të konsoliduara në Kosovë në sektorin e Sundimit të Ligjit. Megjithatë, ngritja e kapaciteteve dhe transparencës në kuadër të Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), forcimi i mbikqyrjes profesionale dhe organeve disiplinore brenda OAK-së si dhe qasja e barabartë në anëtarësinë e OAK-së, krijimi programeve për trajnim të vazhdueshëm dhe për profilizim të avokatëve janë sfidat dhe çelësi i reformave të këtij profesioni. Përfundimisht krijimi i një sistemi elektronik për integrimin e të dhënave në sistemin e avokatisë, do të ndihmonte në shkëmbimin dhe komunikimin e të dhënave në mes të avokatëve.

Pra, nga ajo që u tha më lartë rrjedh se emëruesit e përbashkët për përforcimin e profesioneve të lira janë: profesionalizimi i praktikuesve të këtyre profesioneve, nxjerrja e akteve nënligjore, mbikqyrja e këtyre profesioneve, organizimi në shoqata dhe oda profesionale dhe ngritja e kapaciteteve të gjykatave. Një aspekt tjetër që do të duhej marrë parasysh është harmonizimi i legjislacionit i cili do të rregullonte harmonizimin e veprimeve të profesioneve të lira me gjykatat. Duke patur parasysh faktin se studimet universitare në Kosovë nuk ofrojnë përgatitje të mjaftueshme profesionale praktike, duhet të vlerësohet nevoja e aftësimin profesional pasuniversitar dhe provimit profesional për profesionet e lira të drejtësisë si dhe arsimimi i vazhdueshëm.

Edhe në fushën e **përmirësimit të infrastrukturës fizike dhe asaj të IT-së** të gjykatave dhe prokurorive janë shënuar përmirësime simbolike. Ndërtimi i objekteve për prokurori dhe gjykata në tërë territorin e Kosovës është më se i nevojshëm për të siguruar mbarëvajtje të punëve nëpër këto institucione. Pastaj, krijimi i sistemit të matjes së performancës së punës së prokurorëve dhe stafit të tyre nga KPK në aspektin empirik është një e arritur në këtë drejtim. Ndërkohë që një gjë e tillë nuk është instaluar edhe në KGJK ku do të mbikëqyreshin aktivitetet ditore të gjyqtarëve dhe stafit të gjykatave.

I sponsoruar nga Qeveria e Norvegjisë, projekti i futjes së Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Lëndëve (SMIL) vetëm ka filluar në 2013 dhe, në fazën e dytë të këtij projekti, do të bëhet vendosja e SMIL-it për gjykatat dhe prokuroritë. Duka patur parasysh që një iniciativë e mëhershme për instalimin e SMIL-it nuk ka qenë e suksesshme, KPK dhe KGJK janë të përkushtuara që përmes këtij projekti të lidhin gjykatat dhe prokuroritë. Ndërkohë që është e nevojshme që aspektet e tjera të IT-së për institucione tjera të Sundimit të Ligjit janë të adresohen përmes hartimit të një strategjie të integritit të IT-së dhe interoperabilitetit për tërë sektorin e Sundimit të Ligjit.

Në këtë drejtim, është e nevojshme që planet për të krijuar treguesit e përfomancës së gjykatave e prokurorive dhe mbikqyrjes dhe kontrollit të standardeve të punës në kuadër të gjykatave e prokurorive, përmes krijimit dhe ngritjes së kapaciteteve të Njësive për Analiza dhe Politika në KGJK dhe KPK, të mbështeten vazhdimisht. Këtu përfshihen edhe nevojat për përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe të IT-së së gjykatave dhe prokurorive në veriun e Kosovës. Në përgjithësi, gjykatave dhe prokurorive u mungon një sistem i avancuar i IT-së për menaxhimin e lëndëve. Krijimi i këtij sistemi dhe lidhja dixhitale mes policisë, prokurorisë dhe gjykatave do të rriste dukshëm performancën dhe efikasitetin e gjyqësorit në përgjithësi. Instalimi i infrastrukturës së IT-së duhet të përcillet me aftësimin e stafit për përdorimin e sistemit si dhe punësimin e administratorëve të IT-së.

**Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK)**, në bazë të mandatit të tij, ofron trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë. Ndërkohë që, sistemi i ri i drejtësisë penale, përfshirë legjislacionin për gjykatat dhe prokuroritë, ka rritur nevojën për resurse shtesë, si financiare ashtu dhe kadrovike. Megjithatë, këtij institucioni i mungojnë programe trajnuese të vazhdueshme që do të ndihmonin gjyqtarët dhe prokurorët në specializimin dhe profilizimin e tyre në fusha të ndryshme, p.sh. për krim të organizuar, shpërlarje të parave, luftimin e ekonomisë joformale, krimin financiar e kibernetik si dhe veprave tjera penale karakteristike, kjo për arsye se këto funksione kanë qenë kryesisht përgjegjësi e misioneve ndërkombëtare (së fundi EULEX-it). Qeveria e Kosovës, me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit ligjor dhe në harmoni me reformat në sistemin e drejtësisë, ka marrë vendim që të themelojë Akademinë e Drejtësisë, duke e transformuar IGJK-në në një Akademi të specializuar për trajnime.

**Akademia e Drejtësisë**, përveq misionit primar të saj për organizimin e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë, do të krijojë mundësi të reja për organizimin e trajnimeve edhe për profesionet e lira juridike, bashkëpunëtorë profesional të gjykatave dhe përgatitjet për kandidatët për provimin e jurisprudencës. Akademia, ndër të tjera, pritet që të adresojë edhe kërkesën për profilizim/specializim të gjyqtarëve dhe prokurorëve përmes krijimit të programeve të përgjithëshme/hyrëse, specifike dhe të vazhdueshme për fushat karakteristike (veqanërisht fushat ku EULEX-i ka ushtruar përgjegjësi ekzekutive ekskluzive). Ligji për Akademinë është në finalizim dhe Akademia pritet të themelohet në vitin 2015.

Në mbështetje të arsimit ligjor për sistemin e drejtësisë, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet **reformimit të Fakultetit Juridik (FJ) të Universitetit të Prishtinës (UP)**. Reformimi do të krijonte kushtet për profilizimin e studentëve për fusha të ndryshme, jo vetëm të sistemit të drejtësisë por edhe të çështjeve të brendshme. Krijimi i kurikulave dhe programeve studimore sipas praktikave më të mira ndërkombëtare do të lehtësonte dukshëm punën e studentëve të FJ-së për t'u përfshirë në sistemin gjyqësor. Reformimi i

FJ-së së UP-së do të ketë efekte pozitive zingjirore në Fakultetet e tjera homologe në Kosovë.

Sa i përket funksionalitetit të mirëfilltë të sistemit të drejtësisë, janë edhe dy çështje të cilat deri më tani nuk janë adresuar mjaftueshëm. Së pari, **administrata e sistemit gjyqësor dhe prokurorial** ende punon sipas **Ligjit për Shërbimin Civil**; dhe së dyti, për çështjen e **sigurisë personale për gjyqtarë, prokurorë dhe policë** ende nuk ka një bazë ligjore në hartim që do të rregullonte këtë çështje sipas praktikave ndërkombëtare. Sa i përket çështjes së parë, administrata e gjykatave dhe prokurorive si dhe administrata e Sekretariatit të KGJK-së dhe KPK-së operojnë sipas **Ligjit për Shërbimin Civil**, ndërkohë që kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët kanë kontroll të kufizuar mbi stafin administrativ të tyre si pasojë e vijave të ndryshme të komunikimit që ofrojnë ligjet e drejtësisë dhe shërbimit civil.

Për këtë arsye, personeli administrativ i gjykatave dhe prokurorive duhet të hyjë në kategori speciale duke mos qenë subjekte të ligjit për shërbimin civil dhe rregulloreve të këtij ligji. Kjo do të shpjerë në punë më efçente të prokurorive dhe gjykatave (përfshirë Sekretariatet e KGJK-së dhe KPK-së). Për të bërë këto ndryshime së pari kërkohet një vlerësim gjithëpërfshirës, i cili do të identifikonte nevojën për pavarësinë e administratës së gjyqësorit nga shërbimi civil. Në këtë process do të duhej koordinuar mirë me Ministrinë e Drejtësisë, pastaj me Komisionet Parlamentare respektive për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore.

Një aspekt tjetër i Sundimit të Ligjit që kërkon vëmendje të shtuar nga institucionet e Kosovës është dhe **drejtësia civile**. Kosova është në fazën paraprake të hartimit të **Kodit Civil**, hartimit dhe miratimi i të cilit do të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm të performancës së sistemit gjyqësor në Kosovë dhe do të ndihmonte profilizimin e gjyqtarëve dhe avokatëve në këtë drejtim. Shumë aspekte të cilat me Kodin e Drejtësisë Për të Mitur nuk kanë mundur të rregullohen si duhet (p.sh. alimentacioni, adoptimi i fëmijëve) do të mund adresoheshin me krijimin e një sistemi të drejtësisë juridiko-civile sipas praktikave më të mira të BE-së. Aspekte tjera të drejtësisë civile, si e drejta komerciale, çështjet pronësore, kanë ngecje të theksuara si rezultat i një drejtësie civile të pazhvilluar. Kjo natyrisht që krijon pengesa në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

**Çështjet pronësore** janë poashtu një fushë më vete, për zgjidhjen e së cilave që nga paslufta e deri me tani asnjëherë nuk ka pasur politika adekuate. Ende nuk ka një strategji për çështje pronësore dhe kjo vështirëson zgjidhjet e çështjeve të ndryshme pronësore në nivel vendi. Edhe mekanizmat institucional në këtë lëmi nuk janë të koordinuar si duhet, nuk ka një institucion që krijon politika për çështje pronësore dhe mungojnë kapacitetet humane dhe financiare për të rregulluar këto çështje. Ndërkohë që, çështjet pronësore tashmë janë vënë si një ndër prioritetet për vitet në vijim që do të adresohen së bashku me çështjet civile dhe hartimin e Kodit civil.

Në rrafshin bashkëpunimit ndërkombëtar përkundër vullnetit të institucioneve të Kosovës dhe iniciativave të shumta të ndërmarrë, sistemi i drejtësisë së Kosovës ka qenë i kufizuar në pjesëmarrjen apo anëtarësimin në nisma/iniciativa/organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Pasi që Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, ajo nuk ka mundur të jetë anëtare e **CEPEJ (Komisioni Evropian për Efiçencë në Drejtësi)** në kuadër të Këshillit të Evropës, i cili merret me përmirësimin e efiçencës dhe funksionimin e drejtësisë së shteteve anëtare dhe përmirësimin e zbatimit të instrumenteve të miratuara nga Këshilli i Evropës. Ndonëse ka patur përparim në thellimin e bashkëpunimit bilateral, mosanëtarësimi nëpër iniciativave të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare është pengesë për zhvillimin e sistemit të drejtësisë në tërësinë e tij.

## 5.2. ÇËSHTJET E BRENDSHME

Edhe pse ka një sërë ligjesh të miratuara dhe institucioneve të themeluara, korniza e përgjithshme ligjore që ka të bëjë me çështjet e brendshme është komplekse, sidomos në parandalimin dhe luftimin e **korrupsionit dhe krimit të organizuar**. Këto dy dukuri sfidojnë zhvillimin ekonomik dhe integrimin e Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë, e sidomos në BE.

Për momentin, të gjitha rastet e rënda trajtohen në bashkëpunim me EULEX-in ndërkohë që sektori i çështjeve të brendshme, edhe pse në reformim e sipër, ka nevojë të jetë më efikas dhe efektiv në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, kur misioni i EULEX-i të përfundojë. Për më tepër, nevoja për ngritje të efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve të zbatimit të ligjit të Kosovës është konfirmuar në shumë raporte ndërkombëtare në përgjithësi dhe në ato të BE-së në veçanti. Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve të zbatimit të ligjit do ta përmirësonte përceptimin publik për këto institucione, dhe do t'i rriste kapacitetet për të trajtuar krimet komplekse edhe në kohën kur EULEX-i nuk do të jetë më prezent në Kosovë.

Sa i përket politikave dhe legjislacionit, Kosova ka ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm në **parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit**, duke zbatuar elementet e nevojshme të kornizës ligjore, duke përfshirë miratimin e ligjit për kompetenca të zgjeruara për konfiskim të pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme, ligjin për deklarimin e pasurisë, parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, informatorët, prokurimin publik dhe financimin e partive politike. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka nevojë për obligime përkatëse të raportimit pasi që aktualisht rastet e konfliktit të interesit vazhdojnë të mos raportohen. Sanksionet e parashikuara në ligjet për deklarimin e pasurisë dhe në konfliktin e interesit janë mjaft simbolike dhe ligjet duhet të sigurojnë sanksione bindëse si dhe proporcionale.

Përveç bazës ligjore, në shkurt 2013 Parlamenti i Kosovës ka miratuar edhe **Strategjinë Kundër Korrupsionit si dhe Planin e Veprimit 2013-2017**. Korniza aktuale ligjore ka dispozita mjaftueshëm të forta të për të sjellë rezultate të prekshme në këtë fushë.

Në aspektin institucional, Kosova ka themeluar Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) në vitin 2006. AKK është institucioni kryesor për monitorimin e zbatimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe ligjin për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publikë, si dhe të strategjisë anti-korrupsion dhe planit të veprimit. AKK merret gjithashtu me përpunimin e ankesave individuale për rastet e mundshme të korrupsionit dhe është e obliguar të njoftojë autoritetet tjera si policinë dhe prokurorinë nëse ajo gjen arsye për hetim të mëtejshëm. Në kuadër të përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, në shkurt 2012, Presidentja e Kosovës ka themeluar Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit. Qëllimi i themelimit të këtij Këshilli është përmirësimi i koordinimit dhe rritja e vetëdijes në mesin e të gjitha organeve dhe institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit.

Për të rritur përpjekjet për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, më 26 Shkurt 2010, me vendim të Qeverisë, në kuadër të Prokurorisë Speciale të Kosovës, është krijuar një Task Forcë Anti-Korrupsion e përbërë nga prokurorë (nga Kosova dhe EULEX-i) dhe hetues të policisë. Qëllimi i themelimit të kësaj Task Force është që të hetohet krimet ekonomik dhe financiar. Ndërkohë, në kuadër të këtij mekanizmi, Policia e Kosovës ka themeluar gjithashtu një Drejtori kundër krimet ekonomik dhe korrupsionit. Për më tepër, janë themeluar departamentet e inspektimit në shumë autoritete dhe institucione, me qëllim të adresimit dhe monitorimit të situatës në lidhje me korrupsionin dhe/apo sjelljen kriminale brenda vetë organizatës.

Edhe pse, në përgjithësi, Kosova ka elemente të mjaftueshme të vendosura në kornizën ligjore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, sikurse që ka edhe institucione përkatëse, në aspektin praktik lufta kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar të të gjitha llojeve vazhdon të mbetet sfida për autoritetet e Kosovës. Kjo çështje duhet të shikohet nga dy aspekte, sa i përket luftimit të brendshëm institucional kërkohet forcimi i mekanizmave të brendshëm të institucioneve përkatëse. Ndërsa në anën tjetër me marrjen dhe përgjegjësi të ushtruara nga EULEX-i, vërehet një nevojë e shtuar, ndër të tjera, për profilizimin e mëtutjeshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Rezultatet e zbehta në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit kanë edhe tri arsye kryesore. E para sepse kësaj strategjie i mungojnë mekanizmat obligues që do detyronin institucionet për të marrë përgjegjësi të tyre, e dyta sepse organizimi institucional mbetet i ndërlikuar për ta adresuar këtë fushë komplekse, dhe e treta për shkak se ka patur mungesë të pronësisë nga të gjithë aktorët përgjegjës për implementimin e kësaj strategjie.

Në **Policinë e Kosovës (PK)** ka pasur zhvillime pozitive deri më sot sa i përket ngritjes së kapaciteteve. PK, në bashkëpunim me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit, ka shënuar progres, edhe pse jo në nivelin e dëshirueshëm, në ngritjen e kapaciteteve për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit, me theks të veçantë krimet të organizuar dhe korrupsionit. Poashtu progres është shënuar edhe në ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, sidomos atij rajonal dhe me gjerë, përfshirë atë me agjencionet ndërkombëtare të sigurisë. Në këtë kontekst PK ka qenë pjesë e shumë operacioneve ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e krimet të organizuar. Siqdoftë, duke marrë parasysh trendet e zhvillimit dhe sofistikimit të mjeteve dhe formave të kryerjes së veprave penale, kërkohet forcim dhe specializim i stafit për të luftuar dukuritë negative.

PK në maj të vitit 2012 ka hartuar dhe aprovuar Strategjinë dhe planin e veprimit 2012-2016 "Policimi në Bashkësi". Në bazë të këtij dokumenti parashihet edhe ndarje sektoriale sipas kriterëve të parapara, përkatësisht numrit të popullsisë, numrit të rasteve, dhe disa faktorëve tjerë. Deri me tani janë 133 sektorë në 40 stacione policore. Gjithashtu, Policia ka aprovuar strategjinë Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca – 2013 – 2017 si bazë e rëndësishme për hetime proaktive, siq janë parandalimi dhe luftimi i: krimet të organizuar; trafikimit me qenie njerëzore; trafikimit me narkotikë; krimet ekonomik dhe korrupsionit; si dhe terrorizmit.

Megjithatë, për hetimin e veprave penale komplekse, përpos nevojës për ngritje të kapaciteteve, nevojitet një përkushtimi i mirëfilltë kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar dhe bashkëpunim më i mirë mes institucioneve të zbatimit të ligjit dhe atyre gjyqësore. Prandaj, në këtë aspekt duhet rritur nivelin e bashkëpunimit, e cila do të ndihmonte në përmirësimin e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit dhe krimet të organizuar, siq është paraparë me **Planin Strategjik për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Luftën Kundër Krimet të Organizuar dhe Korrupsionit 2013-2015**. Për hetimin e veprave komplekse, Policia e Kosovës ka nevojë për ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve si dhe pajisje me teknika e mjete të nevojshme për t'u përballur me këtë problematikë komplekse.

Prandaj, meqenëse institucionet e Kosovës aspirojnë të përmbushin obligimet që dalin nga procesi i Stabilizim Asociimit, kërkohet të shtohen përpjekjet për hetime dhe ndjekje të rasteve të korrupsionit si dhe të përmirësojnë besueshmërinë e statistikave në luftën kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar, **pra krijimin dhe menaxhimin adekuat të një regjistri për të dhënat penale sipas praktikave më të mira të BE-së.**

Në aspektin e politikave për **parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit** janë nxjerrë një varg strategjish, si:

- Strategjia Kundër Krimit të Organizuar 2012- 2017,
- Strategjia Kundër Narkotikëve 2012- 2017,
- Strategjia Kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2012- 2017,
- Strategjia kombëtare për Parandalimin e Krimit dhe Plani i Veprimit 2013 – 2017,
- Plani Strategjik për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit 2013-2015,
- Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2013-2018,
- Strategjia për kontrollimin dhe mbledhjen e armëve të vogla dhe të lehta 2013 – 2017,
- Strategjia Kombëtare kundër Falsifikimeve 2012-2017,
- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2012-2017,
- Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014,
- Strategjia Kombëtare Kundër Drogave 2012-2017,
- Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit, dhe Krimeve Financiare 2014-2018.

Edhe pse janë hartuar një varg i strategjive, kërkohet përkushtim më i madh nga të gjithë aktorët relevantë në zbatimin në praktikë të këtyre strategjive, përmes krijimit të mekanizmave adekuat institucional dhe ofrimit të mjeteve buxhetore për implementimin e strategjive. Në aspektin strategjik do të duhej që në të ardhmen numri i strategjive të reduktohej në minimum, duke hartuar strategji më gjithëpërfshirëse dhe sektoriale.

Pjesë integrale e instucioneve për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar është edhe **Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (AAPSK)**, duke u kompletuar kështu struktura institucionale në luftimin e krimit. Përkundër progresit të gjertanishëm në administrimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar, kjo agjenci përballlet me vështirësi gjatë zbatimit të ligjit të AAPSK-së. Kjo për arsye të ekzistimit të disa çështjeve konfliktuale në mes të Ligjit për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara, Kodit Penal (KP) dhe Kodit të Procedurës Penale (KPP), të cilat kërkojnë zgjidhje.

Në mes tjerash, këtu bëhet fjalë për ligjin që rregullon AAPSK-në si përgjegjëse **për asistimin e ekzekutimit** të një vendimi për sekuestrimin apo konfiskimin e pasurive sipas kërkesës së autoritetit kompetent, ndërkohë që në të njëjtën kohë KPP e detyron AAPSK-në **me ekzekutimin** e vendimeve gjyqësore. Pra, në përgjithësi shihet se legjislacioni i drejtësisë penale ka nevojë për përmirësim dhe avancim të mëtejshëm. Poashtu, edhe prokurorët dhe gjykatat krijojnë konfuzion për sa i përket inperpretimit dhe terminologjisë në lidhje me “Sekuestrimin” dhe “Konfiskimin”. Praktika ka treguar se ka pak prokurorë apo gjyqtarë që kanë një kuptim të qartë të procesit të administrimit të pasurive të sekuestruara/konfiskuara. Në një farë mase kjo përfshin edhe stafin e AAPSK-së.

Një aspekt tjetër të cilit duhet t'i jepet rëndësi e veçantë është nevoja për **bashkëpunim** më të thellë **ndër-institucional** me AAPSK-në. Ligji për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara jep vetëm dispozita bazike për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Asistenca në përforcimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe kapaciteteve njerëzore në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar do të ndihmonte në këtë drejtim.

Në **Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK)** është investuar në infrastrukturën fizike, e në veçanti në ndërtimin e Burgut të Sigurisë së Lartë (BSL), një bashkë-investim i Qeverisë së Kosovës dhe BE-së. Sa u përket resurseve njerëzore që punojnë në SHKK, me rritjen infrastrukturale të këtij shërbimi ndjehet nevoja edhe për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore. Një ndër sfidat më të mëdha për SHKK vazhdon të mbetet kategorizimi adekuat i të burgosurve, problem i cili pritet të adresohet me funksionalizimin e Burgut të Sigurisë së Lartë (BSL). Asistenca për të adresuar këto nevoja veç është duke u dhënë për SHKK-në përmes projektit të UNOPS-it për BSL-në, dhe poashtu nga një projekt 1.7 milion EUR të BE-së për mbështetjen e SHKK-së dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSP).

Mirëpo, nevojitet asistencë e mëtutjeshme në fushën e bashkëpunimit ndër-institucional dhe mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, që do të përfshinte edhe ngritjen e një qendre operative për menaxhim dhe monitorim të të dhënave, pastaj krijimin e sistemit elektronik për SHSK-në. Mundësia e bashkimit të SHKK-së dhe SHSK-së poashtu është duke u konsideruar.

Një nga aspektet më të rëndësishme të Kosovës në fushën e Sundimit të Ligjit është **mbrojtja e dëshmitarëve**. Në korrik të vitit 2011 është miratuar Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Zbatimi i këtij ligji mbetet sfidë për institucionet e Kosovës, duke patur parasysh mungesën e infrastrukturës së nevojshme dhe ekspertizën në zhvillim e sipër për të siguruar mbrojtje efektive të dëshmitarëve. Mbrojtja e dëshmitarëve ka qenë një sfidë që rregullisht e ka përcjellur Kosovën që nga koha e UNMIK-ut e deri me tani. Institucionet e Kosovës së bashku me EULEX-in kanë krijuar një sistem efektiv për mbrojtjen e dëshmitarëve. Duke pasur parasysh sensitivitetin e kësaj qështjeve dhe aspektin kohor kërkohet mbështetjen e vazhdueshme për programet e mbrojtjes së dëshmitarëve.

Një fushë me interes të lartë për Institucionet e Kosovës paraqet edhe Dialogu për Liberalizimin e Vizave me BE-në, ku është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe. Ndërkohë, Institucionet e Kosovës kanë punuar në dy drejtime sa u përket **vizave**. Që nga korriku 2013 Kosova ka filluar të aplikojë regjimin e vizave për shtetasit e huaj. Për këtë arsye është nxjerrë legjislacioni bazë, dhe legjislacioni sekondar për procedurat standarde operative për të lëshuar viza nëpër pikëkalimet kufitare. Për të përmbushur kërkesat që dalin nga ky proces, Kosova ka ndërmarrë një sërë masash jo vetëm në hartimin e



politikave, por edhe në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme ligjore, institucionale dhe fizike.

Lidhur me procesin e **liberalizimit të vizave**, në aspektin institucional janë bërë përpaparime në sistemin e sigurisë së Kosovës, ndër të tjera: 1) harmonizimi i legjislacionit vendor me atë të BE-së; 2) hapja e Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit në 2013; 3) funksionalizimi i sistemit të ri të IT-së për Sistemin e Menaxhimit të Kufirit (Border Management System); 4) themelimi i Departamentit për Ri-integrim në kuadër të MPB-së. Natyrisht, themelimit të këtij kuadri institucional i ka paraprirë nxjerrja e legjislacionit adekuat sipas praktikave më të mira të BE-së për fushën e Sundimit të Ligjit.

Megjithatë, ka ende nevojë që donatorët, e sidomos BE-ja, të ndihmojnë institucionet vendore në këto fusha: i) hartimin e legjislacionit sekondar dhe procedurave standarde operative për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit; ii) rritjen e kapaciteteve profesionale të saj dhe institucioneve që lidhen me të; dhe iii) përmirësimin e kapaciteteve profesionale të Departamentit për Ri-integrim. Rritja e kapaciteteve të këtyre sektorëve përmes ndihmës së donatorëve duhet shoqëruar me rritjen e buxhetit të shtetit në këtë drejtim.

Një nga vështirësitë me të cilat është duke u përballur Kosova është edhe **migracioni dhe azili**. Edhe pse janë nxjerrë një varg ligjesh e dokumentesh strategjike që lidhen direkt dhe indirekt me këtë fushë, në aspektin praktik shteti i Kosovës vazhdon të përballlet me këtë sfidë e cila duhet adresuar më seriozisht për të përmbushur obligimet që dalin nga procesi i Integrimit Evropian.

Së fundi është nxjerrë **Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit, dhe Krimeve Financiare 2014-2018** sikundër që është amandamentuar ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Përkundër zhvillimeve të mësipërme, ekonomia joformale, shpërlarja e parave, financimi i terrorizmit, krimi financiar dhe ai kibernetik vazhdojnë të mbetet probleme që duhet adresuar përmes ngritjes së mëtutjeshme të kapaciteteve dhe bashkëpunimit më efikas brenda e ndërinstucional dhe ndërkombëtar.

Një aspekt që zvogëlon efektet e përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, shpërlarjes së parave, financimin e terrorizmit, krimin financiar e kibernetik është edhe nevoja e ngritjes të kapaciteteve dhe mungesa e ekspertizës lokale. Mungesa e përvojës dhe kapaciteteve në këtë sektor është evidente jo vetëm te Njësia e Inteligjencës Financiare që operon në kuadër të Ministrisë së Financave (MF), por edhe te policia, gjykatat dhe prokuroritë si dhe te institucionet tjera që përballen me këtë problematikë serioze.

Edhe në fushën e trajnimeve, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) dhe Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) nuk kanë programe të avansuara për problematikat e lartpërmedura për të ofruar trajnime adekuate për prokurorë e gjyqtarë respektivisht për agjencionet e zbatimit të ligjit në Kosovë. Prandaj, kjo është një fushë që kërkon asistencë të jashtme për një qasje programatike ndaj kësaj problematike, me fokus në ngritje të kapaciteteve njerëzore.

Ashtu si vendet e rajonit, edhe Kosova nuk përbën ndonjë përjashtim sa i përket **problemit të drogave**. Në Raportin e Progresit të BE-së të vitit 2013 thuhet se “Kosova vazhdon të jetë tranzit dhe vend deponues kryesisht për heroinë duke involvuar grupet e organizuara lokale”. Prandaj, edhe në këtë fushë kërkohen hetime të kombinuara kundër trafikimit apo posedimit të narkotikëve. Kapacitetet institucionale të Kosovës, në këtë rrafsh, duhet përmirësuar dhe forcuar sikundër që duhet forcuar bashkëpunimin rajonal.

Sa i përket programeve për ngritjen e kapacitetit të stafit të agjencioneve të zbatimit të ligjit, të cilat kryesisht ofrohen nga **Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në Vushtri**, vlen të theksohet se është shënuar progres. Megjithatë, AKSP-së ende i mungojnë kapacitetet e nevojshme fizike (pajisje teknike të avancuara) dhe profesionale për të ofruar programe të specializuara në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar, shpërlarjes së parave, trafikimit me qenie njerëzore, terrorizmit, kontrabandës me droga, medikamente dhe aspekte tjera që prekin jo vetëm Kosovën, por edhe rajonin e më gjerë.

Edhe sa i përket infrastrukturës fizike (objekteve) të agjencive të ligjit, ka ende punë për tu bërë, sidomos në renovimin/ndërtimin e pikëkalimeve të reja kufitare dhe stacioneve policore me të gjitha pajisjet e nevojshme. Këtu duhet përmendur infrastrukturën fizike në veriun e Kosovës e cila ka nevojë për përmirësim në të gjitha dimensionet e saj.

**Dixhitalizimi i të dhënave** në institucionet e drejtësisë dhe ato të punëve të brendshme është njëra nga sfidat kryesore në forcimin e Sundimit të Ligjit. Policia kufitare e Kosovës është në hapat e parë të saj të ndërtimit të Sistemit të IT-së për menaxhimin e kufirit. Ky sistem i IT-së pritet që në të ardhmen të zgjerohet duke lidhur, përvec databazave softwerike të Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC), edhe prokurorinë, gjykatat, doganat, Ministrinë e Punëve të Jashtme (seksioni i vizave), Ministrinë e Punëve të Brendshme (migracioni dhe azili) dhe, nëse është e nevojshme, institucionet e tjera relevante. Krijimi dhe integrimi i këtyre rrjeteve softwerike, përpos që do të rriste efikasitetin dhe kontrollin e këtyre institucioneve, do të krijonte dhe kushtet për krijimin e një regjistri të dhënash penale sipas praktikave më të mira të BE-së.

Përkundër bazës së politikave dhe asaj ligjore **sektori i menaxhimit të emergjencave** ka nevojë për përmirësim dhe avancim të mëtejshëm. Sipas rekomandimeve të dalura nga procesi i rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, disa nga pikat kryesore që duhet adresuar janë: mungesa e kapaciteteve të Policisë së Kosovës në menaxhimin e turmave

dhe protestave të dhunshme, mosekzistenca e një qendre operative për menaxhimin e situatave emergjente, kapacitetet e ulëta të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) për të marrë përgjegjësitë nga Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK) dhe vështirësitë në menxhimin e materieve të rrezikshme.

Bashkëpunimi i instucioneve të rendit me **Komisionet e ndryshme parlamentare** është poashtu një çështje në vete që kërkon vëmendje. Forcimi i mbikqyrjes së Komisioneve Parlamentare është më se i nevojshëm për të pasur sukses në hartimin dhe zbatimin e politikave adekuate për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar të të gjitha llojeve. Asistenca në fushën e Sundimit të Ligjit do të duhej të përfshinte sa më shumë Komisionet e ndryshme Parlamentare duke përforsuar kështu bashkëpunimin mes tri pushteveve (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor) për problematika të caktuara të nevojshme, duke përmirësuar cilësinë e ligjeve të hartuara dhe duke rritur mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

Bashkëpunimi efektiv rajonal dhe ndërkombëtar është parakusht për parandalimin dhe luftimin e krimit me karakter rajonal dhe ndërkombëtar. Edhe pse institucionet e Kosovës janë të interesuara që në vazhdimësi të rrisin bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në çështje të ndërsjellta, kjo ende mbetet njëra nga vështirësitë kryesore. Bashkëpunimi me EUROJUST, EUROPOL, FRONTEX, Këshillin e Evropës, dhe institucionet e tjera mbetet i limituar, por ka hapa pozitivë në këtë drejtim, duke qenë se ka bashkëpunim bilateral përmes dërgimit të zyrtarëve ndërlidhës policorë dhe bashkëpunimit profesional.

### 5.3. ÇËSHTJET E QASJES NË DREJTËSI

Dihet që Kosova, në bazë të Kushtetutës së saj, është shtet dygjuhësor dhe multietnik. Në kuadër të kësaj, institucionet e drejtësisë kanë bërë hapa të konsiderueshëm, ndonëse ende ka nevojë për të siguruar qasje në drejtësi për të gjitha grupet etnike në Kosovë. Sa i përket punësimit të minoriteteve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, vlen të theksohet se numri i tyre është në rritje e sipër. Për më tepër, Institucionet e Drejtësisë janë të obliguara të sigurojnë **interpretë dhe përkthyesë adekuat gjyqësor** për të mundësuar qasje të njëjtë për të gjithë qytetarët në gjykata e prokurori, dhe jo vetëm. Kjo çështje ende nuk është adresuar siç duhet, përkundër iniciativave të mëhershme të cilat kanë rezultuar të dështuara. Prandaj sigurimi i interpretëve dhe përkthyesëve adekuat gjyqësor mbetet sfidë.

Në përgjithësi në fushën e qasjes në drejtësi është shënuar progres, sidomos në nxjerrjen e legjislacionit primar dhe sekondar për sistemin e ndihmës juridike, për të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, të drejtat pronësore, mediave, etj. Ndërkohë që, njëra nga sfidat kryesore në këtë proces është përmirësimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues. Poashtu, do të duhej qartësuar përgjegjësitë e strukturave që merren me mbrojtjen, promovimin, zbatimin dhe raportimin e çështjeve të të drejtave të njeriut dhe atyre pronësore, ashtu sikurse dhe sigurimi i pavarësisë financiare së medimeve publike.

Qasja në drejtësi ka qenë e vështirësuar në veriun e Kosovës që nga paslufta e deri me tani. Kjo përbën një ndër sfidat kryesore të sistemit të drejtësisë në Kosovë, përfshirë dhe çështjet e brendshme. Duke patur parasysh progresin e bisedimeve Kosovë-Serbi, pritet që situata në këtë aspekt të përmirësohet në vitet që vijnë, gjë që do të kontribuojë në unifikimin dhe konsolidimin e mëtutjeshëm të Sundimit të Ligjit në tërësinë e vendit. Gjithashtu, zbatimi i dispozitave të Kodit të ri Penal (KP) dhe Kodit të Procedurës Penale (KPP) ende përbën vështirësi si për implementuesit ashtu edhe për qytetarët.

Duke pasur parasysh kohën e hyrjes në fuqi të Kodeve, konsiderohet se institucionet relevante ende nuk janë plotësisht të familiarizuara me KP dhe KPP, dhe ligjet e tjera relevante ende nuk janë plotësisht të harmonizuara me to. Për më tepër, edhe qytetarët kanë nevojë të informohen dhe vetëdijësohen për sistemin e ri të gjykatave dhe prokurorive. Pastaj, në Ligjin e ri për Gjykatat, në mes tjerash, do të ketë dispozita që parashohin publikimin e aktvendimeve të gjykatave, gjë e cila kontribuon në rritjen e transparencës së gjykatave. Në përgjithësi, fillimi i zbatimit të sistemit të ri gjyqësor dhe prokurorial u ka sjellur vështirësi jo vetëm stafit të gjykatave dhe prokurorive përballë qytetarëve, por edhe ansjelltas. Të gjitha këto aspekte duhet të adresohen përmes hartimit të një strategjie komunikimi për tërë sistemin e drejtësisë.

**Sistemi i ndihmës juridike** në Kosovë është ende në zhvillim e sipër dhe ka nevojë për përmirësim dhe avancim të mëtejshëm për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës. Infrastruktura fizike për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) mbetet një nga sfidat kryesore. Prandaj, kërkohet rritje e bashkëpunimit në mes të kësaj agjencie me institucionet tjera në mënyrë që të lehtësohet qasja e qytetarëve në sistemin ndihmës juridike.

Shoqëria e Kosovës viteve të fundit është duke u përballur me disa vështirësi të cilat do të duhej adresuar në vitet që vijnë. Këto vështirësi janë: **dhuna në familje, dhuna ndaj fëmijëve, qasja e limituar e fëmijëve në sistemin e drejtësisë, trafikimi me qenie njerëzore dhe shumë aspekte tjera me pasoja sociale.** Në përgjithësi, korniza rregullatore për adresimin e këtyre çështjeve është ende e pakompletuar. Me hartimin e Kodit Civil shumë çështje të fëmijëve si p.sh. alimentacioni, çështjet e trashëgimisë dhe adoptimi, do të rregullohen si duhet. Harmonizimi i Kodit për të Drejtat e të Miturve me Kodin Civil, që pritet të hartohet në vitet në vijim, do të përmirësonte dukshëm qasjen e fëmijëve në drejtësi.

Sa i përket **Drejtësisë për të Mitur**, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijëve në Kushtetutën e saj. Në përputhje me këtë është nxjerrë Kodi i Drejtësisë për të Mitur. Megjithatë, problemet vazhdojnë, sidomos në këto

aspekte: i) mungesa e shërbimeve dhe iniciativave të parandalimit; ii) kapacitetet e kufizuara të Qeverisë për të monitoruar dhe raportuar mbi çështjet e drejtësisë për fëmijët dhe mbrojtjes së fëmijëve; iii) vështirësitë e zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur nga gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar. Edhe pse Drejtësia për të Mitur tani shihet si prioritet, nevojitet ndërtimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve për të evituar vështirësitë e sipërpërmendura.

**Integrimi i veriut** në Sundimin e Ligjit të Kosovës mbetet një nga **mega-sfidat** e institucioneve të Kosovës. Në këtë drejtim kërkohet përmirësimi i infrastrukturës fizike për gjykata, prokurori, polici (përfshirë policinë kufitare), doganat, Agjencionin e Ushqimit dhe fusha tjera që ndërlidhen me sektorin e Sundimit të Ligjit. Është me rëndësi të theksohet, se integrimi i veriut në hierarkinë insitucionale të Kosovës është prioritet mbi prioritete për Institucionet e Kosovës, të cilat janë tejet të përkushtuara për integrimin, unifikimin dhe konsolidimin e Sundimit të Ligjit në tërësinë e tij në tërë territorin e Kosovës.

**Angazhimi i shoqërisë civile** në përforcimin e Sundimit të Ligjit mbetet ende i limituar. Kjo për arsye se qasja e Shoqërisë Civile në zhvillimet e institucioneve të Sundimit të Ligjit është e kufizuar. Për më tepër, Shoqëria Civile në Kosovë ende nuk është e profilizuar sa duhet në specifikat e Sundimit të Ligjit dhe bashkëpunimi institucione-shoqëri civile ka nevojë për thellim të mëtejshëm. Edhe pse një strategji për bashkëpunim me shoqërinë civile është krijuar, ende nevojitet asistencë, sidomos për të kontribuar në profilizimin dhe specializimin e mëtutjeshëm të aktorëve të shoqërisë civile në Sundimin e Ligjit, pastaj në zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të tyre të monitorimit dhe avokimit, si dhe në rritjen e mundësive të bashkëpunimit mes Shoqërisë Civile dhe Institucioneve të Kosovës për çështje që janë me interes publik.

Për të përmirësuar qasjen në drejtësi, institucionet e Sundimit të Ligjit, përpos politikave, legjislacionit adekuat dhe mekanizmave efektivë institucional, duhet të kenë një strategji komunikimi që do të përfshinte të gjithë aktorët, përfshirë tri pushtetet (legjislativin, ekzekutivin, gjyqëorin) shoqërinë civile dhe mediat. Kjo do të rriste dukshëm bashkëpunimin brenda e ndërinsitucional, me shoqërinë civile dhe mediat në përgjithësi dhe do të lehtësonte qasjen dhe mirë-informimin e qytetarëve të Kosovës për sistemin e drejtësisë.

## **6. LIDHJA ME DOKUMENTE STRATEGJIKE**

Hartimi i kësaj strategjie është bërë në përputhje të plotë me një varg dokumentesh strategjike të BE-së dhe Kosovës, të cilat janë listuar më poshtë:

### **6.1 Lidhja me Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme (DPPA) 2014-2016 dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2014-2016**

Deklarata e Politikave Afatmesme Prioritare (DPPA) përcakton kornizën e politikave dhe projekteve të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës planifikon t'i zbatojë gjatë periudhës së ardhshme afatmesme 2014-2016. Ky dokument është mekanizmi kryesor që udhëzon Qeverinë në planifikimin e buxhetit dhe në orientimin e burimeve të tjera buxhetore për periudhën e ardhshme tre vjeçare. Ndërkohë që, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2014-2016 është dokumenti kryesor që bën ndërlidhjen mes politikave dhe prioriteteve qeveritare me planin buxhetor të vendit. Njëra nga katër fushat kryesore të DPPA-së dhe KASH-it për periudhën 2014-2016 është qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit. Prandaj, kjo strategji është në përputhje me dokumentet kryesore planifikuese dhe buxhetore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pra DPPA-në dhe KASH-in.

### **6.2. Lidhja me Strategjinë Kombëtare për Integrim Evropian- Kosova 2020**

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Integrim Evropian, konfirmohet suksesi i arritur në fushën e Sundimit të Ligjit, kryesisht në zhvillimet ligjore dhe themelimin e mekanizmave institucional, përfshirë reformën e gjyqësorit dhe fushat tjera, sikundër që theksohet nevoja për përforcimin e mëtejshëm të Sundimit të Ligjit në tërësinë e tij. Prandaj, sipas kësaj strategjie, deri në vitin 2020 Kosova do të vendosë një sistem efektiv të sundimit të ligjit.

### **6.3. Lidhja me Dokumentin Strategjik Shumëvendësh (*BE-Multi Country Strategy Paper*)**

Në këtë dokument theksohet nevoja e vendeve të Ballkanit Perëndimor për reforma përfshirëse, transparente dhe ambicioze në fushën e drejtësisë me qëllim të sigurimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm, eficient, dhe llogaridhënës. Poashtu, ky dokument shtron nevojën për koordinimin e përpjekjeve për të krijuar një kornizë të fuqishme për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat mbesin shqetësim serioz për vendet e zgjerimit. Sipas këtij dokumenti, vendet e zgjerimit duhet që, përpos reformave vendore, të punojnë fuqishëm dhe në rrafshin rajonal për të parandaluar dhe luftuar këto dukuri negative. Pra, kjo strategji për asistencë është në linjë me dokumentin e sipërpërmendur të BE-së.

### **6.4 Lidhja me Strategjinë e BE-së për zgjerim dhe sfidat kryesore 2012-2013**

Edhe në strategjinë për zgjerim të BE-së shtrohet qartë nevoja për forcimin e Sundimit të Ligjit dhe Qeverisjes së Mirë, si fushat kryesore në procesin e zgjerimit të BE-së. Pikërisht për këtë arsye, gjatë negociatave për anëtarësim, kapitujt për fushën e Sundimit të Ligjit,

dhe jo vetëm këta kapituj, do të hapen krejt në fillim të procesit dhe do të mbyllen krejt në fund, për t'u siguruar kështu se reformat janë të qëndrueshme dhe të pakthyeshme.

### **6.5 Lidhja me Dokumentin Strategjik Vendor (*Country Strategy Paper*)**

Sikurse në dokumentet e mësipërme, edhe në këtë dokument theksohet nevoja për përmirësimin e Sundimit të Ligjit në Kosovë në përgjithësi. Sipas këtij dokumenti, një gjyqësor i pavarur që punon në përputhje me standarde të vërteta demokratike dhe profesionale nuk është jetik vetëm për përforcimin e Sundimit të Ligjit për përfitim të menjehershëm të publikut, por është qenësor edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillimin ekonomik, përfshirë inkurajimin e investimeve të huaja. Asistenca financiare e BE-së përmes IPA II (2014-2020) është planifikuar të mbështes katër objektiva specifike: i) mbështetje për reformat politike; ii) mbështetje për zhvillimin ekonomik, social dhe territorial; iii) forcimi i aftësisë së vendit përfitues për të përmbushur obligimet (e ardhshme) që dalin nga anëtarësimi në BE, duke mbështetur përafrimin me legjislacionin e BE-së; dhe iv) forcimi i integritetit rajonal dhe bashkëpunimit territorial.

Prandaj, kjo strategji për asistencë është në linjë të plotë me këtë dokument dhe merr parasysh të gjitha shqetësimet dhe rekomandimet e nënvizuara në këtë strategji, përfshirë: i) sfidat me pavarësinë, efikasitetin, përgjegjësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit; ii) problemet me ekzekutimin e vendimeve të gjyqësorit; iii) numrin e madh të rasteve të pazgjidhura; iv) mungesën e bashkërendimit të reformave dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm ndër-institucional; v) nevojën për implementimin më efektiv të legjislacionit kundër korrupsionit; vi) përmirësimin e kapaciteteve të policisë dhe institucioneve të tjera vis-a-vis aktiviteteve kriminale komplekse; vii) përmirësimin e luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, krimeve ekonomike, terrorizmit, etj.

### **6.6 Lidhja me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian (KE) për Kosovën për vitin 2013**

Ashtu sikurse në Raportet e kaluara të Progresit, edhe Raporti Progresit i vitit 2013 ri-thekson nevojën për forcimin e Sundimit të Ligjit në Kosovë në tërësinë e tij. Në këtë raport janë paraqitur pothuaj të gjitha deficienat e Sundimit të Ligjit në Kosovë. Prandaj, kjo strategji është plotësisht në përputhje me të gjeturat e Raportit të Progresit 2013.

## 7. QASJA STRATEGJIKE

Hartimi i kësaj strategjie përbën hapin e parë konkret të Qeverisë së Republikës së Kosovës drejt gjithëpërfshirjes sektoriale të institucioneve të Sundimit të Ligjit. Kjo qasje strategjike është në përputhje të plotë me qasjen sektoriale të BE-së, e cila kërkohet për të gjitha fushat e administratës së një shteti aspirues. Kjo strategji do t'i paraprijë strategjisë për sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë, hartimi i së cilës pritet të bëhet pas miratimit të kësaj strategjie.

Qasja sektoriale e BE-së synon mënyrë të punës së përbashkët mes Qeverive, donatorëve dhe aktorëve tjerë. Shikuar në aspektin praktik, qasja sektoriale ndërthet në vete një strategji sektoriale me disa objektiva, një program sektorial të hartuar nga vendi partner, në këtë rast Kosova (me mbështetje të partnerëve zhvillimor), një kornizë financiare afatmesme për ndërmarrjen e reformave dhe nevojave tjera, dhe një rrjet të partnerëve zhvillimorë, të cilët së bashku me vendin partner punojnë për të shtyer reformat.

Për më tepër, qasja e gjerë sektoriale është një proces që synon të rrisë pronësinë qeveritare dhe nacionale mbi politikën e sektorit publik dhe të vendimeve për ndarjen e resurseve brenda sektorit, rritjen e koherencës mes politikave, shpenzimeve dhe rezultateve dhe reduktimin e shpenzimeve transaksionale.

Përderisa një Qeveri ka definuar një sektor dhe ka aprovuar një strategji të vetme politikash me një buxhet dhe rezultate, mbështetja e donatorëve është jetike për implementimin e strategjisë përmes asistencës teknike dhe mbështetjes për infrastrukturë fizike dhe IT-së. Sa i përket planifikimit strategjik, Institucionet e Kosovës kanë kompletuar mekanizmin për planifikimin dhe koordinimin e politikave. Poashtu, edhe në aspektin e hartimit të dokumenteve është shënuar progres, por mbetet ende punë për t'u bërë në reduktimin e numrit të strategjive dhe orientimin e tyre sipas sektorëve.

Në vazhden e politikave të zgjerimit, Bashkimi Evropian (BE) në buxhetin 2014-2020 ka paraparë një shumë të konsiderueshme të mjeteve për mbështetjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, përfshirë Kosovën. Instrumenti financiar që do të përfshijë këtë periudhë është IPA II. Prandaj, nëse do t'u referoheshim politikave të BE-së për periudhën 2014-2020 do të shohim se planifikimet e politikave dhe projeksioneve buxhetore për vendet përfituese do të bëhen sipas qasjes sektoriale. Mënyra se si do të organizohet planifikimi i politikave dhe projeksioneve buxhetore të BE-së për periudhën 2014-2020, ndër të tjera, do të bazohet në këto pika:

- 1) **Vazhdimi me instrumentin** me nivele të njëjta të burimeve që mbulojnë zhvillimin institucional dhe socio-ekonomik.
- 2) **Asistencë e orientuar drejt nevojave** dhe karakteristikave të secilit vend veç e veç.



- 3) **Forcimi i qasjes sektoriale** me proces planifikimi afatgjatë më koherent me një instrument strategjik për koordinimin e donatorëve dhe për orientimin e investimeve në sektorin privat.
- 4) **Futja e planifikimit shumëvjeçar** për të përfshirë kohëzgjatjen e kornizës tjetër financiare shumëvjeçare; me rishikim afatmesëm, dhe zhvillimin e mëtejshëm të **programimit shumëvjeçar**, si dhe për veprime të asistencës transitorë dhe zhvillimin institucional, së bashku me një **përfshirje më të mirë të përfituesve në programim** të udhëhequr nga autoritetet kombëtare më të përgatitura, që janë të ngarkuara me koordinimin e IPA-s (shih Rregulloren e BE-së për IPA II).

Përkundër progresit që është shënuar në themelimin e mekanizmave për planifikim strategjik dhe koordinim të politikave, në Kosovë ende nuk është instaluar Sistemi i Planifikimit të Integruar (IPS=Integrated Planning System). Pastaj, ka një numër të madh të strategjive të nxjerra të cilat nuk janë të harmonizuara siç duhet mes vete dhe nuk kanë qasje sektoriale.

Që nga viti 2013 Qeveria e Kosovës ka filluar të hartojë Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme (DPPA) si dokument kryesor i politikave, dhe si paraprijës i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), e cila bën lidhjen mes politikave dhe projeksioneve buxhetore. Tashmë Institucionet e Kosovës kanë filluar nxjerrjen e strategjive sektoriale sepse kjo do të ndihmojë në kanalizimin më të mirë të fondeve të donatorëve. Strategjia sektoriale për Asistencë është e para e këtij lloji në fushën e Sundimit të Ligjit në Kosovë.

## **8. VIZIONI**

Sundim i ligjit i garantuar me kushtetutë e ligje të Kosovës që promovon shoqëri të drejtë, demokratike, përparimtare dhe stabile.

## **9. MISIONI**

Vazhdim i reformave gjithëpërfshirëse për të siguruar sundim efektiv të ligjit në përputhje me praktikën më të mira të BE-së.

## **10. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE**

Për të përfshirë fushat kryesore që nevojiten për përmirësimin e Sundimit të Ligjit, në këtë strategji janë shtruar tri objektiva strategjike, të cilat në aspektin horizontal dhe vertikal mbulojnë çështjet kryesore të drejtësisë, të punëve të brendshme, dhe qasjes në drejtësi. Këto objektiva strategjike janë: **1)** Përmirësimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit, llogaridhënies dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë; **2)** Përmirësimi i parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë trafikimit me qenie njerëzore dhe narkotikë, krimit ekonomik dhe shpërlarjes së parave, kontrabandës me armë, krimit kibernetik dhe terrorizmit; dhe **3)** Përmirësimi i qasjes në drejtësi.

### **10.1. Objektivi strategjik 1: Përmirësimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit, llogaridhënies dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë**

Për të pasur reformim të suksesshëm të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, Kosova në vitet që vijnë duhet të përqendrohet në: i) përmirësimin e vazhdueshëm të pavarësisë, efektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës dhe paanshmërisë së gjyqësorit; ii) përmirësimin dhe avancimin e sigurisë dhe masave mbrojtëse për gjyqtarë, prokurorë, dëshmitarë, ankues, personelin e gjykatave; iii) përforcimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje të ndryshme gjyqësore; dhe iv) rritjen e përfaqësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në përputhje me kornizën ligjore.

Në këtë kuadër hyn edhe përmirësimi, avancimi dhe harmonizimi i legjislacionit primar dhe sekondar të sistemit gjyqësor dhe prokurorial konform praktikave më të mira të BE-së. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, përfshirë atij me Komisionet Parlamentare, dhe dixhitalizimi i këtij bashkëpunimi do të rrisnin dhe do të përmirësonin substancialisht performancën e sistemit të drejtësisë në përgjithësi. Reforma do të përfshijë tërë sistemin juridik të Kosovës, duke filluar nga Fakulteti Juridik, Institucionet Trajnuese për Arsimim

Ligjor, e deri në Gjykata, Prokurori dhe institucione tjera. Përpos aspekteve të sipërpërmendura, asistenca e donatorëve do të kontribuojë në përforcimin e kapaciteteve institucionale për zbatim adekuat të kornizës rregullore të sistemit të drejtësisë në tërësinë e tij, pastaj edhe në lehtësimin e anëtarësimit në nisma rajonale e ndërkombëtare. Programe të avancuara për zhvillim të vazhdueshëm të gjyqësorit do të mbështeten nga kontributi i donatorëve. Nga këto programe do të përfitojnë jo vetëm institucionet e drejtësisë, por edhe ato për zbatimin e ligjit dhe profesionet e lira ligjore. Nga këto programe do të përgatitet stafi vendor, të cilët pastaj me trajnimet që do i ofrojnë do të kenë efekt shumëzues nëpër institucionet e tyre. Duke marrë parasysh nevojën për infrastrukturë të nevojshme fizike dhe të IT-së pritet që kontributi i donatorëve të adresojë këtë çështje akute të sistemit të drejtësisë.

### **Rezultatet e pritura:**

- i. Korniza ligjore e sistemit gjyqësor dhe prokurorial e përmirësuar, e avancuar dhe harmonizuar sipas praktikave më të mira të BE-së.*
- ii. Mekanizmat që sigurojnë zbatimin e një sistemi të drejtësisë të paanshëm, efektiv, transparent, dhe llogaridhënës të përforcuara.*
- iii. Kapacitetet e burimeve njerëzore për përmirësimin e performancës së përgjithshme të sistemit të drejtësisë të ngritura.*
- iv. Infrastruktura fizike dhe të IT-së e përmirësuar duke kontribuar kështu, ndër të tjera, në bashkëpunim efektiv mes institucioneve të drejtësisë.*
- v. Veprimet e profesioneve të lira ligjore të harmonizuara dhe mekanizmat për mbikqyrjen e tyre të përforcuara.*

### **Lista e projekt-ideve:**

Përshkrimi i detajuar i projekt-ideve për arritjen e rezultateve të mësipërme është bërë më poshtë në Planin e Veprimit. Titujt e projekt-ideve, të renditura në bazë të prioriteteve dhe logjikës së sekuencimit për të arritur rezultatet e pritura në mënyrë sa më efikase, janë si vijon:

- 1.1.** Mbështetje për Prokurorinë Speciale të Kosovës
- 1.2.** Përforcimi i kapaciteteve për hartimin e politikave dhe legjislacionit si dhe monitorimin e zbatimit të tyre
- 1.3.** Përforcimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit gjyqësor në Kosovë
- 1.4.** Mbështetje për zhvillim të mëtejshëm të profesioneve të lira ligjore në Kosovë
- 1.5.** Avancimi i arsimimit ligjor 1
- 1.6.** Strategjia për sektorin e Sundimit të ligjit
- 1.7.** Strategji gjithëpërfshirëse për Teknologji Informative (IT) dhe Interoperabilitet (Ndërveprim)
- 1.8.** Përmirësimi i drejtësisë civile

- 1.9. Përmirësimi i çështjeve pronësore
- 1.10. Përmirësimi i infrastrukturës fizike në sistemin e drejtësisë
- 1.11. Rishikimi gjithëpërfshirës i drejtësisë penale
- 1.12. Përmirësimi i kapaciteteve për matjen e performancës dhe mbikqyrjen e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve
- 1.13. Arsimi ligjor 2: Mbështetje për Fakultetin Juridik
- 1.14. Rritja e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar
- 1.15. Regjistrimi dhe menaxhimi i të dhënave penale
- 1.16. Mbështetje për mekanizmat e mbikëqyrës në drejtësi dhe çështje të brendshme

**10.2. Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë trafikimit me qenie njerëzore dhe narkotikë, krimit ekonomik dhe shpërlarjes së parave, kontrabandës me armë, krimit kibernetik dhe terrorizmit**

Krahas përpjekjeve për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në tërësinë e tij, Qeveria e Kosovës, se bashku me ndihmën e donatorëve, do të vazhdojë ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe dukurive tjera që prekin shoqërinë tonë. Brenda mundësive buxhetore, Qeveria e Kosovës do të ofrojë mjetet e nevojshme për bashkëfinancim të projekteve/programeve të ndryshme në fushën e çështjeve të brendshme.

Përpjekje do të bëhen edhe në përforcimin e bashkëpunimit dhe vazhdimin e anëtarësimeve në asociacione dhe nisma të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare të cilat si qëllim kanë parandalimin, reduktimin dhe luftimin e të gjitha dukurive të krimit të organizuar në nivel rajonal. Rritja e bashkëpunimit në këtë drejtim nuk do të jetë e lehtë për Kosovën kur kihen parasysh vështirësitë politike të Kosovës, sidomos në raport me Serbinë, dhe qëndrimi neutral i BE-së karshi pavarësisë së Kosovës.

Për të pasur progres në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit kërkohet që institucionet e zbatimit të ligjit, gjyqësori dhe prokuroritë të kenë qasje proaktive ndaj këtyre dukurive negative. Adresimi i korrupsionit brenda gjyqësorit, policisë, prokurorisë, burgjeve, etj. dhe forcimi i kontrollit të brendshëm dhe mekanizmave disiplinorë duhet të jenë prioritet për të përmirësuar përceptimin publik dhe për të rritur besimin.

Prandaj, në vitet në vijim, përpjekjet institucionale duhet të jenë të strukturuar, të përqendruara dhe të orientuara kah rezultatet konkrete. Kjo natyrisht kërkon para së gjithash përkushtim dhe resurse shtesë për tërë zinxhirin e ndjekjes penale. Në këtë aspekt është e nevojshme ndihma e donatorëve për ngritjen e kapaciteteve institucionale në të

gjitha institucionet e sundimit të ligjit. Ndhurma kryesisht do të fokusohet në: i) Konsolidimin e mëtutjeshëm dhe avancimin e legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit; ii) përmirësimin e dukshëm të zbatimit të legjislacionit në tërësinë e tij duke forcuar mekanizmat institucional për çështje të brendshme; iii) ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore; dhe iv) krijimin e programeve të avancuara për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore të të gjitha institucioneve të zbatimit të ligjit.

Edhe këtu sikurse të objektivi strategjik 1, nga programe të avancuara për zhvillim të vazhdueshëm do të përfitojnë jo vetëm agjencitë e zbatimit të ligjit por edhe institucionet e drejtësisë aty ku është e nevojshme. Programet e zhvillimit të vazhdueshëm për agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet e drejtësisë janë të nevojshme për të pasur qasje uniforme gjatë zbatimit të kornizës legjislative. Nga këto programe do të përgatitet stafi vendor, të cilët pastaj me trajnimet që do i ofrojnë do të kenë efekt shumëzues nëpër institucionet e tyre. Duke marrë parasysh nevojën për infrastrukturë të nevojshme fizike dhe të IT-së pritet që kontributi i donatorëve të adresojë këtë çështje më se të nevojshme për agjencitë e zbatimit të ligjit.

#### **Rezultatet e pritura:**

- i) Korniza ligjore për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit e përmirësuar, avancuar dhe harmonizuar sipas praktikave më të mira të BE-së.*
- ii) Mekanizmat që sigurojnë zbatim eficient dhe efektiv të ligjit për të rritur sigurinë e përgjithshme të vendit ndaj dukurive negative të përforcuar.*
- iii) Infrastruktura e nevojshme (fizike, IT, pajisje) për një funksionim efektiv dhe të koordinuar mirë të agjencioneve të zbatimit të ligjit e përmirësuar.*
- iv) Kapacitetet e resurseve të nevojshme njerëzore për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar (përfshirë krimet e luftës), korrupsionit të nivelit të lartë etj, të ngritura.*
- v) Anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat rajonal dhe ndërkombëtarë në fushën e zbatimit të ligjit i avancuar.*

#### **Lista e projekt-ideve:**

Përshkrimi i detajuar i projekt-ideve për arritjen e rezultateve të mësipërme është bërë më poshtë në Planin e Veprimit. Titujt e projekt-ideve, të renditura në bazë të prioriteteve dhe logjikës së sekuencimit për të arritur rezultatet e pritura në mënyrë sa më efikase, janë si vijon:

**2.1.** Arsimi ligjor 3: Përforcimi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike

**2.2.** Përforcimi i menaxhimit efektiv të migracionit dhe azilit në Kosovë

**2.3** Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda

- 2.4 Rritja e llogaridhënies dhe parandalimi i keqpërdorimit të parasë publike në institucionet e Kosovës
- 2.5 Përmirësimi i sistemit penitenciar (shërbimet korrektuese dhe sprovuese)
- 2.6 Avancimi i mbrojtjes së dëshmitarëve
- 2.7 Përmirësimi i Sistemit IT të Menaxhimit të Kufirit
- 2.8 Mbështetje për parandalimin dhe luftimin e krimeve komplekse (krimet ekonomike, financiare, ekonomia joformale, krimi kibernetik, shpërlarja e parave, terrorizmi)
- 2.9 Avancimi i shërbimeve forenzike
- 2.10 Përmirësimi i sistemit të emergjencave
- 2.11 Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore
- 2.12 Përmirësimi i infrastrukturës së IT-së në Policinë e Kosovës
- 2.13 Përmirësimi i infrastrukturës fizike të Policisë së Kosovës
- 2.14 Avancimi i shërbimeve doganore
- 2.15 Avancimi i sigurisë së dokumenteve personale dhe mbrojtjes së të dhënave personale

### **10.3. Objektivi strategjik 3: Përmirësimi i qasjes në drejtësi**

Përmirësimi i qasjes në drejtësi është njëri nga prioritetet e insitucioneve të Sundimit të Ligjit. Në këtë aspekt, asistenca e donatorëve do të fokusohet në përmirësimin, avancimin dhe harmonizimin e legjislacionit sipas praktikave më të mira të BE-së, duke bërë që sistemi i drejtësisë të jetë i qasshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës. Asistenca poashtu do të fokusohet në përmirësimin dhe avancimin e sistemit të ndihmës juridike, integrimin e veriut në hierarkinë e Sundimit të Ligjit në Kosovë me qasje të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Sa i perket drejtësisë për të mitur, asistenca e donatorëve pritet të forcojë kornizën ligjore dhe shërbimet për të siguruar qasje në drejtësi për kategori të ndryshme të fëmijëve, dhe të nxisë shtimin e llogaridhënies së ofruesve të shërbimeve dhe institucioneve kyçe të drejtësisë. Qeveria do të ketë rritur aftësinë për të monitoruar dhe raportuar mbi reformat e drejtësisë për fëmijët, dhe profesionistët kyç të drejtësisë do të kenë përmirësuar kapacitetet për të zbatuar legjislacionin e ri të drejtësisë për fëmijët. Aspekte tjera që pritet të adresohen përmes kësaj asistence janë çështjet pronësore, integrimi i veriut në sistemin juridik të Kosovës.

Bashkëpunimi i institucioneve të Sundimit të Ligjit me shoqërinë civile në monitorimin e politikave, legjislacionit, dhe mekanizmave institucional pritet të thellohet për të pasur efektet e duhura. Prandaj, përmirësimi i bashkëpunimit dhe dialogut të intensifikuar mes institucioneve të rendit dhe ligjit dhe shoqërisë civile do të ishte veçanërisht i rëndësishëm

në fushën e analizimit të politikave dhe ligjeve kundër korrupsionit, krimit të organizuar, qasjes në drejtësi, instrumenteve dhe masave të zbatimit, pastaj në përmirësimin e standardeve dhe forcimin e mbikëqyrjes së masave kundër korrupsionit etj.

Kjo do të ndihmojë në forcimin e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës për të luftuar në mënyrë efektive fenomenet e korrupsionit dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në këtë drejtim. Pra, projektet do të jenë kryesisht ndër-institucionale, për të adresuar problematikat e shtjelluara në projekt-idetë e listuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie që janë në kuadër të këtij objektivi strategjik e që për rrjedhojë janë ndër-institucionale.

### **Rezultatet e pritura:**

- i) Korniza ligjore për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës e përmirësuar, avancuar dhe harmonizuar sipas praktikave më të mira të BE-së*
- ii) Mekanizmat ligjorë për qasje në drejtësi në tërë territorin e Kosovës të përforcuar.*
- iii) Qasja e fëmijëve dhe femrave në drejtësi e përmirësuar.*
- iv) Sistemit i drejtësisë në tërë territorin e Kosovës i integruar, unifikuar dhe konsoliduar.*
- v) Bashkëpunimi i institucioneve të Kosovës me shoqërinë civile dhe mediat i përforcuar.*

### **Lista e projekt-ideve:**

Përshkrimi i detajuar i projekt-ideve për arritjen e rezultateve të mësipërme është bërë më poshtë në Planin e Veprimit. Titujt e projekt-ideve, të renditura në bazë të prioriteteve dhe logjikës së sekuencimit për të arritur rezultatet e pritura në mënyrë sa më efektive, janë si vijon:

- 3.1** Ngritja e kapaciteteve monitoruese dhe avokuese të shoqërisë civile
- 3.2.** Përmirësimi i komunikimit brenda-institucional, ndër-institucional dhe atij me shoqëri civile dhe media
- 3.3.** Implementim i plotë i Konventës për të Drejtat e Njeriut për interesin më të mirë të fëmijëve
- 3.4.** Parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje
- 3.5.** Parandalimi i dhunës në shkollë
- 3.6.** Mbështetje për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të krimit
- 3.7.** Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe keqpërdorimi seksual
- 3.8.** Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna
- 3.9.** Mbështetje për përkthyesit, interpretët dhe gjuhëtarët ligjorë

Arritja e rezultateve të sipërpërmendura për të tri objektivat strategjike do të varet shumë nga kontributi i donatorëve duke pasur parasysh që implementimi i kësaj strategjie varet, përpos përkushtimit të institucioneve vendore për shtyerjen e reformave përpara, pothuaj tërësisht nga kontributi i donatorëve. Projektet/programet që do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të sipërpërmendura do të jenë: asistencë teknike dhe projekte infrastrukturore (objekte dhe IT).



## **11. PROGRAMIMI I ASISTENCËS**

Duke filluar nga paslufta, në fushën e Sundimit të Ligjit ka pasur një mori donacionesh, të cilat në të shumtën e rasteve nuk kanë qenë të koordinuara sa duhet, prandaj efekti dhe ndikimi i tyre ka mundur të jetë më i madh. Andaj, përmes kësaj strategjie, asistencë e donatorëve pritet të përqendrohet kryesisht në përmirësimin, avancimin dhe harmonizimin e politikave dhe legjislacionit, zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të Sundimit të Ligjit, ngritjen e kapaciteteve profesionale në tërë gamën e fushës së Sundimit të Ligjit, përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe të IT-së aty ku është e nevojshme si dhe në fusha të tjera sipas nevojës.

E tërë asistencë e donatorëve do të planifikohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e Sundimit të Ligjit duke filluar nga faza e programimit, identifikimit, formulimit, financimit, implementimit, monitorimit dhe vlerësimit, sepse vetëm në këtë mënyrë do të maksimalizohet përfitimi nga asistencë, sikundër që do të rritet efekti dhe ndikimi i asistencës në forcimin e Sundimit të Ligjit në tërësinë e tij. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që në krahasim me vitet e kaluara ta rrisë në mënyrë të konsiderueshme pronësinë gjatë programimit dhe koordinimit të donacioneve në sektor në radhë të parë si dhe zbatimin të projekteve/ programeve në sektor duke vënë në dispozicion resurset e nevojshme për të gjitha projektet/programet që do të rezultojnë nga kjo strategji dhe jo vetëm. Vetëm me një pronësi lokale proaktive do të rritet progresi në sektorin e Sundimit të Ligjit i cili, ndër të tjera, do të përshpejtojë rrugëtimin e Kosovës drejt anëtarësimit në BE.

### **11.1. KONTRIBUTI I DONATORËVE DHE MISIONEVE NDËRKOMBËTARE**

Që nga paslufta e deri më tani në Kosovë veprojnë një sërë donatorësh dhe misionesh ndërkombëtare të cilët ofrojnë mbështetje në fusha të ndryshme. Donatorët kryesorë në sektorin e Sundimit të Ligjit janë: BE, GIZ, OSBE, USAID, Agjencitë Implementuese të Kombeve të Bashkuara (UNDP, UNICEF, UNOPS, etj.), SWISS International Cooperation, Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, ICITAP, etj.

#### **11.1.1 BE**

Institucionet e Kosovës janë përfituese të asistencës së BE-së që nga viti 2000 e deri më sot. Në kuadër të procesit të Integritimit Evropian, Kosova është duke kaluar nëpër dy procese të rëndësishme: i) procesi i liberalizimit të vizave; dhe ii) negociimi i Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (MSA). Sektori i Sundimit të Ligjit është pjesë e të dy proceseve të sipërpërmendura. Prandaj, për të përmbushur obligimet që rrjedhin nga procesi Integritimit Evropian, Institucionet e Kosovës do të mbështeten nga BE në funksion të përfundimit të suksesëshëm të proceseve të sipërpërmendura dhe proceseve tjera që pasojnë. Pra, ndihma e BE-së për sektorin e Sundimit të Ligjit kryesisht do të përqendrohet në përmbushjen e

standardeve evropiane në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, duke mos përfshirë edhe përmirësimin e infrastrukturës fizike aty ku është e mundur.

#### **11.1.2. EULEX**

Misioni i EULEX-it ofron mbështetje për sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë. Për më tepër, ky mision është duke ofruar mbështetje sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, procesit të Integritimit Evropian të Kosovës, Dialogut Kosovë-Serbi, Dialogut të Strukturuar për Sundim të Ligjit. EULEX-i vazhdon të ketë në fokus luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe arritjen e një qëndrueshmërie për institucionet e Sundimit të ligjit sipas praktikave më të mira të BE-së.

#### **11.1.3. GIZ**

Deri në vitin 2017, GIZ kryesisht do të ofrojë i) mbështetje për Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE) për të mbikëqyrur procesin e para-anëtarësimit dhe implementimin e nevojave që dalin nga ky proces; ii) mbështetje për gjyqësorin dhe administratën në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre në kontekst të para-anëtarësimit; dhe iii) mbështetje për Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës për të përmbushur përgjegjësitë monitoruese dhe legjislative në mënyrë efikente dhe kompetente.

#### **11.1.4. MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME TË NORVEGJISË**

Në kuadër të mbështetjes së Institucioneve të Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë është duke implementuar projektin për Menaxhimin e Lëndëve në Gjykata dhe Prokurori për periudhën 2012-2017.

#### **11.1.5. OSBE**

Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është duke punuar ngushtë me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe shoqërinë në nivele të ndryshme sa i përket luftimit të trafikimit me qenie njerëzore. OSBE poashtu mbështet sistemin gjyqësor për të siguruar pavarësinë e tij, paanshmërinë dhe llogaridhënien. Për më tepër ky mision monitoron rregullisht punën e gjyqësorit, prokurorëve dhe avokatëve për të parë nëse puna e tyre është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

#### **11.1.6. SWISS International Cooperation**

SWISS International Cooperation përmes projekteve të ndryshme është duke kontribuar në i) zhvillimin dhe implementimin e një sistemi funksional të noterisë; ii) ngritjen e kapaciteteve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në mënyrë që institucionet të performojnë në mënyrë më efikase, transparente dhe të përgjegjshme, duke konsideruar aspektet gjinore dhe forcimin e monitorimit dhe mekanizmave të mbikëqyrjes; iii) mbështetje në çështjet pronësore; dhe iv) fushatë informuese mbi migracionin e parregullt në Kosovë.

### **11.1.7. UNDP**

Sa i përket Qeverisjes Demokratike, objektivat kryesore të UNDP-së në Kosovë janë të mbështes: i) zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe komunitare për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë dhe avancimin e drejtësisë për femra; ii) arsimimin e vazhdueshëm ligjor për gjykatës dhe përforcimin e pavarësisë dhe efektivitetit të gjyqësorit; iii) tejkalimin e sfidave të institucioneve që dalin nga procesi i integritetit Evropian, sidomos në fushat e reformës së administratës publike dhe siguri; iv) kapacitetet institucionale dhe ato të shoqërisë civile për të adresuar dhunën në familje dhe trafikimin e qenieve njerëzore; v) institucionet e Kosovës për të kontrolluar përhapjen dhe qarkullimin e armëve të vogla sipas standardeve ndërkombëtare; vi) përpjekjet kundër korrupsionit; dhe vii) proceset për drejtësi tranzicionale dhe ballafaqimi me të kaluarën.

### **11.1.8. UNICEF**

Aktualisht UNICEF-i është duke kontribuar në konsolidimin e reformave të arritura për fëmijët që kanë rënë ndesh me ligjin, shkelje këto të sanksionuara me Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Paralelisht UNICEF-i do të përqendrohet te fëmijët e tjerë të cilët poashtu mund të jenë në kontakt me sistemin e drejtësisë penale dhe të drejtat e të cilëve nuk janë specifikuar si duhet. Pas vitit 2016, përqendrimi i UNICEF-it do të jetë në këto fusha: i) integrimi në axhendën e Sundimit të Ligjit të qasjes në drejtësi për fëmijët; ii) vëmendje do u kushtohet çështjeve të qasjes në drejtësi veçanërisht fëmijëve të marginalizuar; iii) zgjerimi i grupit të profesionistëve ligjor dhe paraligjor për qasjen e fëmijëve në drejtësi; iv) mbështetje për shoqërinë civile dhe mediat për të adresuar qasjen e fëmijëve në nevojat e drejtësisë; dhe v) hulumtimi i mëtejshëm për qasjen e fëmijëve në drejtësi.

### **11.1.9 UNOPS**

UNOPS është krahu operacional i Kombeve të Bashkuara duke ndikuar partnerët e tij në implementimin e ndihmave dhe projekteve zhvillimore në nivel global. Në Kosovë UNOPS është aktiv që nga viti 1999, duke ndihmuar institucionet e Kosovës në arritjen e objektivave zhvillimore dhe paqe-ndërtuese. Në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës UNOPS ka mbështetur krijimin e një sistemi gjyqësor dhe prokurorial të pavarur duke menaxhuar procesin e ri-emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, projekt ky i bashkëfinancuar nga BE dhe USAID dhe i përfunduar në vitin 2010. Edhe ndërtimi i Burgut të Sigurisë së Lartë i financuar nga BE dhe Qeveria e Kosovës është menaxhuar nga UNOPS. UNOPS ka mbështetur dhe projekte tjera siç është regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, pastaj projekte që kanë të bëjnë me mjedis, qeverisje të mirë, aksione të de-minimit, shëndetësi, arsim, etj.

### **11.1.10. USAID**

Për periudhën 2014-2018 USAID ka planifikuar mbështetje të mëtejme për sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë. Njëra nga Objektivat Zhvillimore të kësaj strategjie është “Përmirësimi i sundimit të ligjit dhe qeverisjes për të përbushur nevojat e qytetarëve”. Me konkretisht do të ofrohet asistencë për një i) gjyqësor më eficient, transparent, të pavarur dhe llogaridhënës; ii) administrim më të mirë të gjykatave dhe institucioneve të gjyqësorit; iii) ngritje të kapaciteteve të profesionistëve në sektorin e drejtësisë; dhe iv) përmirësim i legjislacionit në fusha kyçe për të pasur një zbatim më të mirë.

#### **11.1.11. ICITAP**

International Criminal Investigative Training Assistance Program (ICITAP) është duke mbështetur Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës në zhvillimin e tyre, përfshirë zhvillimin e shërbimeve për menaxhimin e kufirit dhe imigracionit, krijimin e një sistemi të integruar të IT-së për të mundësuar hetime penale efektive, trajnimin e policëve dhe prokurorëve për t’ju përgjigjur krimit të organizuar dhe atij financiar si dhe mbështetje për përforsimin e komuniteteve lokale në ballafaqimin me aspekte të sigurisë dhe konfliktit etnik.

## **12. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI**

Monitorimi dhe vlerësimi janë komponente fundamentale në implementimin e një strategjie dhe synojnë matjen e progresit të arritur. Në përputhje me këtë, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Integritimit Evropian, në baza të rregullta do ta monitorojnë zbatimin e Planit të Veprimit të kësaj strategjie.

Për dallim nga strategjitë tjera, implementimi i Planit të Veprimit të kësaj strategjie do të varet shumë nga orientimet dhe kontributet e donatorëve në fushën e Sundimit të Ligjit, pra më konkretisht nga kontributet e donatorëve në implementimin e projekt-ideve të identifikuar në Planin e Veprimit të kësaj strategjie. Për të siguruar monitorim të mirëfilltë të planit të veprimit, janë definuar indikatorët për të monitoruar implementimin e strategjisë. Këta indikatorë do të mundësojnë monitorimin e progresit duke parë nivelin e arritjes së objektivave strategjike dhe implementimit të aktiviteteve të kësaj strategjie.

Monitorimi dhe vlerësimi konsistent i kësaj strategjie i jep jetë Planit të Veprimit dhe u ofron mbikqyrësëve të kësaj strategjie një pasqyrë që u mundëson atyre të veprojnë me kohë, sipas nevojës dhe sfidave me të cilat përballlet sektori i Sundimit të Ligjit tani dhe në të ardhmen. Plani i Veprimit të kësaj strategjie është i ndërtuar sipas projekt-ideve, progresi i të cilave do të monitorohet rregullisht në takimet vjetore që do të udhëhiqen nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ministria e Drejtësisë (MD) do të jetë bartëse e monitorimit dhe vlerësimit të kësaj strategjie. Departamenti për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP) të MD-së do të mbledh të dhëna për projektet nëpër institucionet e Sundimit të Ligjit dhe këto të dhëna do të kondenzohen në raporte të konsoliduara dhe do të prezantohen në takimet vjetore që do të drejtohen nga MD. Institucionet tjera duhet të caktojnë nga një Zyrtar Përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të donatorëve në institucionet e tyre si dhe raportimin në DIEKP të MD-së.

Zyrtarët Përgjegjës do të dërgojnë të dhënat në DIEKP, ndërkohë që DIEKP do të përgatisë një raport të kondenzuar dhe konsoliduar, të cilin Ministri i Drejtësisë do ta prezantojë në takimin vjetor me Institucionet e Sundimit të Ligjit, në të cilat përpos institucioneve të sundimit të ligjit do të marrin pjesë edhe donatorët që mbështesin sektorin e sundimit të ligjit, Shoqëria Civile dhe mediat. Të dhënat që Zyrtarët Përgjegjës duhet të dërgojnë në DIEKP përfshijnë: progresi i projektit në institucionin e tyre përkatës, efektet, ndikimi, vështirësitë, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet. Zyrtarët Përgjegjës do të marrin të

dhëna edhe nga donatorët të cilët poashtu përmes sistemeve të tyre të brendshme dhe të jashtme monitorojnë fondet e tyre nëpër institucionet e Kosovës. Në mënyrë që të kemi një monitorim të mirëfilltë të implementimit të projekteve, Zyrtarët Përgjegjës nëpër institucionet e tyre duhet që të marrin pjesë nëpër takimet e rregullta që kanë menaxhmentet e projekteve të ndryshme që operojnë brenda institucioneve të tyre si dhe të kenë qasje në raportet e progresit të të gjitha projekteve. Kjo strategji është një dokument i gjallë dhe do të rishikohet dhe plotësohet në baza vjetore.

Pasi që të gjitha veprimet e kësaj strategjie do të implementohen prej projekteve/programeve të komunitetit të donatorëve, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet gjithëpërfshirjes institucionale (përfshirë shoqërinë civile) me qëllim që i) projektet/programet të përmbushin objektivat në tërësinë e tyre, dhe ii) implementimi i projekteve/programeve të jetë i koordinuar mirë me të gjithë donatorët në sektorin e Sundimit të Ligjit. Për pikën e dytë Ministria e Integritimit Evropian (MIE) do të luajë rol kyç në koordinimin e donacioneve në këtë sektor.

Krejt në fund të implementimit të kësaj strategjie do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm për të parë se sa ka kontribuar kjo strategji në forcimin e Sundimit të Ligjit, cilat kanë qenë sukseset, vështirësitë, ndikimi, qëndrueshmëria, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për strategji të ardhshme. Në bazë të rezultateve të këtij vlerësimi gjithëpërfshirës institucionet e Kosovës dhe donatorët do të jenë në gjendje të planifikojnë dhe orientojnë asistencën pas vitit 2019.

### **13. INDIKATORËT E PROGRESIT**

Për të monitoruar dhe vlerësuar masën e implementimit të kësaj strategjie janë definuar këta indikatorë:

1. Rastet e pazgjidhura për më shumë se një vit për kokë banori.
2. Rastet e trajtuara nga institucionet e auditimit dhe ato kundër korrupsionit.
3. Numri i rasteve të regjistruara dhe procesurara në sistemin e menaxhimit të lëndëve për vit.
4. Përmirësimi i rangimit të Kosovës në Indeksin e Përceptimit të Korrupsionit nga Transparency International.
5. Përmirësimi i rezultatit aktual të Kosovës në Global Integrity Report.
6. Rritja e deklarimeve të pasurisë nga zyrtarët publik.
7. Rritja e pasurisë së konfiskuar, sekuestruar dhe ngrirë në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar/ për kokë banori – GRECO dhe Eurostat
8. Numri i rasteve të pazgjidhura të gjyqësorit, si përqindje e numrit total të rasteve në sistemin gjyqësor (%) CEPEJ të Këshillit të Evropës.
9. Përmirësimi i notës për Sundim të Ligjit (perceptimi për zbatimin e kontratave, të drejtat pronësore, polici, gjykata, dhe probabiliteti për krim dhe dhunë) – the World Bank Institute.
10. Numri i projekteve suksesëshëm të implementuara për asistencë teknike, infrastrukturë fizike dhe IT.
11. Progresi në sektorin e Sundimit të Ligjit sipas BE-së.
12. Misionet Vlerësuese të Ndryshme ndërkombëtare dhe vendore për fusha specifike të Sundimit të Ligjit
13. Përmirësimi i indikatorit për nivel të qasjes dhe përballueshmërisë financiare të drejtësisë (World Justice Project – nëse Kosova përfshihet në këtë Index në vitet në vijim)
14. Numri i emigrantëve ilegal të kapur si përqindje e popullsisë (nga të dhënat administrative).
15. Numri i tentimeve për kalim ilegal të kufirit për popullsi.
16. Përqindja e pranimit të aplikacioneve për azil (awards/applications - %) – UNHCR.
17. Përqindja e stafit të institucioneve të drejtësisë dhe atyre për zbatimin e ligjit që janë zgjedhur, emëruar dhe promovuar në funksionet të Sundimit të Ligjit bazuar në kritere objektive dhe transparente.
18. Përqindja e rasteve të caktuara përmes sistemit elektronik për ndarjen e lëndëve.

- 19.**Satisfaksioni i institucioneve të drejtësisë dhe atyre të zbatimit të ligjit me përmbajtjen e programeve për zhvillim të stafit dhe cilësinë e trajnimeve.
- 20.**Ndarja e kërkesave për ndihmë juridike falas të ofruar nga autoritetet publike.
- 21.**Legjislacioni i përmirësuar, avancuar dhe harmonizuar me praktikën më të mirë të BE-së.
- 22.**Sistemi i Sundimit të Ligjit në Veri të Kosovës i konsoliduar dhe funksional.
- 23.**Numri i programeve të ndryshme për ngritje të kapaciteteve të hartuara dhe në përdorim.
- 24.**Strategjitë për fusha specifike të hartuara dhe në zbatim.
- 25.**Mekanizma çertifikimi (p.sh. për përkthyes dhe interpreto gjyqësorë).



#### **14. SUPOZIMET DHE RREZIQET**

Si në çdo strategji tjetër, edhe në këtë strategji janë definuar supozimet dhe rreziqet (assumptions and risks) të cilat do të mund të kishin potencial për të ndikuar negativisht (madje edhe ndikim vendimtar) në arritjen e suksesit gjatë fazës së implementimit të strategjisë.

Supozimet kritike në nivel të objektivave strategjike janë:

- Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të mbështesë reformat në sistemin e drejtësisë në tërësinë e tij.
- Vullneti politik për të forcuar sektorin e Sundimit të Ligjit.
- Institucionet e Sundimit të Ligjit janë të interesuara të marrin pjesë në mënyrë proaktive në implementimin e kësaj strategjie.
- Nëse e nevojshme, Qeveria e Kosovës siguron bashkëfinancimin për projektet/programet e komunitetit të donatorëve.
- Institucionet e Sundimit të ligjit në Kosovë realizojnë me sukses planet dhe objektivat e tyre për periudhën 2014-2016 si parakusht për fillimin e implementimit të projekteve pasuese 2016-2019

Sa i përket rreziqeve të cilat mund ta ndikojnë negativisht implementimin e kësaj strategjie, duhet theksuar se ato kryesisht kanë të bëjnë me:

- Kapacitetet e kufizuara teknologjike dhe
- Burimet njerëzore joadekuata në institucionet e Sundimit të Ligjit.

Prandaj, institucionet e Sundimit të Ligjit pritet që gjatë periudhës 2016-2019 të ndër marrin të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar rreziqet e sipërpërmendura. Gjithsesi, veprimet për minimizimin e rrezikut zakonisht kërkojnë kosto shtesë, prandaj këto veprime jo gjithmonë janë të lehta për t'u aplikuar.

Për më tepër, minimizimi i rrezikut përmes shmangies së problemeve reale mund të jep rezultate më të shpejta, mirëpo kjo shmangie nuk është gjithnjë në interesin e ndikimit eventual të kësaj strategjie, prandaj për arsye të parapërmendura, nevoja për ndryshime në përmbajtjen e kësaj strategjie gjatë implemetimit të saj do të merret parasysh.

## **15. QËNDRUESHMËRIA**

Implementimi i strategjisë pritet të sigurojë që implementimi i projekteve dhe programeve të komunitetit të donatorëve është në përputhje me prioritetet e Sundimit të Ligjit dhe si i tillë është i qëndrueshëm. Institucionet e Sundimit të Ligjit do të përpiqen të zhvillojnë kapacitetet e tyre me mbështetje të donatorëve, kapacitete të cilat do të vazhdonin të operonin efektivisht edhe pas implementimit të kësaj strategjie.

Nevojat për ngritje të kapaciteteve, si në fushën e burimeve njerëzore ashtu edhe në fushat tjera, do të analizohen para dhe gjatë implementimit të projekteve dhe programeve. Në mënyrë që kjo strategji të jetë e qëndrueshme, kërkohet që të gjitha institucionet e Sundimit të Ligjit të jenë të përfshira në të gjitha fazat e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve që pritet të rezultojnë nga kjo strategji.

Sa i përket shfrytëzimit të teknologjisë informative (IT) gjatë implementimit të strategjisë do të merren parasysh këto kritere: kost-efiçenca, aplikueshmëria e tyre në institucionet e sundimit të ligjit, përputhshmëria me legjislacionin në fuqi si dhe me teknologjinë dhe metodat ekzistuese që janë në përdorim. Kjo konsiderohet të jetë qenësore dhe do të bëjë diferencën mes shfrytëzimit aktual dhe zhvillimit të mëtejshëm të rezultateve të arritura.

Për më tepër është e nevojshme të instalohen vetëm ato pajisje teknologjike të cilat mund të shfrytëzohen nga institucionet e Sundimit të Ligjit për t'u siguruar që softwer-et dhe pajisjet tjera teknologjike të blera mund të sipërmerren dhe mirëmbahen nga institucionet e Sundimit të Ligjit. Kjo parasheh që zyrtarët përgjegjës të këtyre institucioneve të trajnohen nga projekte dhe programe të ndryshme për përdorimin e pajisjeve teknologjike dhe përshtatjen e tyre me softwer-et ekzistues.

Institucionet e Sundimit të Ligjit janë të vetëdijshme se për t'i realizuar pritjet e kësaj strategjie kërkohet bashkëpunim i ngushtë brenda-institucional dhe ndër-institucional për të forcuar edhe më tej sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë. Për më tepër, menaxhmenti i institucioneve të Sundimit të Ligjit pritet që të rrisë përkushtimin duke ngritur njohuritë dhe dijet e stafit të tyre, duke përforcuar komunikimet dhe koordinimet e brendshme në mënyrë që të sigurohen vendimet efektive të politikave në fushën e Sundimit të Ligjit. Në qoftë se efektet dhe ndikimi i kësaj strategjie do të jenë të qëndrueshme, atëherë Kosova do të avancojë me hapa të sigurtë në rrugëtimin e saj drejt anëtarësimit të plotë në BE.

## **16. SHTOJCAT**

### **16.1. TABELA E PROJEKT-IDEVE SIPAS PRIORITETEVE, BUXHETIT DHE SEKUENCIMIT**

Në tabelën e mëposhtme (shih faqe 52-53) janë paraqitur projektet sipas prioritetit që kanë ndër vite. Ka disa projekte që pritet të fillojnë në vitin 2014. Është e rëndësishme të sqarohet se nëse një projekt i BE-së p.sh. fillon të programohet në vitin 2014, atëherë implementimi i tij tentativisht fillon në vitin 2016 dhe përfundimi i tij në vitin 2018 (mund të jetë edhe më gjatë). Pra, kjo formë e programimit është në përputhje me kohën e implementimit të kësaj strategjie, 2016-2019. Jo të gjithë donatorët kanë metodologji dhe rregulla të njëjta për programimin e asistencës së tyre, mirëpo institucionet e Kosovës do të jenë fleksibile në këtë drejtim, duke u koordinuar me politikrat dhe projeksionet e donatorëve sa u përket kohës dhe mënyrës së ndarjes së fondeve.

Në tabelë janë paraqitur edhe kostot e përafërta të projekt-ideve, të cilat varësisht prej rrethanave dhe nevojave mund të ndryshojnë. E rëndësishme është se për çdo projekt-ide të ketë gjithnjë vlerësime të thukta sa u përket nevojave të institucioneve si dhe aspekteve financiare të nevojshme para fazës së implementimit. Për më tepër, këtu është bërë sekuencimi i projekteve, duke u mundësuar kështu institucioneve të Kosovës dhe donatorëve të programojnë dhe implementojnë projektet sipas rrjedhës së nevojshme kronologjike.



OS	Titujt e projekt-ideve	Kosto	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
OS1	1.1 Mbështetje për Prokurorinë Speciale të Kosovës	1								
OS1	1.2 Përforcimi i kapaciteteve për hartimin e politikave dhe legjislacionit si dhe monitorimin e zbatimit të tyre	2								
OS1	1.3 Përforcimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit gjyqësor në Kosovë	2								
OS1	1.4 Mbështetje për zhvillim të mëtejshëm të profesioneve të lira ligjore në Kosovë	1								
OS1	1.5 Avancimi i arsimit ligjor 1	1								
OS2	2.1 Arsimi ligjor 3: Përforcimi i Akademisë për Siguri Publike	1								
OS2	2.2 Përforcimi i menaxhimit efektiv të migracionit dhe azilit në Kosovë	2.5								
OS2	2.8 Mbështetje për parandalimin dhe luftimin e krimeve komplekse (krimet ekonomike, financiare, ekonomia joformale, krimi kibernetik, shpërlarja e parave, terrorizmi)	2								
OS2	2.11a Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore	1 faza I								
OS2	2.15 Avancimi i sigurisë së dokumenteve personale dhe mbrojtjes së të dhënave personale – IPA 2013 II	2								
OS1	1.6 Strategjia për sektorin e Sundimit të ligjit	1								
OS1	1.7a Strategji gjithëpërfshirëse për Teknologji Informative (IT) dhe Interoperabilitet (Ndërveprim)	2 faza I								
OS1	1.8a Përmirësimi i drejtësisë civile	2 faza I								
OS1	1.9 Përmirësimi i çështjeve pronësore	1.5								
OS1	1.10a Përmirësimi i infrastrukturës fizike në sistemin e drejtësisë	7.5 faza II								
OS1	1.11a Rishikimi gjithëpërfshirës i drejtësisë penale	2 faza I								
OS1	1.12 Përmirësimi i kapaciteteve për matjen e performancës dhe mbikqyrjen e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve	2								
OS1	1.14 Rritja e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar	0.8								
OS2	2.4 Rritja e llogaridhënies dhe parandalimi i keqpërdorimit të parasë publike në institucionet e Kosovës	2								
OS2	2.10a Përmirësimi i sistemit të emergjencave	1 faza I								
OS2	2.11b Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore	1 faza II								
OS2	2.5a Përmirësimi i sistemit penitenciar (shërbimet korrektuese dhe sprovuese)	1.5 faza I								

OS2	2.6 Avancimi i mbrojtjes së dëshmitarëve	0.7								
OS2	2.7a Përmirësimi i Sistemit të IT për Menaxhimin e Kufirit	3 faza I								
OS2	2.9 Avancimi i shërbimeve forenzike	1.5								
OS2	2.12a Përmirësimi i infrastrukturës së IT-së në Policinë e Kosovës	4 faza I								
OS3	3.1a Ngritja e kapaciteteve monitoruese dhe avokuese të shoqërisë civile	0.8 faza I								
OS3	3.9 Mbështetje për përkthyesit, interpretët dhe gjuhëtarët ligjorë	1								
OS1	1.11b Rishikimi gjithëpërfshirës i drejtësisë penale	2 faza II								
OS1	1.7b Strategji gjithëpërfshirëse për Teknologji Informative (IT) dhe Interoperabilitet (Ndërveprim)	2 faza II								
OS1	1.8b Përmirësimi i drejtësisë civile	2 faza II								
OS1	1.10b Përmirësimi i infrastrukturës fizike në sistemin e drejtësisë	7.5 faza II								
OS1	1.13 Arsimi ligjor 2: Mbështetje për Fakultetin Juridik	1.5								
OS1	1.15 Regjistrimi dhe menaxhimi i të dhënave penale	2								
OS1	1.16 Mbështetje për mekanizmat e mbikëqyrës në drejtësi dhe çështje të brendshme	2								
OS2	2.3a Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda	2.5 faza I								
OS2	2.7b Përmirësimi i Sistemit IT të Menaxhimit të Kufirit	2 faza II								
OS2	2.5b Përmirësimi i sistemit penitenciar (shërbimet korrektuese dhe sprovuese)	1.5 faza II								
OS2	2.13 Përmirësimi i infrastrukturës fizike të Policisë së Kosovës	2								
OS2	2.14 Avancimi i shërbimeve doganore	9								
OS2	2.10b Përmirësimi i sistemit të emergjencave	1 faza II								
OS3	3.1b Ngritja e kapaciteteve monitoruese dhe avokuese të shoqërisë civile	0.8 faza II								
OS3	3.2 Përmirësimi i komunikimit brenda-institucional, ndër-institucional dhe atij me shoqëri civile dhe media	1								
OS3	3.3. Implementim i plotë i Konventës për të Drejtat e Njeriut për interesin më të mirë të fëmijëve	1								
OS3	3.4 Parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje	1								
OS3	3.5 Parandalimi i dhunës në shkolla	0.8								

OS3	3.6 Mbështetje për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të krimit	1								
OS2	2.12b Përmirësimi i infrastrukturës së IT-së në Policinë e Kosovës	4 faza II								
OS3	3.7 Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe keqpërdorimi seksual	1								
OS3	3.8 Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna	1.5								
OS2	2.12c Përmirësimi i infrastrukturës së IT-së në Policinë e Kosovës	5 faza III								
OS2	2.3b Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda	2.5 faza II								
OS3	3.1c Ngritja e kapaciteteve monitoruese dhe avokuese të shoqërisë civile	0.8 faza III								
Kostoja totale:		109.2 MEUR (Milion EUR)								

#### Shpjegim për ngjyrat dhe shkurtesat në tabelë

OS=Objektivat Strategjike  
MEUR= Milion EUR

	Koha e programimit të projektit
	Koha e implementimit të projektit

## 16.2. PLANI I VEPRIMIT ME PËRSHKRIMIN E PROJEKT-IDEVE

### 16.2.1 Përshkrimi i projekt-ideve të Objektivit Strategjik 1: Përmirësimi i pavarësisë, efikasitetit, llogaridhënies dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë

Lista e projekt-ideve të mëposhtme paraqet nevojat për asistencë në realizimin e objektivit strategjik 1, ku projekt-idetë janë të renditura sipas prioritetit që kanë. Realizimi i këtyre projekt-ideve do të duhej t'i paraprinte dhe njëkohësisht do të kontribuonte në krijimin e kushteve më të përshtatshme për implementimin e plotë të projekt-ideve tjera të përmendura, të cilat komplementojnë mirë njëra tjetrën, duke u fokusuar në mënyrë më specifike në aspekte të ndryshme të sistemit të drejtësisë, siq janë funksionimi më i mirë i i gjykatave dhe prokurorive, përmirësimi i drejtësisë penale dhe civile, përmirësimi i resurseve njerëzore dhe arsimimit ligjor, përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe IT-së në sistemin e drejtësisë, etj.

Projektet-idetë në këtë strategji janë gjithëpërfshirëse, duke lënë mundësinë e hapur që disa, ose shumica e këtyre projekt-ideve, të mund të realizohen përmes një apo më shumë projekteve më specifike dhe në disa faza.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.1 Mbështetje për Prokurorinë Speciale të Kosovës</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017
<b>Përfituesit direkt:</b>	KPK, Prokuroria Speciale, Prokurori i Shtetit
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për përforcimin e sundimit të ligjit duke avancuar ndjekjet, hetimet sa u përket rasteve të korrupsionit, krimit të organizuar, shpërlarjesë së parave dhe krimeve komplekse
<b>Qëllimi:</b>	Mbështetje për Prokurorinë Speciale të Kosovës
<b>Përshkrimi:</b>	Në kuadër të sistemit prokurorial të Kosovës ekziston Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), e cila në bazë të ligjit për PSRK-në ka autoritetin të veprjë pranë gjykatave themelore për veprat penale në tërë territorin e Kosovës. Kjo prokurori drejtohet nga Misioni i EULEX-it. Kompetencat e Prokurorëve të EULEX-it që veprojnë në kuadër të PSRK-së janë kryesisht të definuara në dy dokumente ligjore: i) ligji për juridiksionin, selektimit dhe ndarjes së rasteve nga gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë; dhe ii) ligji për PSRK-në. Prokurorët e EULEX-it kanë juridiksion të gjerë për një sërë veprash penale të parapara



në ligjet e lartpërmendura.

Duke qenë se kapacitetet e prokurorëve vendorë janë të limituara për tu përballur me krime të rënda, PSRK drejtohet nga EULEX-i dhe përqendrimin kryesor të saj e ka në fushën e korrupsionit, të krimeve të luftës, terrorizmit, krimin të organizuar dhe krimin financiar. Që nga themelimi i PSRK-së e deri me sot ka qenë e vështirë të matet niveli i ngritjes së kapaciteteve vendore që janë pjesë e PSRK-së. Duke ditur se mandati i EULEX-it do të mund përfundonte deri në vitin 2016, atëherë duhet shikuar mundësitë e lehtësimit të tranzicionit nga EULEX te prokurorët vendorë.

Duke pasur parasysh marrjen e përgjegjësive shtesë nga prokurorët vendorë në këtë Prokurori, është e një rëndësie të veçantë përgatitja e prokurorëve vendorë për një tranzicion të suksesshëm të marrjes së kompetencave shtesë dhe se kjo ndihmë do të duhej mbështetur nga asistenca e donatorëve. Asistenca do të duhej përqendruar në hetimet e krimeve të rënda, përfshirë krimin financiar, kibernetik, dhe rastet korruptive. Asistenca do të duhej mbështetur edhe policinë e gjykatat duke qenë se janë të ndërlidhura mes vete edhe sa i përket veprave penale të lartpërmendura. Këtu duhet shikuar mundësia e specializimeve jashtë vendit të disa prokurorëve, gjyqtarëve e policëve, të cilët më pas do të mund të kishin efekte shumëzuese në përgatitjen e kolegëve të tyre.

Luftimi i veprave penale të korrupsionit të nivelit të lartë, krimin të organizuar dhe shpërlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit janë prioritetet për Qeverinë e Kosovës dhe sistemin prokurorial të Kosovës. Luftimi efikas i këtyre veprave penale kërkon angazhim dhe mobilizim jo vetëm brenda kufijve të Kosovës, por edhe një bashkërendim dhe bashkëpunim me shtete të rajonit dhe më gjerë.

Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave mes PSRK-së dhe prokurorive të vendeve të rajonit dhe BE-së do të ndikonte drejtëpërdrejt në ngritjen e kualitetit të punës në PSRK dhe në arritjen e rezultateve konkrete në luftimin e veprave penale të lartpërmendura. Trajnimet dhe specializimet e prokurorëve vendorë në PSRK do të duhej të fokusoheshin kryesisht në shkëmbim të vizitave në njërin ndër shtetet e BE-së, ku prokurorët e PSRK do të merrnin përvoja lidhur me menaxhimin dhe administrimin e PSRK, si dhe në avancimin e teknikave në fazën e hetimit, mbledhjes së informatave dhe dëshmive, ngritjen e bashkëpunimit me agjencitë që zbatojnë ligjin, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar përmes shkëmbimit të informatave në luftimin e veprave penale karakteristike.

Përpos, specializimeve të jashtme do të duhej zhvilluar programe trajnimi të vazhdueshme në Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK)/Akademinë e

	<p>Drejtësisë së Kosovës (ADK) dhe Akademinë Kosovare për Siguri Publike (AKSP). Aspekt tjetër që duhet patur parasysh është edhe vazhdimi i bashkëpunimit të PSRK-së me institucione homologe ndërkombëtare sa i përket veprave të ndryshme penale. Edhe në këtë fushë kërkohet asistencë për të përgatitur jo vetëm prokurorët por edhe administratën e tyre për vazhdimin dhe përfocimin e bashkëpunimit me institucione homologe ndërkombëtare. Aktiviteteve për tranzicionin e PSRK-së nga EULEX-it te vendorët do të duhej shtuar edhe investimet në infrastrukturën e PSRK-së duke ditur se PSRK ka mungesë objekti sipas standardeve ndërkombëtare.</p> <p>Përgatitja e stafit vendor për të sipërmarrur udhëheqjen dhe menaxhimin e PSRK-së do të krijonte kushtet për një tranzicion të butë ng EULEX-i te vendorët. Pastaj, kjo do të ndihmonte në vazhdimin dhe rritjen e nivelit të parandalimit, hetimeve, ndjekjeve dhe dënimeve ndaj krimeve të lartëpërmendura. Duke pasur progres në këtë drejtim do të kontribuohet në uljen e nivelit të korrupsionit dhe krimit të organizuar të të gjitha llojeve në Kosovë.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.2 Përforcimi i kapaciteteve për hartimin e politikave dhe legjislacionit, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017
<b>Përfutuesit direkt:</b>	MD, Kuvendi i Kosovës, KGJK
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Avancimi i procesit politikëbërës dhe legjislativ në fushën e drejtësisë
<b>Qëllimi</b>	Përforcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Parlamentit të Kosovës sa u përket politikave dhe legjislacionit në sektorin e sundimit të ligjit
<b>Përshkrimi</b>	<p>Njëra nga objektivat kryesore të Ministrisë së Drejtësisë është krijimi dhe avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri me prioritetet që dalin nga procesi i Integritimit Evropian. Pra, mandati i Ministrisë së Drejtësisë është, ndër të tjera, për të zhvilluar politika brenda fushës së saj të përgjegjësisë, si dhe për të mundësuar përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë.</p> <p>Në kuadër të MD-së gjendet Departamenti për Çështje Ligjore. Në kuadër</p>

të këtij departamenti pritet të funksionalizohet Divizioni për Mbikqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit. Prandaj, njëra nga deficienat e këtij departamenti është edhe mungesa e mbikqyrjes së zbatimit të ligjeve në fushën e drejtësisë. Në të shumtën e rasteve ka raporte ndërkombëtare që flasin për nivelin e zbatimit të ligjeve në rrafshin e drejtësisë, ndërkohë që mekanizmat e MD-së në këtë drejtim mbesin të limituar.

Aspekt tjetër që mungon në MD është edhe çështja planifikimit dhe analizimit të politikave. Departamenti për Çështje Ligjore ka mungesë kapacitetesh për planifikim dhe analiza. Prandaj, në kuadër të Divizionit për Mbikqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit do të duhej krijuar një njësi për planifikim dhe analiza e cila do të kontribuonte dukshëm në përmirësimin dhe avancimin e përpjekjeve të MD-së për të përcjellur trendet vendore dhe ndërkombëtare sa i përket planifikimit të politikave dhe analizimit të tyre, sikundër që do të kontribuonte në ngritjen e cilësisë së ligjeve.

Në kuadër të KGJK-së ekziston Departamenti për Çështje Ligjore dhe Njësia për Analiza dhe Planifikim. Kjo projekt-ide duhet të mbështet edhe ngritjen e kapaciteteve të KGJK-së, si në aspektin e çështjeve ligjore ashtu edhe në ato për hulumtim dhe analiza.

Ndërkohë, Parlamenti i Kosovës ka një sërë komisionesh që merren me mbikqyrjen e punës së Ekzekutivit dhe trupave tjera të pavarura. Duke iu referuar Raportit të Progresit 2013 për Kosovën shihet se *“mbikqyrja e Qeverisë duhet të përmirësohet, përfshirë mbikqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të komisioneve nga ministritë. Parlamenti duhet të përmirësojë të kuptuarit e rolit të tij në mbikqyrjen e institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullatore. Prandaj, duhet krijuar mekanizmat adekuat”*.

Pra, aspektet e hartimit të politikave dhe legjislacionit si dhe mbikqyrjes së zbatimit të ligjeve duhet adresuar nga MD dhe Parlamenti. Kjo në radhë të parë do të ndihmonte në rritjen e cilësisë së ligjeve si dhe harmonizimin e ligjeve me *acquis* si dhe përforcimin e kapaciteteve për mbikqyrjen e zbatimit të ligjeve si njëra nga sfidat më të mëdha të institucioneve të drejtësisë, dhe jo vetëm. Një mbikqyrje efektive e ligjeve do të rriste nivelin e zbatimit të ligjeve dhe për më tepër do të identifikonte saktësisht nevojat për plotësim-ndryshimin e ligjeve ekzistuese dhe nevojën për ligje të reja.

Për arsyet që u përmenden më lartë, rrjedhimisht, kjo projekt-ide konsiderohet si prioritare. Realizimi i saj do të ndikonte drejtëpërsëdrejti në disa nga rezultatet e pritura të objektivit strategjik të parë, përfshirë këtu përmirësimin dhe harmonizimin e kornizës ligjore të sistemit gjyqësor, përforcimin e mekanizmave që sigurojnë zbatimin e një sistemi

	të drejtësisë që do të jetë i paanshëm, efektiv, transparent, dhe llogaridhënës, dhe poashtu, në rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Kjo projekt-ide poashtu komplementon dhe përputhet mirë me projekt-idetë e tjera që dalin nga kjo strategji, sidomos me ato që kanë të bëjnë me përmirësimin e mbikëqyrjes së performancës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial, avancimin e arsimimit ligjor dhe rishikimin dhe përmirësimin e drejtësisë penale dhe civile.
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.3 Përforcimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit gjyqësor në Kosovë</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017
<b>Përfituesit direkt:</b>	KPK, KGJK, Gjykatat, Prokuroritë, IGJK, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Sundimin e Ligjit duke përfortuar kapacitetet e KGJK-së, KPK-së, Zyrës së Prokurorit të Shtetit, dhe gjykatave për të siguruar pavarësinë, efikasitetin, cilësinë dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor
<b>Qëllimi:</b>	Rritja e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë përmes menaxhimit më të mirë të sistemit gjyqësor, përfortimi i mekanizmit për zhvillim në karrierë për gjyqtarët dhe prokurorët si dhe rritja e efektivitetit dhe cilësisë së procedurave gjyqësore (court proceedings)
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Ligji mbi Gjykatat dhe Prokuroritë, në fuqi nga janari 2013, ka ristrukturuar dhe reformuar në mënyrë të konsiderueshme sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. Poashtu, janë nxjerrë dhe aktet nënligjore për funksionalizimin e sistemit gjyqësor e prokurorial.</p> <p>Edhe pse tashmë ka një sistem të ri gjyqësor dhe prokurorial, funksionimi praktik i tij ka nevojë për përmirësime të mëtejme. Në Raportin e Progresit të BE-së për Kosovën për vitin 2013 lidhur me gjyqësorin thuhet se <i>“Kosova duhet të adresojë sfidat e studimit të fizibilitetit.... Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial duhet tu përgjigjen vendosmërisht sulmeve ndaj personave dhe institucioneve gjyqësore.... Kosova duhet të sigurojë zbatim eficient të legjislacionit”</i>.</p> <p>Prandaj, për të adresuar siç duhet aspektet e ngritura në Raport të Progresit kërkohet asistencë e cila do të duhej fokusuar në këto fusha: rritjen e efikasitetit të KGJK-së dhe KPK-së; të dy Këshillat duhet të implementojnë në mënyrë efektive një mekanizëm të qartë për zhvillim</p>

të karrierës për gjyqtarët dhe prokurorët; duhet rritur efikasitetin/llogaridhënien e sistemit të ri të gjykatave; dhe duhet rritur efektivitetin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit.

Për të adresuar aspektet e mësipërme do të ndërmerren këto veprime: mbështetje për strukturën dhe përmirësimin e menaxhimit të dy Këshilleve, përforsimin e qasjes së përgjithshme të Burimeve Njerëzore për stafin gjyqësor (stafi i Këshilleve, gjykatave e prokurorëve), mbështetje për KGJK, KPK në menaxhimin e implementimit të Planeve Strategjike të tyre, mbështetje për Sekretariatit e KGJK-së në zhvillimin e analizave të politikave të gjyqësorit, mbështetje për të dy Këshillat në krijimin e rregullave të qarta për transparencë dhe komunikim me publikun, ngritje e njohurive menaxheriale për KGJK e KPK për arritjen e rezultateve më të mira për performancë individuale të gjyqtarëve e prokurorëve, përmirësimi i sistemit disiplinor për prokurorët dhe gjyqtarët, mbështetje për zhvillim në karrierë për gjyqtarët dhe prokurorët, përmirësimi i efikasitetit të gjykatave përmes rishikimit të sistemit për ndarjen e rasteve, etj.

Me adresimin adekuat të aspekteve të sipërpërmendura është e pritshme që sistemi gjyqësor dhe prokurorial do të përmirësohet dukshëm në të gjitha aspektet. Kjo në tërësi do të rrisë efikasitetin, efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor e prokurorial.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.4 Mbështetje për zhvillim të mëtejme të profesioneve të lira ligjore në Kosovë</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, Institucionet e Profesioneve të Lira Ligjore
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin profesioneve të lira ligjore
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i sektorit gjyqësor duke përmirësuar kapacitetet e profesioneve të lira ligjore përmes zhvillimit të mëtejme të mekanizmit alternativ për zgjidhjen e kontesteve (Alternative Dispute Resolution) si dhe mbështetje për sistemin e noterisë, përmbaruesëve privat dhe avokatëve
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Gjykatat e Kosovës kanë vështirësi me numrin e madh të rasteve të pazgjidhura si dhe numrin e vogël të ekzekutimit të aktevevendimeve gjyqësore. Për të shkarkuar gjykatat nga volumi i madh i punëve të tyre dhe për të futur praktikën më të mira ndërkombëtare që do të ndikonin në këtë drejtim, institucionet e Kosovës kanë marrë një sërë masash për reformimin e sistemit gjyqësor në radhë të parë si dhe në krijimin e mekanizmave jashtëgjyqësor që rregullojnë fusha të ndryshme specifike.</p> <p>Në kuadër të krijimit të profesioneve të lira ligjore, institucionet e Kosovës, përpos profesionit të avokatisë që ekziston që nga e kaluara jugosllave, kanë themeluar disa profesione të lira ligjore siç janë: noteria, ndërmjetësimi, arbitrazhi, përmbaruesit privat, dhe administratorët falimentues. Këto profesione janë në fazat e para të zhvillimit të tyre duke patur vështirësi në funksionimin e mirëfilltë të tyre pjesërisht për shkak të mungesës së përvojës në këtë drejtim dhe pjesërisht për shkak të mungesës së infrastrukturës së nevojshme për zhvillim të mëtejme të tyre.</p> <p>Vlen të theksohet se edhe vetëdija e qytetarëve për ekzistimin dhe rëndësinë e këtyre profesioneve të lira është ende e ulët, dhe si rezultat i kësaj qytetarët shpesh u referohen gjykatave për punët që mund t'i kryejnë p.sh. përmes noterisë. Por edhe anasjelltas, edhe vetëdija gjykatave për rëndësinë e ekzistimit të profesioneve të lira ka ende nevojë për tu përmirësuar duke i referuar rastet në profesionet e lira ligjore.</p> <p>Sa i përket përforcimit të profesioneve të lira, mungojnë programe të</p>

	<p>avancuara për zhvillim të vazhdueshëm të këtyre profesioneve, pastaj mungon infrastruktura e IT-së për rritjen e komunikimit dhe efijencës së këtyre profesioneve.</p> <p>Për të adresuar çështjet e mësipërme kërkohet asistencë për këto aspekte: zgjerimi i qasjes në drejtësi për palët në kontest përmes multi-door courthouse (të lidhur me gjykatën) si modeli i Mekanizmit Alternativ për Zgjidhje të Kontesteve (Alternative Dispute Resolution); zvogëlimi i rasteve nëpër gjykata sa i përket rasteve civile, komerciale, familjare dhe të punës; krijimi i një sistemi të ri për funksionimin më të mirë të noterisë dhe përmbaruesve privat; përforcimi i kapaciteteve administrative dhe menaxheriale të OAK-së; rritja e njohurive praktike të avokatëve në rastet penale dhe civile; përmirësimi i trajnimit të vazhdueshëm të avokatëve; përmirësimi i standardeve etike dhe masave disiplinore për anëtarët e provimit të jurisprudencës si dhe rritja e performancës së avokatëve; si dhe ngritja e vetëdijës së publikut për ekzistencën dhe rëndësinë e profesioneve të lira duke përjashtuar këtu avokatinë si institucion që ekziston që nga e kaluara jugosllave.</p> <p>Përforcimi i profesioneve të lira ligjore të sipërpërmendura do të rriste dukshëm performancën e këtyre profesioneve, do të shkarkonte gjykatat nga volumi madh i punëve, do të profilizonte avokatët në lëmi penale e civile, do të rriste vetëdijen e qytetarëve për ekzistimin dhe rëndësinë e profesioneve të lira si dhe të rriste cilësinë e shërbimeve të profesioneve të lira ligjore. Asistenca për profesionet e lira ligjore duhet të vazhdojë deri sa këto profesione të arrijnë standarde ndërkombëtare në punën e tyre.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.5 Avancimi i Arsimimit Ligjor 1</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, Prokurorët, Gjyqtarët, IGJK, Profesionet e lira, Asociacioni Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit duke mbështetur institucionet e drejtësisë në të qenurit sa më efijent dhe efektiv në aktivitetet e tyre
<b>Qëllimi:</b>	Avancimi mekanizmave të arsimimit ligjor në sistemin e drejtësisë dhe profesioneve të lira
<b>Përshkrimi:</b>	Arsimimi ligjor për sistemin e drejtësisë ende nuk është i formës së avancuar dhe harmonizuar. Gjyqtarët dhe prokurorët, përpos procedurave

të emërimit, i nënshtrohen vetëm trajnimit fillestar. E njëjta gjë ndodh edhe me avokatët, të cilët poashtu i nënshtrohen provimit të jurisprudencës, ndërkohë që nuk ka një program për trajnim të vazhdueshëm. Sa u përket bashkëpunëtorëve profesional mund të thuhet se deri me tani nuk ka pasur trajnime programore për ngritjen e kapaciteteve profesionale të tyre.

Së fundmi në Kosovë janë themeluar, kryesisht me ndihmën e donatorëve, disa profesione të pavarura si noterët, arbitrat, ndërmjetësuesit, përmbartësit privat. Të gjitha këto veprime kanë ndodhur për të shkarkuar gjykatat nga volumi punëve. Përderisa provimi pranues dhe programet e arsimit fillestar ligjor dallojnë sa i përket kuptimit të fushës së zbatimit të përmbajtjes, vetë procesi dhe masat mbrojtëse nuk janë uniforme për të gjitha profesionet.

Edhe sa i përket kornizës legislative të sistemit të gjykatave, prokurorive me profesionet e lira ka një mosharmonizim të veprimeve. Kjo shpesh shkakton paqartësi dhe konfuzion në terren mes asaj se çfarë është përgjegjësi e gjykatës dhe çfarë e profesioneve të lira.

Pastaj, bashkëpunimi mes agjencioneve të zbatimit të ligjit me gjykata e prokurori nuk duket të jetë e mbuluar mirë nga IGJK. Në këtë drejtim mungojnë programe trajnimi të përbashkëta për gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe agjenci të zbatimit të ligjit (varësisht prej fushës). Ky aspekt do të duhej adresuar në të ardhmen sepse programet e trajnimeve të përbashkëta do të rrisnin bashkëpunimin dhe koordinimin institucional si dhe do të mundësonin qasjen uniforme ndaj ligjit për të gjitha institucionet që merren me zbatimin e atij legjislacioni.

Një aspekt që duhet adresuar mire nga IGJK-ja është ofrimi i programeve për trajnime hyrëse për gjyqtarët dhe prokurorët serbë që priten të emërohen për pjesën veriore të Kosovës. Kjo do të ndihmonte në zbatim të njëjtë të ligjit në tërë territorin e Kosovës.

Në mënyrë që sistemi i drejtësisë të jetë i avancuar duhet të ketë një shkallë të lartë profesionalizmi dhe etike të ushtruesve të prokurorëve, gjyqtarëve, dhe profesioneve të lira. Sigurimi i njëtrajtshmërisë së standardeve mbi bazën e të cilave rregullohet hyrja në këto profesione, arsimimi fillestar dhe i vazhdueshëm do të fuqizojë dukshëm efikasitetin, profesionalizmin, dhe cilësinë e ndarjes së drejtësisë së plotë.

Për të arritur standarde të larta dhe uniforme të arsimit ligjor do të duhej ndërmarrë këta hapa: harmonizimi i legjislacionit të sistemit të drejtësisë me profesionet e lira; institucionalizimi i programeve të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë; zhvillimi i një strategjie të trajnimit me kosto-efektshmëri financiare për profesionistët e fushës së drejtësisë



	<p>në Kosovë; zhvillimi i standardeve uniforme të pranimit në profesione të lira; dhe trajnime për ushtruesit e profesioneve të lira që janë të lidhura me sistemin e drejtësisë në Kosovë.</p> <p>Për të pasur një mekanizëm të avancuar të arsimimit ligjor duhet që menaxhimi i provimeve pranuese dhe ofrimi i programeve të arsimimit fillestar dhe të vazhdueshëm të bëhet nga një institucion i vetëm që do të mundësonte zhvillimin e standardeve të unifikuara për të gjithë profesionistët e sistemit të drejtësisë duke përfshirë këtu gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional dhe profesionet e lira.</p> <p>Projekt-ideja për avancimin e arsimimit ligjor do të ndikojë ndjeshëm në realizimin e rezultateve të pritura të kësaj strategjie, përfshirë: rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të sistemit të drejtësisë; zhvillimin e resurseve të nevojshme njerëzore për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit; si dhe harmonizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të profesioneve të lira. Si i tillë, kjo projekt-ide do të komplementojë shumë projekte-ide në këtë strategji që kanë të bëjnë me përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë dhe parandalimin e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.6 Strategjia për Sektorin e Sundimit të ligjit</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018
<b>Përfituesit direkt:</b>	Institucionet e sektorit të Sundimit të Ligjit
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit për të avancuar në procesin e Integritetit Evropian
<b>Qëllimi:</b>	Hartimi i Strategjisë për Sektorin e Sundimit të Ligjit
<b>Përshkrimi:</b>	Sektori i Sundimit të Ligjit në Kosovë ka qenë kompleks që nga paslufta e deri me tani. Ndarja e përgjegjësisë mes autoriteteve vendore dhe bashkësisë ndërkombëtare ka vështirësuar arritjen e një sundimi të ligjit të unifikuar dhe konsoliduar. Sfidat në veriun e Kosovës kanë ndihmuar në thellimin e kompleksitetit të këtij sektori. Si rrjedhojë, sektori i Sundimit të Ligjit asnjëherë nuk ka pasur politika të përbashkëta dhe projeksione afatmesme e afatgjata si në aspektin e politikave ashtu dhe në projeksionet buxhetore lidhur me atë se deri ku do të dëshirohej të arrihej në këtë

	<p>sektor.</p> <p>Kjo strategji për asistencë do t'i paraprijë hartimit të një strategjie për sektorin e Sundimit të Ligjit. Hartimi i strategjisë për këtë sektor do të ndihmonte institucionet e Kosovës në përmirësimin e Sundimit të Ligjit në Kosovë dhe avancimit të Kosovës drejt procesit të Integritimit Evropian. Strategjia poashtu do të adresonte të gjitha nevojat dhe sfidat e këtij sektori, adresimi i mirëfilltë i të cilave do të krijonte një mjedis më të sigurtë për tërë qytetarët e Kosovës, do të krijonte kushte më të favorshme për zhvillim socio-ekonomik dhe inkurajim të investitorëve të jashtëm për investime në Kosovë si dhe do të avanconte Kosovën në rrugëtimin drejt anëtarësimit në BE.</p> <p>Strategjia për Sektorin e Sundimit të Ligjit shihet si prioritet imediat për suksesin e projekteve të propozuara në këtë strategji. Hartimi i një strategjie të tillë do të përcaktonte projeksionet e detajuara afatmesme dhe afatgjata dhe, si e tillë, do të luajë një rol të rëndësishëm edhe në koordinimin dhe përcaktimin më të detajuar dhe të suksesshëm të projekteve të tjera përfshira në këtë strategji.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<p><b>1.7 Strategji gjithëpërfshirëse për Teknologji Informativ (IT) dhe Interoperabilitet (Ndërveprim)</b></p> <p><i>Kjo projekt-ide përfshinë të gjitha aspektet e IT-së të Objektivit Strategjik 1 e 2 të kësaj strategjie.</i></p>
<b>Vlera:</b>	<p>1 MEUR (faza I)</p> <p>2 MEUR (faza II)</p>
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	<p>Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza I)</p> <p>Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza II)</p>
<b>Përfituesit direkt:</b>	Institucionet e sektorit të Sundimit të Ligjit
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit duke dixhitalizuar komunikimin brenda- dhe ndër-institucional sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Qëllimi:</b>	Përmirësimi, avancimi dhe integrimi i bashkëpunimit brenda- dhe ndër-institucional në sektorin e sundimit të ligjit
<b>Përshkrimi:</b>	Sektorit të sundimit të ligjit i mungon një strategji gjithëpërfshirëse për IT. Deri tani, intervenimet në fushën e IT-janë janë bërë kryesisht nëpër institucione veç e veç, pa pasur mundësinë e lidhjes dhe integritimit të

sistemeve të IT-së. Kjo ka qenë njëra nga sfidat kryesore që ka penguar një komunikim eficient dhe efektiv të tërë institucioneve të sundimit të ligjit. Si pasojë e kësaj, edhe të dhënat statistikore asnjëherë nuk kanë qenë në nivelin e duhur.

Disa vende të BE-së tashmë kanë krijuar sisteme të avancuara të IT-së, të cilat janë duke gjetur shtrirje efektive në sektorin e sundimit të ligjit, dhe jo vetëm. Prandaj, kërkohet që sektori i sundimit të ligjit të dixhitalizohet në përgjithësi. Një strategji e IT-së do të kontribuonte dukshëm në këtë drejtim.

Hartimi dhe implementimi i kësaj strategjie do të duhej që pikë së pari të identifikonte të gjitha zbrazësirat ligjore dhe institucionale për të krijuar kështu një kornizë ligjore të qartë dhe jodykuptimore, pastaj të vlerësonte nevojat për pajisje të IT-së (hardwerike dhe softwerike), nivelin e resurseve njerëzore dhe mundësitë buxhetore për implementimin e strategjisë së IT-së. Strategjia e IT-së dhe interoperabilitetit do të ishte orientimi më i mirë dhe i vetëm për të gjitha projeksionet e IT-së që priten të mbështesin sektorin e sundimit të ligjit.

Që institucionet e drejtësisë dhe sigurisë të kenë sukses të plotë në punën e tyre, duhet të vendoset patjetër një bashkëpunim më i thellë në mes të gjithëve, automatizim i këmbimit të informatave, dhe integrim më i madh i gjithë strukturës së IT-së. Për të ndërtuar një sistem të IT-së sipas praktikave më të mira të BE-së, duhet të bëhet një studim fizibiliteti që do të jepte një vlerësim të saktë dhe gjithëpërfshirës për projektet pasuese.

Efektet e implementimit të strategjisë së IT-së do të ishin shumëdimensionale për sektorin e sundimit të ligjit. Para së gjithash do të dixhitalizohet bashkëpunimi brenda dhe ndër-institucional, të dhënat statistikore do të ishin kredibile, do të rritej në tërësi efienca dhe efektiviteti i sistemit të drejtësisë dhe sektorit të punëve të brendshme.

Projekt-ideja për strategji gjithëpërfshirëse për IT shihet si e një rëndësie të veçantë, dhe do të komplementojë përpjekjet e tjera për avancim të bashkëpunimit ndër-institucional dhe rritjes së efiençës dhe efektivitetit të sektorit të sundimit të ligjit në përgjithësi. Kjo projekt-ide do të komplementojë edhe projekt-idetë e tjera për IT në këtë strategji, siç janë Përmirësimi i Sistemit IT të Menaxhimit të Kufirit dhe përmirësimi i infrastrukturës së IT-së në Policinë e Kosovës.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.8 Përmirësimi i drejtësisë civile</b>
<b>Vlera:</b>	1.5 MEUR (faza I) 1.5 MEUR (faza II)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza I)  Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza II)
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, Gjykatat, Avokatët, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit duke avancuar sistemin e drejtësisë civile
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi dhe avancimi i drejtësisë civile sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Sistemi i drejtësisë civile në Kosovë mbetet ende në fazat e tij fillestare të themelimit. Në këtë drejtim kanë munguar politikat dhe legjislacioni të cilat do të ndihmonin sistemin gjyqësor për të qenë efikas sa duhet. Çështjet e drejtësisë civile janë shumë komplekse dhe zgjidhja e rasteve civile merr shumë kohë dhe palët në të shumtën e rasteve janë të pakënaqur me këto stërgjatje.</p> <p>Si njëra ndër vështirësitë kryesore me të cilën përballlet gjyqësori sa i përket drejtësisë civile është mungesa e Kodit Civil. Si pasojë e mungesës së Kodit Civil ka qenë puthuaj e pamundur edhe profilizimi dhe specializimi i gjyqtarëve dhe avokatëve në këtë lëmi komplekse. Shumë aspekte që lidhen me pronat, trashëgiminë, të drejtën familjare në përgjithësi, të drejtën komerciale, etj, nuk kanë mundur të zgjidhen në formën më të mirë të mundshme dhe shpesh ka pasur konfuzion të madh nëpër aktvendime të ndryshme gjyqësore.</p> <p>Prandaj, për të përforcuar këtë lëmi duhet që pikë së pari të analizohet gjendja aktuale, të plotësohen dhe ndryshohen ligjet aktuale si dhe të nxirret legjislacioni i ri dhe në përputhje me të gjitha këto të dizajnohet Kodi Civil i cili do të duhej të jetë i përafërt me praktikën më të mira të BE-së.</p> <p>Nxjerrja e Kodit Civil dhe harmonizimi i ligjeve respektive në këtë Kod do të ishte përparim i madh për drejtësinë civile në Kosovë. Përforcimi i sistemit juridiko-civil do të rriste dukshëm efikasitetin e gjyqësorit në zgjidhjet adekuate të rasteve civile. Kodi i ri do të ndihmonte poashtu profizilimin e gjyqtarëve dhe avokatëve, do të përmirësonte dukshëm klimën e biznesit në Kosovë, poashtu do të kontribuonte në rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë civile. Pasi që drejtësia civile</p>

	<p>konsiderohet e pazhvilluar sa duhet në Kosovë, asistenca e donatorëve do të duhej të ishte e vazhdueshme në këtë drejtim së paku deri në vitin 2020.</p> <p>Së shpejti do të fillojë së implementuari një projekt, i financuar nga IPA 2013, i cili për qëllim kryesor ka hartimin e kodit civil. Rrjedhimisht, kjo projekt-ide do duhej të fillohej pas realizimit të projektit të lartpërmendur IPA 2013, në mënyrë që të vazhdohet përmirësimi i mëtutjeshëm i drejtësisë civile. Njëkohësisht, këto projekte do të komplementonin përpjekt-idetë e tjera për të rishikuar në përgjithësi funksionimin e sferave tjera të sistemit gjyqësor, siç bën edhe projekt-ideja për rishikimin e drejtësisë penale.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.9 Përmirësimi i çështjeve pronësore</b>
<b>Vlera:</b>	1.5 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018
<b>Përfituesit direkt:</b>	Agjencia e Pronave të Kosovës (APK), Agjencia e Privatizimit të Kosovës (APK), Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencioni Kadastral i Kosovës (AKK), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Ministria e Drejtësisë, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit avancuar sektorin e pronave
<b>Qëllimi:</b>	Krijimi i politikave për rregullimin e çështjeve pronësore në Kosovë sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Çështjet pronësore vazhdojnë të konsiderohen edhe sot si pengesë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës. Tregu i pasurive të patundshme përballet në mënyrë me sfida të shumta, që në një numër të konsiderueshëm të rasteve derivojnë nga mungesa e një sistemi të qartë e funksionues të administrimit të të drejtave të pronësisë. Që nga paslufta e deri më tani Kosova asnjëherë nuk ka pasur politika të qarta dhe strategji të cilat do të adresonin siç duhet çështjet pronësore dhe si rezultat i kësaj moszgjidhja e çështjeve pronësore vazhdon të mbetet sfidë.</p> <p>Në rrafshin institucional në Kosovë janë 3 Agjenci Ekzekutive (Agjencia e Pronave, Agjencia e Privatizimit dhe Agjencia Kadastrale) që merren me çështje pronësore, por asnjëra prej tyre nuk ka mandat të merret me politikat pronësore dhe legjislacionin pronësor. Kjo konfirmon faktin se me politika pronësore nuk është marrë askush deri me sot, ndërsa me hartim të legjislacionit janë marrë institucione të ndryshme varësisht nga</p>

nevojat e momentit. Në vitin 2011 është themeluar Zyra e Koordinatorit Nacional për Çështje Pronësore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, por që nuk është arritur qëllimi i synuar sa i përket krijimit të mekanizmit për politikëbërje dhe ligjëbërje të koordinuar dhe unifikuar për kompleksitetin e çështjeve pronësore në Kosovë.

Mirëspecifikimi i të drejtave të pronësisë dhe regjistrimi i mirëdokumentuar i pronave të paluajtshme kanë një rëndësi primare në projektimin afatgjatë dhe përmirësimin e planifikimit urban, si dhe të zhvillimit tëinfrastrukturës, duke lejuar hapësirat e nevojshme për implementimin e reformave shtetërore.

Me qëllim që të jetë eficient, sistemi i administrimit të pronave duhet të garantojë pronësinë dhe zotërimin e pronës nga pronarët e ligjshëm, duke i shërbyer përforcimit të qëndrueshmërisë së sektorit të pronave të paluajtshme, reduktimit të mosmarrëveshjeve për tokën, lehtësimit të transaksioneve në lidhje me pronat dhe mbështetjes së mirëqeverisjes. Realiteti jo i mirë i pronave të paluajtshme në vend dhe shqetësimet e grupeve të interesit për të drejtat e pronësisë kanë rritur vëmendjen mbi rëndësinë e efektivitetit të reformave dhe efijencës së institucioneve përgjegjëse për këto çështje.

Prandaj, për të adresuar të gjitha çështjet pronësore do të duhej hartuar një strategji gjithëpërfshirëse për çështjet pronësore e cila do të ngërthente në vete të gjitha institucionet si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal si dhe shoqërinë civile.

Një strategji për prona do të duhej përqëndruar në këto aspekte:

- i) Rregullimi dhe harmonizimi i kornizës legjislative për prona si dhe krijimi i mekanizmave institucional që janë eficient, mirëfunktionues dhe të pakontestueshëm,
- ii) Definimin e llojeve të pronave
- iii) Definimin e statusit të pronave
- iv) Monitorimi i implementimit të reformave me një përfshirje më të gjerë të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile duke i shërbyer kështu rritjes së efektivitetit të iniciativave institucionale të ndërmarra,
- v) Rritja e numrit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore që lidhen me çështje pronësore,

iv) Rritja e besueshmërisë publike nëpërmjet transparencës dhe lehtësimit për qasje më të dhëna, p.sh. organizimi i debateve publike

	<p>në shërbim të konsolidimit institucional, pastaj shërbimet online si mjet për transparencë dhe qasje të lehtësuara në të dhëna, dhe</p> <p>v) Tatimi në pronë si mjet për nxitje të përdorimit eficient të pronës.</p> <p>Efektet pozitive të implementimit adekuat të strategjisë për prona do të ishin shumëdimensionale. Pikë së pari efektet do të ishin pozitive sa i përket bërjes biznes dhe në këtë aspekt Kosova do të përmirësonte rangimin në Doing Business Report të Bankës Botërore sa i përket regjistrimi të pronave, marrjes së lejeve të ndërtimit etj. Ky përmirësim në rangim do të kishte efekte pozitive të investitorëve jashtëm që do të ishin të interesuar për të investuar në Kosovë. Aspekte tjera që do të rregulloheshin do të ishin planifikimi adekuat i pronës, përfundimi i procesit të legalizimit dhe ndërtimeve pa leje, do të reduktoheshin konstatet e ndryshme pronësore dhe shumë aspekte tjera që lidhen me këtë problematikë. Njëkohësisht, kjo do të komplementonte projektet e tjera që dalin nga kjo strategji, siq është, për shembull, përmirësimi i drejtësisë civile, përmirësimi i qasjes në drejtësi, dhe në përgjithësi përmirësimi, avancimi dhe harmonizimi i kornizës ligjore të sistemit gjyqësor dhe përforcimi i mekanizmave që sigurojnë zbatimin e një sistemi të drejtësisë që do të jetë i paanshëm, efektiv, transparent, dhe llogaridhënës.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.10 Përmirësimi i infrastrukturës fizike në sistemin e drejtësisë</b>
<b>Vlera:</b>	7.5 MEUR (faza I) 7.5 MEUR (faza II)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza I)  Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza II)
<b>Përfutuesit direkt:</b>	Gjykatat, Prokuroritë, KGJK, KPK
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit duke mbështetur në përgjithësi institucionet e drejtësisë në të qenurit sa më eficient dhe efektiv në aktivitetet e tyre
<b>Qëllimi:</b>	Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të drejtësisë
<b>Përshkrimi:</b>	Nga janari i vitit 2013, ka filluar implementimi i pakos së re ligjore të sistemit të drejtësisë e cila përfshinë Ligjin për Gjykatat, Prokurorinë e Shtetit, KPK, KGJK, Kodin Penal (KP) dhe Kodin e Procedurës Penale (KPP).

	<p>Pakoja e re ligjore ka pasur implikime të reja buxhetore në lidhje me infrastrukturën e nevojshme fizike për gjykatat e prokuroritë.</p> <p>Ndonëse Pallati i Drejtësisë, i cili është në përfundim e sipër, do të akomodojë një pjesë të mirë të prokurorive dhe gjykatave të Prishtinës, prapë se prapë përfshirja e plotë e stafit të KPK-së, Prokurorisë Speciale dhe KGJK-së në këtë Pallat duket të jetë e pamundshme.</p> <p>Infrastruktura për mbrojtjen e dëshmitarëve, poashtu, nuk është adresuar deri me tani siç duhet. Ndërkohë, edhe pse ndërtimi i gjykatës themelore në Ferizaj përfundon në 2017 dhe i asaj në Gjakovë planifikohet të përfundojë në 2018, në mënyrë që para vitit 2020 të përmbushen nevojat e infrastrukturës fizike, ka nevojë të ndërtohen edhe ato në Pejë dhe Prizren.</p> <p>Prandaj, ndërtimi dhe funksionalizimi i një pjese të kësaj infrastrukture fizike pritet të kryhet nga kontributet e donatorëve. Më specifikisht, këtu përfshihen, në mes tjerash, edhe nevojat për ndërtimin e a) dy Gjykatave Themelore në Pejë dhe Prizren; b) Prokuroria Speciale e cila kërkon infrastrukturë përcjellëse të vecantë të dhomave të marrjes në pyetje, infrastrukturë të veçantë teknike, masa për mbrojtjen e dëshmitarëve etj.</p> <p>Përmirësimi i infrastrukturës fizike të gjykatave dhe prokurorive (përfshirë nevojat në veriun e Kosovës) është i një rëndësie jetike për të përmirësuar kushtet e punës së gjykatave dhe prokurorive. Ky përmirësim i infrastrukturës do të rriste eficientësinë dhe efektivitetin e KPK-së, KGJK-së, prokurorive dhe gjykatave. Njëkohësisht, ky përmirësim i infrastrukturës do të rriste edhe efektin e projekteve të tjera që kanë për qëllim përmirësimin e bazës ligjore, mbrojtjen e dëshmitarëve, përmirësimin e infrastrukturës së IT-së etj.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.11 Rishikimi gjithëpërfshirës i drejtësisë penale</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR (faza I) 2 MEUR (faza II)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza I)  Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza II)
<b>Përfutuesit direkt:</b>	MD, MPB, KPK, KGJK, Gjykatat, Prokuroritë, PK, DK, Zyra e Prokurorit Disiplinor, Asociacioni Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, etj.



<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përmirësimi i sundimit të ligjit duke mbështetur sistemin e drejtësisë për të qenë sa më eficient, efikas, transparent dhe llogaridhënës
<b>Qëllimi:</b>	Avancimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Që nga janari 2013 në Kosovë ka filluar implementimi i një sistem të ri të drejtësisë (gjykata dhe prokurori). Përpos sistemit të ri të gjykatave dhe prokurorive, ka filluar edhe zbatimi i Kodit të ri Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Funksionimi i sistemit të ri të drejtësisë ka shënuar vështirësitë e para të tij, të cilat nuk janë adresuar si duhet me legjislacionin e ri. Janë disa aspekte që nuk janë rregulluar siç duhet: p.sh. Funksionimi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, Gjykata Administrative, etj.</p> <p>Tranzicioni i këtij ri-strukturimi të gjykatave dhe prokurorive ka rezultuar të jetë i vështirë jo vetëm brenda për brenda këtyre institucioneve (p.sh. bartja e përgjegjësive nga njëra gjykatë apo prokurori në tjetrën, etj), por edhe qasja e qytetarëve në sistemin e ri nuk ka qenë e lehtë.</p> <p>Vështirësitë tjera të aspektit përmbajtësor lidhen me zbatimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale nga institucionet e drejtësisë dhe atyre të zbatimit të ligjit. Edhe për qytetarët, dispozitat e këtyre kodeve nuk janë mjaftueshëm të qarta. Në përgjithësi sistemi i drejtësisë penale ka vështirësi që lidhen nga mosharmonizimi i plotë i legjislacionit të drejtësisë penale.</p> <p>Një çështje që ende nuk është adresuar siç duhet ka të bëjë me të dhënat e drejtësisë penale (criminal track record) dhe menaxhimin e tyre. Kjo çështje pritet të adresohet duke u krijuar një sistem qendror i menaxhimit të të dhënave penale dhe monitorimit të tyre.</p> <p>Kjo në tërësi shkakton vështirësi në përforcimin dhe koordinimin e mekanizmave për implementimin e drejtësisë penale dhe si rezultat i tërësishëm është mosefektiviteti në parandalimin dhe luftimin e veprave penale, e sidomos të korrupsionit dhe krimit të organizuar të të gjitha llojeve. Në përgjithësi janë një sërë aspektesh që do të duhej adresuar duke plotësuar-ndryshuar, harmonizuar pakon ligjore të drejtësisë penale në tërësinë e saj.</p> <p>Për këtë arsye, duhet do të rishikohet sistemi i drejtësisë penale në mënyrë që të avancohet sistemi i drejtësisë, ai prokurorial dhe i çështjeve të brendshme në tërësinë e tyre. Rishikimi do të përfshijë propozimet për plotësim-ndryshimin e kornizës legjislativ të drejtësisë penale, pavarësimin e plotë të Zyrës së Prokurorit Disiplinor nga KGJK, themelimin e gjykatës administrative (nëse e nevojshme), etj. Realizimi i veprimeve të sipërmendura do të kontribuonte në rritjen e efikasitetit dhe</p>

	<p>efektivitetit të sistemit të drejtësisë.</p> <p>Sikur Strategjia për Sektorin e Sundimit të Ligjit, edhe Rishikimi Gjithëpërfshirës i Drejtësisë Penale shihet si prioritet imediat. Përvec arsyeve që u përmenden më lartë, ky rishikim shihet edhe si pararendës dhe njëkohësisht i nevojshëm edhe për suksesin e projekteve të tjera të propozuara, sidomos atyre që kanë të bëjnë me luftimin e veprave penale, sikur korrupsioni dhe krimi i organizuar . Si i tillë, ky rishikim do ndikojë rëndësishëm sidomos në rezultatet e pritura të kësaj strategjie për përmirësimin dhe harmonizimin e kornizës ligjore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe përforcimin e mekanizmave që sigurojnë zbatimin e një sistemi të drejtësisë që do të jetë i paanshëm, efektiv, transparent dhe llogaridhënës.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.12 Përmirësimi i kapaciteteve për matjen e performancës dhe mbikqyrjen e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018
<b>Përfutuesit direkt:</b>	Gjyqtarët, Prokurorët, KPK, KGJK
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit në Kosovë duke përmirësuar efikasitetin dhe efizienzën e punës së gjykatave dhe prokurorive
<b>Qëllimi:</b>	Krijimi i mekanizmave mbikqyrës të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe personelit të gjykatave e prokurorive
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Forcimi i efikasitetit, kualitetit dhe llogaridhënës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në kryerjen e detyrave të tyre kërkon implementimin e mekanizmave të nevojshëm për mbikqyrjen e punës së gjykatave, prokurorive dhe këshillave. Edhe pse baza ligjore ekziston deri diku, për momentin, ka mungesë të mekanizmave rigoroz të disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të kontrollimit të standardeve të punës, të treguesëve të performancës etj.</p> <p>Sa u përket prokurorëve, për shembull, shihet nevoja e themelimit të një mekanizmi më efikas për mbikqyrjen më efektive si të prokurorëve ashtu edhe të kryeprokurorëve. Kompetencat e komisionit disiplinor dhe atij të vlerësimit të performancës nuk janë të qarta. Komisioni disiplinor merret edhe me vlerësimin profesional. Ka nevojë për ndryshimin e bazës ligjore dhe krijimin dhe rishikimin e rregulloreve përkatëse për vlerësim të</p>

	<p>performansës.</p> <p>Njëkohësisht, KGJK dhe KPK kanë nevojë për asistencë për Njësitë për Analiza dhe Politika, për krijimin e treguesëve të performances së gjykatave (courtools), për mbikqyrjen dhe kontrollin e standardeve të punës në kuadër të gjykatave, krijimin e mekanizmave më të mirë disiplinor, etj.</p> <p>Përmirësimi dhe krijimi i mekanizmave të ri të mbikqyrjes së punës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial do të ndihmonte dukshëm në përmirësimin e efikasitetit dhe efijencës në sektorin e sundimit të ligjit në përgjithësi dhe atë të gjykatave dhe prokurorive në veçanti.</p> <p>Projekt-ideja për përmirësimin e kapaciteteve për matjen e performances dhe mbikqyrjen e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, shihet si një projekt-ide e rëndësishme së veçantë e cila, bashkë me projektet-idetë e tjera për avancimin e arsimit ligjor, avancimin e përdorimit të teknologjisë informative, dhe përmirësimin e komunikimit ndër-institucional në sistemin e drejtësisë, do të kontribuojë dhe ndikojë rëndësishëm në rritjen e efikasitetit, kualitetit dhe llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe rrjedhimisht në përmirësimin e efijencës, efektivitetit, llogaridhënies dhe paanshmërisë së tërë sistemit të drejtësisë.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.13 Arsimi ligjor 2: Mbështetje për Fakultetin Juridik</b>
<b>Vlera:</b>	1.5 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfituesit direkt:</b>	Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Drejtësisë dhe Akademia e Drejtësisë
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit duke përmirësuar programet specifike të arsimit juridik
<b>Qëllimi:</b>	Zhvillimi dhe avancimi i mëtejshëm i arsimit juridik në Kosovë sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Përshkrimi:</b>	Me formimin e Akademisë së Drejtësisë dhe me synimin që në sistemin e drejtësisë të profilizohen gjykatësit dhe prokurorët në fusha specifike, do të ishte e nevojshme që i gjithë sistemi i arsimit ligjor të sigurojë kurikula të specializuara dhe konsistente. Në mënyrë që kjo të realizohet, është e nevojshme që kurikulat të harmonizohen në mes të studimeve themelore juridike (që në këtë rast merret Fakulteti Juridik) dhe

	<p>programeve të Akademisë së Drejtësisë.</p> <p>Reformimi i plan-programeve, duke integruar më shumë lëndë praktike juridike, do të ofronte mundësinë e profilizimit të studentëve gjatë studimeve të tyre, p.sh. dy vite studime të përgjithshme dhe dy tjera profilizim dhe specializim. Kjo do të ndihmojë të diplomuarit që të jenë më afër profesionit të gjyqtarit, prokurorit, avokatit dhe për më tepër do të ndihmonte futjen e kuadrove më të reja në sistemin gjyqësor apo prokurorial.</p> <p>Ky projekt do të duhej t'i kushtonte rëndësi edhe bibliotekës së Akademisë së drejtësisë. Pasurimi i literaturës së nevojshme për trajnime dhe literaturë relevante të nevojshme për gjykatës dhe prokurorë. Biblioteka do të duhej të ishte pjesë e rrjetit të Bibliotekave të Kosovës dhe të kishte poashtu qasje në revista të drejtësisë.</p> <p>E gjithë kjo kërkon blerje të një numri të konsiderueshëm të librave, trajnime të bibliotekarëve, funksionalizimin e një sistemi modern të katalogimit, përmirësim të sistemit të IT-së etj.</p> <p>Një projekt për një bibliotekë moderne do të përmirësonte dukshëm bazën e arsimimit juridik në Kosovë dhe kjo ndër të tjera do të kishte efekt pozitiv si në përgaditjen ashtu edhe në përmirësimin e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe hulumtuesëve.</p> <p>Harmonizimi i kurikulave të nivelit themelor dhe atij të lartë/ aplikativ juridik do të përmirësonte dukshëm bazën e arsimimit juridik në Kosovë dhe kjo ndër të tjera do të kishte efekt pozitiv edhe në sistemin e arsimit në përgjithësi, por vecanërisht sistemin e drejtësisë.</p> <p>Efektet pastaj do të ishin zinxhirë dhe në plan afatgjatë kjo bazë arsimore juridike do të kontribuonte dukshëm në përmirësimin e sundimit të ligjit në tërësinë e tij.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.14 Rritja e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar</b>
<b>Vlera:</b>	0.8 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, MPB, KGJK, KPK, NJIF, PK, DK, etj.

<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit duke përmirësuar bashkëpunimin juridik ndërkombëtar jo vetëm me vendet e rajonit por edhe më gjerë
<b>Qëllimi:</b>	Përmirësimi dhe avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në sistemin e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë një sërë masash për të reformuar sektorin e sundimit të ligjit sipas praktikave më të mira të BE-së. Në disa aspekte janë arritur rezultate konkrete (p.sh. legjislacioni), ndërkohë që në disa aspekte tjera ka nevojë për përmirësime të mëtejme. Duke patur parasysh mjedisin e komplikuar politik (sidomos relacionet Kosovë-Serbi) në të cilin është duke vepruar Kosova, aspekti i bashkëpunimit ndërkombëtar mbetet një sfidë e cila duhet të adresohet në vazhdimësi.</p> <p>Mungesa e pjesëmarrjes aktive në nisma të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare ka kufizuar mundësitë e Kosovës për të përfituar dhe kontribuar në çështje të ndryshme siç është parandalimi dhe luftimit i krimit të organizuar rajonal dhe ndërkombëtar. Një pjesë e mos-suksesit në parandalimin dhe luftimit të të gjitha formave të krimit të organizuar ndërkombëtar rrënjët i ka pikërisht te mungesa dhe pamundësia e Kosovës për të qenë pjesë e nismave të ndryshme, rrjeteve, apo asociacioneve ndërkombëtare.</p> <p>Në përgjithësi, ka probleme në sferën e bashkëpunimit juridik në nivel ndërkombëtar si te gjykatat ashtu edhe te prokuroritë. Në mes tjerash, janë caktuar koordinatorë, kapacitetet e të cilëve kanë nevojë të përforcohen.</p> <p>Prandaj, në mënyrë që Kosova të përparojë në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar kërkohet që së pari të ri-shqyrtohet dhe harmonizohet korniza rregullatore me praktikën më të mira të BE-së, të vlerësohen kapacitetet institucionale, buxhetore dhe infrastrukturore të institucioneve të sektorit të sundimit të ligjit për të parë se çfarë kërkohet dhe mund të përmirësohet në vitet që vijnë, dhe krejt në fund të kontribuohet në ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve gjegjëse.</p> <p>Poashtu është qenësore që të përmirësohet bashkëpunimi me organizatat e mekanizmat e ndryshme Evropiane ku, për shkak të kontekstit politik ose neutralitetit ndaj statusit të Kosovës, nuk ka patur bashkëpunim të mirëfilltë deri me tani. Këtu përshihen, në mes tjerash, CEPEJ, Eurojust, Europol dhe Frontex. Duhet të shqyrtohen mundësi dhe projekte bashkëpunimi, mbase edhe informale, në mënyrë që Kosova të përfitojë nga këto organizata dhe njëkohësisht t'i përmirësojë kapacitetet e saj për luftën kundër krimit të organizuar etj.</p>

Është shumë e rëndësishme të potencohet se problemet si ai i krimit të organizuar janë probleme regjionale dhe ndërkombëtare dhe për ta përmirësuar punën e Kosovës në këtë drejtim është shumë e nevojshme asistencë për bashkëpunim më të ngushtë me këto organizata. Prandaj, anëtarësimi i Kosovës në nisma, rrjete, asociacione dhe trupa të ndryshme ndërkombëtare do të kontribuonte dukshëm në parandalimin dhe luftimin e të gjitha llojeve të krimit të organizuar rajonal dhe ndërkombëtar. Rrjedhimisht, kjo projekt-ide për rritjen e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar do të komplementonte mirë përpjekjet dhe projektet e tjera për rritjen e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, luftës së trafikimit me genie njerëzore, rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional etj.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.15 Regjistrimi dhe menaxhimi i të dhënave penale</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, KPK, KGJK, MPB, DK, PK, SHKK, SHSK, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit duke avancuar menaxhimin e të dhënave penale
<b>Qëllimi:</b>	Krijimi i një sistemi të centralizuar për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave penale
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave me BE-në, institucionet e Kosovës janë duke bërë hapa të rëndësishëm drejt përmbushjes së obligimeve që dalin nga ky proces kompleks. Megjithatë, aspekte si p.sh. regjistrimi dhe menaxhimi i të dhënave që flasin për të kaluarën penale të personave të dënuar në Kosovë apo vende të ndryshme, veçanërisht në BE, ende nuk janë adresuar.</p> <p>Sistemi i drejtësisë penale në Kosovë nuk ka një mekanizëm që do të merrej me menaxhimin e të dhënave penale dhe të dhënave për personat e dënuar. Kodi i Procedurës Penale (KPP) në nenin 491 të tij parasheh që <i>“evidencën mbi procedurat penale dhe evidencën e personave të dënuar e mban organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore. Mënyra e mbajtjes së evidencës caktohet me akt nënligjor”</i>. Edhe pse KPP parasheh regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave penale, deri me tani nuk ka një</p>

	<p>institucion që është përgjegjës për menaxhimin e këtyre të dhënave penale.</p> <p>Krijimi i regjistrit për të dhënat penale kërkon strukturë administrative të centralizuar, kompjuterizuar, organizuar, të sigurtë dhe të bazuar në legjislacion. Krijimi dhe funksionalizimi i këtij regjistri mund të zgjasë mes 18 muajve deri në 4 vite. Sipas praktikave të BE-së, regjistri i të dhënave penale kryesisht menaxhohet nga Ministria e Drejtësisë. Ndërkohë që në Kosovë vetëm KGJK ka filluar të reflektojë sa i përket regjistrin të të dhënave penale.</p> <p>Prandaj, për të qenë në linjë me praktikën e BE-së, duhet që pikë së pari të sqarohet se kush është institucionalisht më afër të dhënave penale, pastaj duhet sqaruar obligimet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në këtë proces, të cilët do të duhej të punonin së bashku në themelimin sa më të shpejtë të këtij institucioni tepër të rëndësishëm.</p> <p>Shkëmbimi i të dhënave penale në nivel evropian është duke u zhvilluar me të madhe në vitet e fundit, kjo për t'i ndihmuar lëvizjes së lirë dhe parandalimit dhe luftimit të krimit ndërkombëtar. Prandaj, një regjistër i të dhënave penale mundëson që çdo person të verifikojë të kaluarën penale të tij, por poashtu ndihmon dhe prokuroritë dhe gjykatat për të përshtatur përgjigjen e tyre për të akuzuarit (p.sh. recidivizmi apo dënimet me kusht).</p> <p>Kjo projekt-ide, ndër të tjera, plotëson dhe përforcon edhe projekt-idetë e tjera që kanë të bëjnë me rritjen e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, përmirësimin e komunikimit brenda-institucional dhe ndër-institucional, zhvillimin e resurseve për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së IT-së.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>1.16. Mbështetje për mekanizmat e mbikëqyrës në drejtësi dhe çështje të brendshme</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfituesit direkt:</b>	Inspektorati Policor i Kosovës, Inspektorati i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Zyra e Prokurorit Disiplinor, Inspektorati i Doganave, Inspektorati Sanitar, Fitosanitar dhe Veterinar
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Të kontribuohet në përforcimin e sundimit të Ligjit në Kosovë përmes përforcimit të mekanizmave mbikëqyrës sipas praktikave më të mira të BE-së

<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i mekanizmave mbikëqyrës në sistemin drejtësisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Në kuadër të institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë ka disa institucione që merren me mbikëqyrjen e punëve nëpër institucionet gjegjëse të tyre. Në kuadër të MPB-së ekziston Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) si institucion që merret me parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj.</p> <p>Që nga themelimi e deri me tani IPK ka shënuar rezultate të mira sa i përket përmirësimit të punës së policisë si dhe parandalimin dhe luftimin e dukurive negative në Policinë e Kosovës. Megjithatë, çdo përpjekje për të vlerësuar pozitivisht eficientë dhe llogaridhënien në Policinë e Kosovës kërkon ekzistimin e databaze të dhënash (track record) kur ndërmerren masa disiplinore dhe veprime tjera në Polici.</p> <p>Prandaj, në këtë drejtim duhet të ngriten kapacitetet e IPK sa i përket masave disiplinore si dhe të krijohet një database të dhënash lidhur me masat disiplinore dhe veprime tjera sa u përket zyrtarëve policorë. Aspekte tjera të cilat do të duhej marrë në konsiderim janë rishikimi organizativ dhe operativ i IPK (nëse e nevojshme), avancimi i procedurave standard operative, përmirësimi i bashkëpunimit të IPK me Policinë e Kosovës dhe institucione tjera relevante.</p> <p>Në vazhden e reformës së sistemit të burgjeve në Kosovë në është themeluar Në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) është themeluar Inspektorati i SHKK-së. Qëllimi i këtij Inspektorati është që të përmirësojë punën e SHKK-së duke siguruar zbatim të ligjit nëpër burgje nga personeli i burgjeve, rrespektimin e të drejtave të të burgosurve sipas standardeve ndërkombëtare dhe marrjen e masave të nevojshme disiplinore për moszbatim të ligjit. Përqendrimi i asistencës për këtë institucion do të ishte në rishikimin organizativ dhe operativ të këtij institucioni, hartimin e procedurave standard operative sipas praktikave më të mira të BE-së, hartimin e programeve për trajnim të vazhdueshëm për inspektorët si dhe përforcimin e bashkëpunimit të këtij institucioni me institucione tjera relevante.</p> <p>Në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës është themeluar Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) e themeluar me Ligjin e KGJK-së dhe KPK-së. Ky institucion merret me rastet e shkeljeve gjatë punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. ZPD është përgjegjëse për: hetimet e shkeljeve të mundshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe paraqitjen e të dhënave si dhe mbështetjen e rasteve të shkeljeve në veprimet disiplinore të Komisioneve</p>



Disiplinore të KGJK-së dhe KPK-së.

Vështirësitë me të cilat është duke u përballur ZPD janë: Ligjet e KGJK-së dhe KPK-së nuk përmbajnë rregulla të qarta për disa aspekte procedural (p.sh. hetimet preliminare, hapja e hetimeve, kufiziket e periudhës së përshkimit të rastit, kundërshtimi i ankesave, detyrat e stafit të ZPD-së. Poashtu, ligji nuk e definon qartë përbërjen material të elementeve të 'shkeljes' apo 'masave disiplinore'.

Aspekt tjetër është edhe mungesa e procedurave standard operative dhe bashkëpunimi i dobët mes gjykatave e prokurorive me ZPD-në. Prandaj, për të krijuar një institucion sipas praktikave ndërkombëtare pikë së pari do të duhej rishikuar bazën ligjore të ZPD-së, rishikimin organizativ dhe operativ, ngritjen e kapaciteteve, përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes/emërimit të Prokurorëve dhe Inspektorëve Disiplinor, përmirësimin e bashkëpunimit me KGJK, KPK, Gjykata e Prokurori si dhe institucione tjera relevante.

Edhe Doganat e Kosovës kanë brenda tyre njësinë e inspektimit. Kjo njësi merret me inspektimin e punës së zyrtarëve doganorë nëpër pika doganore, terminale doganore dhe shërbime tjera doganore. Një ndër prioritetet kryesore të Doganave të Kosovës janë: zhvillimi dhe avancimi i mekanizmave për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e rasteve të korrupsionit, mashtrimit, konfliktit të interesit dhe shpëlarjes së parasë. Identifikimi i korrupsionit të dyshimtë, hetimi dhe drejtimi i shkelësve drejtë ndjekjes penale dhe zvogëlimi i shkaktarëve dhe rreziqeve nga korrupsioni në administratë. Rishikimi i jashtëm i proceseve të brendshme për identifikimin, fillimin dhe procedimin e rasteve të aktiviteteve korruptuese.

Në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ekzistojnë inspektoratet fitosanitar, sanitar, veterinarë. Raporti i Progresit i BE-së i vitit 2013 për Kosovën thekson nevojën për ngritje të kapaciteteve të kontrollit veterinar, fitosanitar dhe sanitar. Prandaj, asistenca këtu do të duhej përqendruar në rishikimin e aspektit organizativ dhe operativ, hartimin e procedurave standarde operative, hartimin e programeve për trajnime të vazhdueshme, përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, me OJQ dhe publikun.

Përforcimi i këtyre mekanizmave mbikqyrës do të kontribuonte në përmirësimin e performancës së përgjithshme të këtyre institucioneve, do të zvogëlonte mundësitë korruptive brenda këtyre institucioneve dhe më gjerë si dhe do të rriste besimin e publikut në këto institucione. Kjo projekt-ide përfshinë elemente të Objektivit Strategjik 1 dhe 2.

**16.2.2 Përshkrimi i projekt-ideve të Objektivit Strategjik 2:** Përmirësimi i parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë trafikimit me qenie njerëzore dhe narkotikë, krimit ekonomik dhe shpërlarjes së parave, kontrabandës me armë, krimit kibernetik dhe terrorizmit

Lista e projekt-ideve të mëposhtme paraqet nevojat për asistencë në realizimin e objektivit strategjik 2, ku projekt-idetë janë të renditura sipas prioritetit që kanë. Realizimi i këtyre projekt-ideve do të duhej t'i paraprinte dhe njëkohësisht do të kontribuonte në krijimin e kushteve më të përshtatshme për implementimin e plotë të projekt-ideve tjera të përmendura, të cilat komplementojnë mirë njëra tjetrën. Projektet-idetë në këtë strategji janë gjithëpërfshirëse, duke lënë mundësinë e hapur që disa, ose shumica e këtyre projekt-ideve, të mund të realizohen përmes një apo më shumë projekteve më specifike dhe në disa faza.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.1 Arsimimi Ligjor 3: Përforcimi i Akademisë Kosovare për Siguri Publike</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017
<b>Përfituesit direkt:</b>	MPB, PK, Inspektorati Policor, AKSP, DK, SHKK, DK, AME dhe institucionet e tjera të sigurisë publike
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit duke përmirësuar sistemin e sigurisë publike
<b>Qëllimi:</b>	Reformimi dhe zhvillimi ë mëtejme i agjencioneve për siguri publike sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Institucionet e Republikës së Kosovës kanë ndërmarrë një sërë hapash për të reformuar sistemin e sigurisë publike. Përpos krijimit të bazës ligjore dhe themelimit të mekanizmave për zbatimin e ligjit ato kanë nevojë edhe për ngritje të kapacitete profesionale dhe resurseve të nevojshme për të siguruar një zbatim sa më adekuat të ligjit nga të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit.</p> <p>Njëra ndër prioritetet kryesore që lidhet me sigurinë publike është reformimi dhe fuqizimi i agjencioneve të sigurisë publike. Më konkretisht politikat e MPB-së synojnë fuqizimin e Akademisë Kosovare për Siguri Publike si gjeneratori kryesor për ofrimin e programeve të ndryshme për trajnim dhe zhvillim të agjencioneve të zbatimit të ligjit.</p> <p>Ligji për Akademinë Kosovare për Siguri Publike (AKSP) e definon këtë institucion si përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë për të gjitha institucionet e sigurisë publike siç janë: Policia e Kosovës,</p>

Shërbimi Korrektues, Shërbimi Sprovues, Doganat, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, Inspektorati Policor, etj.

Deri me tani Akademia Kosovare për Siguri Publike (AKSP) është duke organizuar trajnime të niveleve të ndryshme për të gjithë zyrtarët e sigurisë publike. Në mënyrë që AKSP të jetë një institucion udhëheqës në zhvillimin e zyrtarëve të sigurisë publike kërkohet që ky institucion të zhvillojë kapacitetet e veta programatike dhe trajnuese për të ofruar trajnime të avancuara sipas nevojave dhe sfidave me të cilat përballlet shoqëria e Kosovës. Fillimi i studimeve të nivelit bazik (bachelor) për fusha të ndryshme do të ishte më se i nevojshëm zhvillimin e zyrtarëve të sigurisë publike. Njëkohësisht, ka nevojë poashtu të zhvillohen kapacitetet kërkimore të Akademisë.

Një aspekt që AKSP do të duhej adresuar me shumë prioritet është ofrimi i programeve të trajnimeve hyrëse për pjesëtarët serb që do të futen në policinë, doganat e Kosovës dhe institucione tjera të zbatimit të ligjit. Ofrimi i programeve adekuate do të ndihmonte integrimin e pjesëtarëve serb në agjencitë e zbatimit të ligjit dhe për më tepër do të mundësonte një qasje uniforme ndaj zbatimit të ligjit në tërë territorin e Kosovës.

Asistenca e donatorëve do të duhej përqendruar në krijimin e programeve të avancuara për trajnime, studime dhe hulumtime duke përfshirë ato për fushat si krimi i organizuar, shpërlarja e parave, krimi kibernetik, krimi financiar, terrorizmi, drogat, ekonomia joformale dhe forma tjera negative të cilat potencialisht mund të kenë efekte negative në shoqërinë e Kosovës.

Theks i veçantë do të duhej kushtuar krijimit të kuadrove lokale në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria institucionale e AKSP-së. Programet e trajnimit, studimeve dhe hulumtimeve do të duhej të ishin gjithëpërfshirëse dhe nuk do të duhej përjashtuar mundësia e përfshirjes në këto programe edhe të stafit gjyqësor në mënyrë që të krijojet një qasje uniforme dhe tërësisht profesionale ndaj parandalimit dhe luftimit të dukurive negative. Meqenëse aktivitetet e institucioneve për zbatimin e ligjit ndërlidhen ngushtë, atëherë ka nevojë të ketë edhe një koordinim dhe bashkëpunim sa i përket arsimimit të pjesëtarëve të këtyre institucioneve.

Qasja programatike ndaj zyrtarëve të sigurisë publike do të kishte efekte tejet pozitive sidomos në krijimin e kuadrit profesional, avancimin institucional në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, plotësimin e kritereve të cilat kërkohen nga BE për fushën sundimit të rendit dhe ligjit. Natyrisht që një staf i përgatitur do të rriste nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit për parandalimin dhe luftimin e dukurive negative.

Realizimi i këtij projekti do të ndikonte drejtëpërsëdrejti në përmirësimin

	e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, sidomos përmes efektit të saj në zhvillimin e resurseve të nevojshme njerëzore për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe korrupsionit. Si i tillë, ky projekt-propozim shihet si i një rëndësie të vecantë dhe është në përputhshmëri të plotë me projekte të tjera si forcimi i inteligjencës financiare dhe luftës kundër krimit kibernetik, parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore, përmirësimi i shërbimeve forenzike dhe atij të emergjencave etj.
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.2 Përforcimi i menaxhimit efektiv të migracionit dhe azilit në Kosovë</b>
<b>Vlera:</b>	2.5 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017
<b>Përfituesit direkt:</b>	MPB, PK
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në krijimin e një mekanizmi më eficient për menaxhimin e migracionit në përputhje me EU acquis
<b>Qëllimi:</b>	Ngritja e kapaciteteve të institucioneve ekzistuese për të arritur standardet e BE-së mbi menaxhimin e migracionit dhe ri-integrimin e të kthyerve pas ri-pranimit
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Migrimi si proces i përhershëm i lëvizjes së njerëzve si dhe rritja e vazhdueshme e numrit të migrantëve dhe problemeve që ndërlidhen me këtë, ka ndikuar që migrimi të gjendet në qendër të vëmendjes në shumë shtete të botës. Pothuajse të gjitha vendet, pa dallim, ballafaqohen me sfida që ndërlidhen me migrimin, qofshin si vende të origjinës, transitit apo vende të destinacionit përfundimtar.</p> <p>Kjo rritje është ndjerë edhe në Ballkanin Perëndimorë dhe Republikën e Kosovës si pjesë e Ballkanit Perëndimor, ku ka pasur rritje të konsiderueshme të migrantëve të parregullt, dhe atë kryesisht nga vendet si: Afganistani, Pakistani, Bangladeshi, Algjeria, Maroku, Kongo, Siria, etj. Kjo rritje sipas këtij raporti vjen kryesisht përmes Turqisë në Greqi dhe pastaj nga Greqia në Shqipëri apo Maqedoni ku vazhdohet për në vendet tjera, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës (shih Strategjinë Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013-2018, faqe 6).</p> <p>Për të adresuar problematikën e migracionit dhe azilit, Republika e Kosovës ka hartuar, plotësuar, ndryshuar dhe miratuar një varg ligjesh</p>

dhe aktesh nënligjore, dokumente strategjike dhe dokumente tjera. Në mesin e këtyre vlen të veçohen: Ligji për Azilin; Ligji për të Huajt; Ligji për Kontrollin e Kufirit; Ligji për Shtetësinë e Kosovës; Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit; Strategjia për Luftimin e Trafikimit me Njerëz. Poashtu, janë plotësuar dhe ndryshuar një numër i ligjeve përfshirë këto që u përmendën më lartë, si dhe disa ligjeve të reja, ku vlen të përmendet Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

Poashtu janë miratuar dokumente strategjike si: Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar; Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Krimin të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2012-2017; Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimin dhe Plani i Veprimit 2009-2012; Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2012-2017; dhe Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014.

Përpos, zhvillimeve të mësipërme, Kosova ka nënshkruar një sërë marrëveshesh biletarale për ripranim. Zbatimi i marrëveshjeve për ripranim është një faktor i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt. Analiza e zbatimit të marrëveshjeve për ripranim tregon qartë se ky instrument kontribuon në forcimin e një bashkëpunimi efikas në luftën kundër migrimit të parregullt dhe lehtëson largimin e personave që hyjnë/qëndrojnë ilegalisht në territorin e njërës prej palëve kontraktuese.

Përkundër veprimeve të mësipërme, në aspektin praktik çështjet e migacionit, azilit, dhe ri-integrimit të të kthyerëve vazhdojnë të mbesin sfida për shtetin e Kosovës, sikundër që vazhdojnë të mbesin sfida në procesin e liberalizimit të vizave të Kosovës me BE-në. Prandaj, për të adresuar këtë problematikë siç duhet kërkohet asistencë në këto fusha: vlerësim gjithëpërfshirës i Strategjisë Shtetërore për Migrim dhe Plan i Veprimit, përmirësimi i mekanizmit për shkëmbim të informatave, ngritja e kapaciteteve institucionale, përafrimi i kornizës ligjore me EU acquis, përforcimi i institucioneve në nivel qendror dhe lokal për të planifikuar monitorimin dhe realizimin e procesit të integrimit për të kthyerit, dhe ngritja e vetëdijës publike.

Adresimi adekuat i migracionit dhe azilit do të kontribuonte dukshëm në parandalimin e migrimit të parregullt dhe fuqizimin e migrimit të rregullt, duke avancuar dhe lehtësuar migrimin ligjor. Këto veprime njëkohësisht do të shndërronin migrimin në faktor pozitiv për zhvillimin ekonomik dhe do të mundësonin përfshirjen e Kosovës në dialogun dhe bashkëpunimin

	rajonale dhe ndërkombëtare, me qëllim të identifikimit të prioriteteve të përbashkëta dhe adresimit të sfidave të përbashkëta me qëllim të fuqizimit të menaxhimit bilateral dhe regional të migrimit.
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.3 Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda</b>
<b>Vlera:</b>	2.5 MEUR (faza I) 2.5 MEUR (faza II)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza I)  Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2017-2018 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2019-2020 (faza II)
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, MPB, KGJK, KPK, IGJK, AKSP, PK, Oda e Avokatëve të Kosovës, Parlamenti i Kosovës, NJIF
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit duke mbështetur institucionet e drejtësisë dhe zbatimit të ligjit në të qenurit sa më eficient dhe efektiv në aktivitetet e tyre
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i bashkëpunimit ndër-institucional, mekanizmave insitucional si dhe kapaciteteve njerëzore në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar
<b>Përshkrimi:</b>	Në aspektin e hartimit të politikave dhe legjislacionit, sektori i sundimit të ligjit është pasuruar me një sërë masash legjislative për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe mekanizmave të zbatimit të ligjit. Më konkretisht, ka pasur përmirësime në krijimin e politikave dhe legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.  Përkundër këtij progresi, vështirësitë në bashkëpunimin ndër-institucional dhe brenda-institucional janë sfida që duhet adresuar. Për më tepër, mungon një profilizim i gjyqtarëve, prokurorëve, policëve, Shërbimit Korrektues, etj, lidhur me fushat specifike që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, shpërlarjes së parave, drogave, trafikimit me qenie njerëzore dhe terrorizmit.  Krijimi i programeve të avancuara për profilizimin e prokurorëve, gjyqtarëve, policëve, Shërbimit Korrektues, etj. do të ndihmonte bindshëm në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar - kjo

	<p>sepse do të profilizoheshin gjyqtarët, prokurorët, policia, Shërbimi Korrektues, etj.</p> <p>Programe të përbashkëta të zhvillimit të kategorive të mësipërme natyrisht se do të kontribuonin në përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstytucional për problematikën e lartëpërmendur. Këto programe do të duhej hartuar në Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe Akademinë për Sigurinë Publike dhe do të duhej organizuar programe trajnime për trajnerë, të cilat në planin afatmesëm dhe afatgjatë do të ofronin trajnime pa qenë të varur nga kontributet e donatorëve.</p> <p>Kjo projekt-ide shihet si prioritet imediat për realizimin e objektivit të dytë strategjik, prandaj edhe është renditur e para në përmbushjen e kësaj objektive. Ajo do të ndikojë në realizimin e disa rezultateve të pritura të këtij objekti, përfshirë përforcimin e mekanizmave që sigurojnë zbatim eficient dhe efektiv të ligjit duke rritur sigurinë e përgjithshme të vendit ndaj dukurive negative si dhe në zhvillimin e resurseve të nevojshme njerëzore për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë etj. Njëkohësisht, kjo projekt-ide komplementon mirë projekt-idetë e tjera siq janë bashkëpunimi ndër-institucional, avancimi i arsimimit ligjor, dhe poashtu projekt-idenë e mëposhtëme për rritjen e llogaridhënies dhe parandalimin e keqpërdorimit të parasë publike në institucionet e Kosovës.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.4 Rritja e llogaridhënies dhe parandalimi i keqpërdorimit të parasë publike në institucionet e Kosovës</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, MPB, KGJK, KPK, IGJK, AKSP, PK, Ombudspersoni, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit duke mbështetur të gjitha institucionet në zbatimin e ligjit dhe në të qenurit sa më eficient dhe efektiv në aktivitetet e tyre
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe kapaciteteve njerëzore në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit
<b>Përshkrimi:</b>	Në aspektin e parandalimit të korrupsionit në përgjithësi dhe mbikqyrjen dhe kontrollin e financave publike në vecanti, përvec mekanizmave të jashtëm të kontrollit, siq janë komisionet parlamentare për mbikqyrjen e

institucioneve përkatëse, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), Organet e Prokurimit Publik (OPP), dhe Agjencia Kundër-Korrupsionit (AKK), rol të rëndësishëm luajnë edhe mekanizmat e brendshëm të kontrollit në institucionet përkatëse për menaxhim financiar, prokurim dhe auditim.

Përkundër ekzistimit të një baze ligjore të mirë (Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, Ligji për Auditim të Brendshëm, si dhe Ligji për Prokurimin Publik) segmentet brenda-institucionale të kontrollit financiar, si auditimi i brendshëm, përballen me sfida siq janë mungesa e konsolidimit të plotë, numri i vogël i personelit në krahasim me volumin e punës etj. Si pasojë, mbikqyrja e shpenzimeve dhe e menagjimit financiar nëpër institucione lë për të dëshiruar dhe ka shqetësime për menaxhimin e prokurimit publik.

Fushat ku ka nevojë për përmirësime janë mënyra e shqyrtimit të ofertave, paqartësitë në specifikimin e njërive gjatë aplikimit dhe vështirësitë e shumta në mbikqyrjen e prokurimit publik. Andaj, përveq forcimit të mekanizmave të jashtëm të kontrollit financiar (Zyra e Auditorit Gjeneral; Agjencioni Anti-Korrupsion; Organi Shqyrtues i Prokurimit), nevojitet asistencë në analizimin e kapaciteteve ekzistuese të mekanizmave brenda-institucionale të mbikqyrjes dhe në forcimin e kapaciteteve të këtyre mekanizmave.

Luftimi dhe parandalimi i keqpërdorimeve të financave publike përmes fuqizimit të mëtutjeshëm të mekanizmave të brendshëm, siq janë Njësitë e Auditimit të Brendshëm, do të përmirësonte më shumë menaxhimin e financave publike, parandalimin e keqpërdorimeve, dhe do tëkontribuonte në përmirësimin e sundimit tëligjit në Kosovë.

Kjo projekt-ide shihet si prioritet imediat në përmbushjen objektivit të përmirësimit të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Meqenëse projekt-idetë e tjera që adresojnë parandalimin dhe luftimin e korrupsionit kanë të bëjnë me përforcimin e mekanizmave të jashtëm të kontrollit, fokusimi në mekanizmat e brendshëm të kontrollit në institucionet përkatëse për menaxhim financiar, prokurim dhe auditim komplementon mirë ato dhe njëkohësisht përbën një përpjekje të re dhe të nevojshme për të luftuar korrupsionin nga të gjitha drejtimet.



<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.5 Përmirësimi i sistemit penitenciar (shërbimet korrektuese dhe sprovuese)</b>
<b>Vlera:</b>	1.5 MEUR (faza I) 1.5 MEUR (faza II)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza I) Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza II)
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, SHKK, SHSK
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionenë përforcimin e sundimit të ligjit lidhur me përmirësimin e sistemit penitenciar
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi dhe avancimi i sistemit për ekzekutimin e sanksioneve penale sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) është themeluar menjëherë pas luftës, më 05 Nëntor 1999 fillimisht me hapjen e Qendrës së Paraburgimit në Prizren. Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet në Kosovë synon të korrektojë dhe risocializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë.</p> <p>Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK) ka filluar së funksionuari në dhjetor 2002, fillimisht nën autoritetin e UNMIK-ut, dhe në prill 2006 përgjegjësitë e SHSK-së barten te Ministria e Drejtësisë. Përgjegjësitë e SHSK-së janë kontribuimi në reduktimin e krimit, zvogëlimin e shkallës së recidivizmit, krijimin dhe rritjen e sigurisë për shoqërinë tonë.</p> <p>Në kuadër të reformës së drejtësisë penale, në gusht të vitit 2013 ka hyrë në fuqi ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale si baza për punën e SHSK-së dhe SHKK-së. Në bazë të këtij Ligji, SHSK dhe SHKK si agjencione të zbatimit të ligjit, për aktivitetet e tyre i raportojnë direkt Ministrit të Drejtësisë. Këto dy agjencione për zbatim të ligjit kanë marrë një sere masash për përmirësimin e performances së tyre konform legjislacionit të ri.</p> <p>Sido që të jetë këto institucione vazhdojnë të përballen me vështirësi të kushteve për punë. Këtu vlen të përmendet SHSK, stafi i të cilit ende vazhdon të veprojë nëpër ndërtesa me qira dhe kontejnerë jashtë çdo</p>

standardi të sigurisë. Ndërtimi ndërtesave të prokurorive nëpër qarqet e Kosovës është paraparë brenda 2 apo 3 viteve të akomodojë dhe stafin e SHSK-së.

Për të pare nevojat e secilit agjencion veç e veç më poshtë do të jepen përshkrimet e duhura:

### **SHSK**

Në kuadër të reformave në fushën e shërbimeve korrektuese dhe sprovuese Ministria e Drejtësisë ka hartuar projektligjin për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me Vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht. Ky ligj do të adresojë një rën prej fushave për të cilën SHSK ka nevojë për mbështetje të donatorëve. Ky projektligj është hartuar dhe ka kaluar leximin e parë në Kuvend dhe pritet të miratohet gjatë këtij viti, ndërkohë që zbatimi i tij sipas të gjitha gjasave mund të fillojë në vitin 2016. Zbatimi i këtij ligji ka kosto të lartë, si në aspektin e pajisjeve elektronike ashtu edhe në atë të trajnimeve.

Qëllimi i ligjit për mbikëqyrjen elektronike është rritja e sigurisë publike dhe garantimi i ekzekutimit efektiv të vendimeve gjyqësore dhe atyre të Panelit për lirim me kusht. Për implementimin e këtij ligji nevojitet Mikëqyrja Elektronike (ME), si mekanizëm që garanton zbatimin e vendimeve përmes përcaktimit në kohë reale të vend-ndodhjes së një personi. Realizimi i ME-së do ta bëhet nga Shërbimi Sprovues, si organ përgjegjës për realizimin e ME-së, dhe nënkupton ndërtimin e një salle operative të pajisur me sistemin dhe aparatat e nevojshme, blerjen e pajisjeve elektronike për personat e mbikëqyrur, si dhe programe trajnimi adekuat të personelit të SHSK-së për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Ligji për ME ka marrë parasysh praktikat më të mira të BE-së dhe rajonale.

Asistenca në implementimin e këtij ligji do të ndihmonte shumë në përmirësimin e sundimit të ligjit në Kosovë duke përmirësuar, në mes tjerash, zbatimin më efikas të vendimeve të gjykatave, duke mundësuar aplikimin më të gjërë të dënimeve alternative, dhe duke ndikuar kështu reduktimin e krimit, zvogëlimin e shkallës së recidivizmit, reduktimit të dhunës në familje, dhe përgjithësisht krijimin dhe rritjen e sigurisë për shoqërinë.

Për të pasur një qëndrueshmëri të trajnimeve duhet që Agjencia për Siguri Publike (ASK) të dizajnojë programe trajnimi të vazhdueshme në të cilat do të trajnoheshin jo vetëm stafi i SHSK-së por edhe agjenci tjera që ndërlidhen me aktivitetet e SHSK-së. Poashtu, duke ditur që Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ofron trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë, do të

duhej që në të ardhmen të dizajnonte programe trajnimi të përbashkëta ku do të trajnoheshin gjyqtarët, prokurorët, avokatët, SHSK dhe institucione tjera për të përforcuar zbatimin e ligjit si dhe për të rritur bashkëpunimin dhe koordinimin mes tyre.

### **SHKK**

Edhe SHKK konform Ligjit të ri për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka ndërmarrë një sërë masash sa i përket reformimit të shërbimeve korrektuese. P.sh. forma e përzgjedhjes së drejtorëve të burgjeve ka ndryshuar dhe kjo në praktikë ka sjellur vështirësi. Në aspektin e infrastrukturës fizike SHKK ka shënuar progres sidomos në përfundimin e Burgut të Sigurisë së Lartë dhe ndarjen e mjeteve për ndërtimin e për qendrave korrektuese për Prishtinë dhe Gjilan.

Në vazhden e reformës së drejtësisë penale, puna e SHKK-së në terren duket të mos jetë e lehtë sidomos nëse flasim për bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstytucional. Kjo vazhdon të përbëjë pengesë në mbarëvajtjen e punëve të SHKK-së. Prandaj, rishqyrtimi i drejtësisë penale pritët të prek dhe SHKK-në në tërësinë e tij.

Në aspektin institucional, shërbimet mjekësore të SHKK-së janë bartur te Ministria e Shëndetësisë. Kjo bartje e përgjegjësisë do të duhej shqyrtuar brenda për të parë se a ka nevojë të përmirësohet diçka në këtë drejtim në mënyrë që të burgosurve tu ofrohet ndihmë dhe trajtim adekuat mjekësor sipas praktikave dhe standardeve ndërkombëtare për trajtimin e të burgosurve.

Ashtu sikurse shumica e institucioneve të sundimit të ligjit edhe SHKK përballet me vështirësi sa i përket sistemit të statistikave. Kjo vështirësi e rregullisht e ka përcjellur SHKK-në, prandaj dixhitalizimi i të dhënave dhe krijimi i një qendre operative për menaxhimin dhe monitorimin e të dhënave do të rriste efikasitetin dhe efektivitetin në të menaxhuarit e burgjeve sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

Në vende e ndryshme të BE-së (p.sh. Suedi, Finlandë), institucione të ngjashme me SHSK-në dhe SHKK-në veprojnë nën një ombrellë të përbashkët në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Në kuadër të rishikimit të drejtësisë penale duhet shikuar mundësinë e futjes së këtyre dy agjencioneve nën një ombrellë të përbashkët duke pasur parasysh se të dyja institucionet kanë për qëllim korrektimin e personave që kanë rënë ndesh me ligjin.

Edhe sa i përket ngritjes së kapaciteteve të stafit të SHKK-së do të duhej që Agjencia për Siguri Publike (ASK) të dizajnojë programe trajnimi të vazhdueshme në të cilat do të trajnoheshin jo vetëm stafi i SHKK-së por

	<p>edhe agjenci tjera që ndërlidhen me aktivitetet e SHKK-së. Në këtë aspekt edhe IGJK do të duhej kontribuar në përmirësimin e shërbimeve korrektuese duke krijuar programe trajnimi të vazhdueshme për gjyqtarë, prokurorë, avokatë, SHKK dhe institucione tjera që merren me shërbime korrektuese për të përforcuar zbatimin e ligjit si dhe për të rritur bashkëpunimin dhe koordinimin mes tyre.</p> <p>Për më tepër asistencë do të duhej përqendruar në këto aspekte: hartimin dhe zbatimin e programeve për edukim profesional për të burgosurit sipas standardeve të BE-së, ngritja e vetëdijes së publikut (p.sh. punëdhënësve, qendrave për punësim, institucioneve publike, etj) sa i përket nivelit të kapaciteteve të dijeve dhe njohurie të të burgosurve për tu risocializuar pas përfundimit të dënimit, sanksionet alternative të forcohen edhe më tutje, ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët e SHSK-së, gjyqtarët, prokurorët që të përdorin praktika pune efçente dhe protokolle koordinimi sipas standardeve të BE-së sa i përket dënimeve alternative, të dizajnohen dhe implementohen programe që do të mobilizonin të gjithë akterët (përfshirë OJQ-të) në mënyrë që të kontribuohet në implementimin efçent të dënimeve alternative.</p> <p>Si përmbledhje për SHSK dhe SHKK-në mund të thuhet se një sistem penitenciar i avancuar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare do të krijonte kushte për trajtim adekuat të të burgosurve, ri-socializimin e tyre dhe lehtësimin për rikthimin e tyre të shëndoshë në komunitet me premisa për të vazhduar një jetë normale dhe me një ndjenjë të përforcuar të përbashkësisë. Kjo do të rriste sigurinë e qytetarëve dhe sikundër që do të rriste besimin e publikut në sistemin penitenciar.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.6 Avancimi i mbrojtjes së dëshmitarëve</b>
<b>Vlera:</b>	0.7 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, MPB, KGJK, KPK dhe institucione tjera të varësisë
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit për të avancuar sistemin e drejtësisë penale me praktikat më të mira të BE-së
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i mekanizmave institucional për mbrojtjen e dëshmitarëve
<b>Përshkrimi:</b>	Në korrik të vitit 2011 është miratuar Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Zbatimi i këtij ligji mbetet sfidë për institucionet e Kosovës duke pasur

	<p>parasysh mungesën e infrastrukturës së nevojshme dhe kapaciteteve profesionale të limituara për të siguruar mbrojtje të dëshmitarëve. Mbrojtja e dëshmitarëve ka qenë një sfidë që ka përcjellur Kosovën që nga koha e UNMIK-ut e deri me tani. Institucionet e Kosovës po mundohen që së bashku me EULEX-in të krijojnë një sistem efektiv për mbrojtjen e dëshmitarëve.</p> <p>Policia e Kosovës ka themeluar Drejtorinë për Mbrojtje të Dëshmitarëve dhe është në fazën e funksionalizimit të saj. Megjithatë, ngritja e kapaciteteve profesionale në këtë drejtim dhe mungesa e pajisjeve të duhura mbeten një sfidë për Policinë e Kosovës. Edhe institucionet tjera, si Gjykatat e Prokuroritë, nuk e kanë të rregulluar sa duhet infrastrukturën fizike dhe të IT-së, e cila do të siguronte një mbrojtje efektive të identitetit të dëshmitarëve.</p> <p>Prandaj, asistenca e donatorëve do të duhej përqendruar në përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe të IT-së, përfshirë pajisje të ndryshme logjistike, nëpër institucionet që merren me mbrojtjen e dëshmitarëve. Natyrisht që ngritja e kapaciteteve profesionale nuk do të duhej përjashtuar në këtë drejtim.</p> <p>Një sistem efektiv i mbrojtjes së dëshmitarëve do të kishte efekte positive shumëdimensionale në përforcimin e sistemit gjyqësor dhe rritjen e efektivitetit në dënimin e kryesëve të veprave të ndryshme penale, kryesisht veprave të rënda penale. Ky sistem do të krijonte kushtet për një siguri më të madhe për qytetarët dhe një rritje të besimit të publikut ndaj sistemit të drejtësisë në tërësinë e tij.</p> <p>Ky projekt shihet si prioritar edhe për shkak të nevojës që ka Kosova t'i zhvillojë kapacitetet në fushat në të cilat deri më tani rol të rëndësishëm ka luajtur EULEX-i. Si i tillë, ai është poashtu në bashkërendi të mirëfilltë me projektet e tjera si ai për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda, por edhe me projektet që kanë të bëjnë me përmirësimin e sektorit të IT-së në sistemin e sigurisë.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.7 Përmirësimi i sistemit IT-së për menaxhimin e kufirit</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR (faza I) 3 MEUR (faza II)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza I)  Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza II)

<b>Përfituesit direkt:</b>	PK, DK, Prokuroritë, Gjykatat, Agjencia e Regjistrimit Civil, MPJ (seksioni i vizave), MPB (azili dhe migracioni), etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit duke mbështetur institucionet e drejtësisë dhe zbatimin e ligjit në të qenurit sa më eficient dhe efektiv në aktivitetet e tyre
<b>Qëllimi:</b>	Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e sigurisë së lëvizjes së personave dhe mallrave
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Në janar 2009 BE-ja ka filluar mbështetjen e Policisë së Kosovës në fillimin e zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Kufirit. Ky sistem është dixhital dhe kërkon lidhjen dixhitale të Policisë Kufitare me Doganat, Prokuroritë, Gjykatat, Agjencinë e Regjistrimit Civil, Ministrinë e Punëve të Jashtme (seksioni i vizave), Ministrinë e Punëve të Brendshme (azili dhe migracioni), etj. Edhe pse hapat e parë janë bërë në policinë kufitare të Kosovës, sistemi i menaxhimit të kufirit kërkon përpjekje të pandalshme për ndërtimin e tij.</p> <p>Megjithatë, për të pasur një sistem të integruar për menaxhimin e kufirit sipas sistemit Schengen, kërkohet instalimi i softwerëve në seksionin e vizave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Qendrën e Regjistrimit të Veturave dhe seksionin e azilit dhe migracionit në kuadër të MPB-së, si dhe në Dogana.</p> <p>Deri në fund të vitit 2016 pritet që të gjitha institucionet e sipërpërmendura të ndërtojnë sistemet e tyre dixhitale individuale, të cilat më pastaj do të lidheshin dhe integroheshin në një me sistemin e menaxhimit të kufirit.</p> <p>Përparësia e instalimit të këtij sistemi është se databazat komunikojnë mes vete (interfacing) dhe kjo rrit sigurinë e qytetarëve të Kosovës, ul kohën për kalim në një pikëkalim kufitar për njerëz dhe mallra, rrit nivelin e zbulimit të krimit kufitar, ul numrin e personave që kalojnë ilegalisht kufirin dhe në përgjithësi një sistem i tillë, që është në përputhje me Sistemin Informativ të Schengenit (SIS), sigurisht që do të kontribuonte në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë si një nga prioritetet kryesore të Institucioneve të Kosovës drejt Integritimit Evropian.</p> <p>Implementimi i këtij projekti jo vetëm që është i kushtueshëm, por kërkon edhe bazë ligjore të qartë që do të lejonte dixhitalizimin e databazave, lidhjen dhe integrimin e tyre si dhe do të kërkonte një vlerësim të detajuar (ndoshta Studim të Fizibilitetit) për arsyeshmerinë dhe realizueshmerinë e këtij projekti.</p> <p>Duke llogaritur që gjykatat dhe prokuroritë kanë filluar me zhvillimin e</p>

	sistemit të përbashkët dixhital për menaxhimin e lëndëve, projekt ky që pritet të perfundojë në fund të vitit 2016, atëhere periudha kohore për fillimin e projektit për sistemin e menaxhimit të kufirit do të ishte në përputhje me periudhën kohore të kësaj strategjie 2016-2019. Njëkohësisht, ky projekt ndërton mbi të arriturat në sektorin e IT-së.
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.8 Mbështetje për parandalimin dhe luftimin e krimeve komplekse (krimet ekonomike, financiare, ekonomia joformale, krimi kibernetik, shpërlarja e parave, terrorizmi)</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, MPB, PK, DK, ATK, KPK, KGJK, NJIF, AKK, Parlamenti i Kosovës
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit duke përmirësuar dhe avancuar hetimet ndaj shpërlarjes së parave, ekonomisë joformale, terrorizmit dhe krimin kibernetik
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, krimin ekonomik, shpërlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare e kibernetike
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Ashtu sikurse vendet e rajonit, edhe Kosova është duke u përballur me sfida të ndryshme sa i përket luftimit të ekonomisë joformale, shpërlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare dhe krimeve kibernetike. Për tu ballafaquar me këtë problematikë, janë krijuar politika dhe ligje që e adresojnë këtë fushë. Poashtu, janë themeluar edhe mekanizmat e nevojshëm.</p> <p>Sido që të jetë, fushat e lartpërmendura janë të reja dhe institucioneve të Kosovës u mungojnë kapacitetet e duhura për t'ju qasur si duhet kësaj problematike. Bashkëpunimi ndërinstytucional duket të mos jetë në nivelin më të mirë të mundshëm për të adresuar këto çështje.</p> <p>Përkundër ndihmës aktuale të donatorëve për të forcuar mekanizmat për parandalim dhe luftim, kjo fushë ka nevojë për mbështetje të mëtejme përfshirë: hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit sipas praktikave më të mira të BE-së; zhvillimin e procedurave të inteligjencës dhe rritjen e shkëmbimit të informacionit duke vlerësuar dhe organizuar bashkëpunimin mes sistemeve të IT-së të ARB-së, AKK, ARC-së, NJIF-së, Policisë, Doganës, ATK-së, prokurorive dhe gjykatave, etj.</p>

Në përgjithësi aktivitetet kryesore që do të mbështeten nga ky projekt janë: 1) vlerësimet periodike të rrezikut nga korrupsioni dhe ndërmarrja e veprimeve të nevojshme konform rrezikut; 2) sigurimi i zbatimit dhe implementimit efektiv të kornizës së re për luftimin e korrupsionit 2013-2017 dhe ndërmarrja e veprimeve të nevojshme për këtë; 3) rishikimi i kornizës ligjore kundër korrupsionit përfshirë konfliktin e interesit, pastaj rishikimi i përgjegjësive institucionale kundër korrupsionit, përfshirë konfliktin e interesit, etj.; 4) rishikimi i aspekteve organizative, institucionale, ndër-institucionale të KGJK-së e KPK-së dhe institucioneve tjera (p.sh. AKK, Zyra e Prokurorit Disiplinor -ZPD-) sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit brenda dhe jashtë-institucional; 5) rishikimi i aspekteve organizative, institucionale, etj, të Policisë së Kosovës, me theks të veçantë emërimin, promovimin, pensionimin, post-pensionimin, masat disiplinore, etj.; 6) rishikimi i kodit të etikës së Anëtarëve të Parlamentit, aspekteve të konfliktit të interesit, pastaj forcimi i kapaciteteve të tyre sa i përket veprimtarisë mbikqyrëse të punës së ekzekutivit dhe agjencioneve të pavarura, duke kontribuar kështu në parandalimin e korrupsionit, etj.

Pastaj aspekt tjetër i nevojshëm është zhvillimi i kapaciteteve teknike për funksione analitike duke i ofruar NJIF-së sisteme të avancuara të IT-së; përmirësimi i infrastrukturës fizike të NJIF-së në përputhje me *Egmont Group for Financial Intelligence Units*; zhvillimi i mëtejshëm dhe i vazhdueshëm i kapaciteteve të stafit të NJIF-së duke organizuar praktikume të ndryshme nëpër institucione homologe ndërkombëtare; avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të NJIF-së duke organizuar takime ndërkombëtare të cilat do të ndikonin në përforcimin e bashkëpunimit rajonal dhe më gjerë.

Sa i përket krimit kibernetik, mund të thuhet se kjo problematike është në rritje në Kosovë dhe duhet adresuar. Në përgjithësi parandalimi dhe luftimi i krimeve kibernetike është një sfidë e madhe kështu që është më se e nevojshme që të kihet angazhim dhe përkrahje financiare për ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e pajisjeve të nevojshme si dhe avancimin e bashkëpunimit mes akterëve. Për të adresuar këtë problematikë, para së gjithash duhet krijuar një bazë ligjore sipas praktikave më të mira të BE-së, duhet u rritur siguria kibernetike në nivel kombëtar, plotësimi i standardeve më të larta evropiane në fushën e krimeve kibernetike, themelimi i mekanizmave për hetimin e krimeve kibernetike, etj.

Përforcimi i mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, shpërlarjes së parave, financimit të terrorizmit, krimit financiar dhe kibernetik do të kishte efekte positive në zvogëlimin e ekonomisë joformale dhe rritjen e të hyrave shtetërore. Njëkohësisht kjo do të përforcojë infrastrukturën shtetërore, do të përmirësojë dukshëm



	<p>konkurrencën e shëndoshë në treg dhe krejt në fund do të zvogëlojë kriminalitetin në shoqëri.</p> <p>Si i tillë, kjo projekt-ide ndikon drejtëpërsëdrejti në përforcimin e mekanizmave që sigurojnë zbatim eficient dhe efektiv të ligjiit si dhe në zhvillimin e resurseve të nevojshme njerëzore për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizar dhe krimeve të tjera të rënda. Sikur porjekt-ideja për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore apo ajo për avancimin e shërbimeve forenzike, edhe kjo projekt-ide prekë dy fusha të rëndësishme të krimeve që po sfidojnë sektorët e sigursë të të gjitha vendeve, dhe ku Kosova ka nevojë për zhvillim të mëtutjeshëm të kapaciteteve.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.9 Avancimi i shërbimeve forenzike</b>
<b>Vlera:</b>	1.5 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, MPB,
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit duke përmirësuar hetimet në Kosovë
<b>Qëllimi:</b>	Avancimi dhe unifikimi i shërbimeve forenzike në Kosovë
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Agjencia e Kosovës për Forenzikë në kuadër të MPB-së kryen ekspertiza të ndryshme që ndihmojnë policinë, prokurorinë, gjyqësorin dhe agjencitë tjera për zbatimin e ligjit, në zbardhjen e rasteve dhe dënimin e kryesve të veprave penale në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Kjo Agjenci deri me tani është anëtarësuar në Asociacionin Ndërkombëtar të Instituteve të Forenzikes, me synim për tu anëtarësuar në Rrjetin Evropian të Instituteve të Shkencës së Forenzikës, si anëtare e plotë.</p> <p>Ndërkohë, Departamenti i Mjekësisë Ligjore në kuadër të MD-së ofron shërbime profesionale mjeko-ligjore. Akreditimi i laboreve mjeko-ligjore sipas standardeve Europiane (ISO), është objektivi prioritar i Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Laboratori Gjenetik i ADN-së mbetet si synim qeveritar që do ndihmonte ne procesin e identifikimeve antropologjike dhe shërbimeve tjera mjeko-ligjore.</p> <p>Këto dy institucione veprojnë të pavarura prej njëra tjetrës. Prandaj, për të rritur efektivitetin në zbardhjen e rasteve dhe dënimin e kryesve të veprave penale do të krijohet një trup i vetëm. Formimi i këtij trupi të</p>

	<p>vetëm së pari kërkon plotësim ndryshimin e bazës ligjore dhe pastaj krijimin e strukturas së re. Mbështetja do të duhej përqendruar më pastaj në ngritjen e kapaciteteve të këtij institucioni të ri, krijimin e procedurave standard operative për punë efektive në fushën e forenzikës sipas standardeve të BE-së.</p> <p>Në përgjithësi shërbimet forenzike duhet përcjellur trendet dhe teknologjinë që përdoret në lëmitë profesionale kriminalistike, të cilat do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit dhe uljen e nivelit të kriminalitetit në përgjithësi, shpejtësinë dhe saktësinë e kryerjes së ekspertizave kriminalistike, uljen e kostos dhe shpenzimeve dhe në integritetin e dëshmive dhe punës profesionale në përgjithësi. Realizimi i këtij projekti, rrjedhimisht, do të ndikonte drejtëpërsëdrejti në zhvillimin e resurseve moderne njerëzore dhe teknike për parandalimin dhe luftimin e krimit. Si i tillë, kjo projekt-ide është në përputhshmëri të plotë me projekte të tjera si forcimi i inteligjencës financiare dhe luftës kundër krimit kibernetik, etj.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.10 Përmirësimi i sistemit të emergjencave</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR (faza I)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	<p>Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016  Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza I)</p> <p>Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017  Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza II)</p>
<b>Përfituesit direkt:</b>	AME, FAK, AMRSB, PK, Zjarrëfikësit, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit duke përmirësuar sistemin e emergjencave
<b>Qëllimi:</b>	Zhvillimi dhe avancimi i mëtejshëm i sistemit të emergjencave në Kosovë sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Sistemi i Integruar për Menaxhimin e Emergjencave (SIME) ofron kornizë të qëndrueshme gjithëkombëtare për të mundësuar që qeveritë e të dyja niveleve (lokal dhe qendror), organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe sektori privat, të punojnë së bashku në parandalimin, mbrojtjen, reagimin, rimëkëmbjen dhe zvogëlimin e efekteve të incidenteve pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre.</p> <p>Dihet që Kosova është përballur me situata emergjente, ku zingjiri i komunikimit, i paraparë në SIME, nuk është respektuar. Nisur nga kjo, zbërthimi i mëtejshëm, i ndarë në kategori emergjencash, do të rezultonte me respektimin e zingjirit të komunikimit. Meqë ngjarjet emergjente fillojnë në nivel komune, do të thotë se përgjegjësia bie mbi komunën, e</p>

nëse eskalon situata, atëherë kompetencat tejkalohe në qendra rajonale.

Nëse situata tejkalon edhe nivelin e përgjegjësisë dhe mundësisë për veprim të rajonit të caktuar, atëherë kërkesa shkon në nivel të Agjencisë për Menaxhim të Emergjencave. Nëse përmbushen elementet e parapara me ligj, Ministria për Punë të Brendshme i jep propozim Kryetarit të shtetit, e ky i fundit vlerëson nëse duhet shpallur gjendjen e jashtëzakonshme.

Përkundër bazës së politikave dhe bazës ligjore, sektori i menaxhimit të emergjencave ka nevojë të theksuar për përmirësim dhe avancim të vazhdueshëm. Disa nga pikat që duhet adresuar janë: mungesa e kapaciteteve të Policisë së Kosovës në menaxhimin e turmave dhe protestave të dhunshme; mosekzistenca e një qendre operative për menaxhimin e situatave emergjente; kapacitetet e ulëta të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) për të marrë përgjegjësitë nga Forcat e Armatura të Kosovës (FAK); dhe vështirësitë në menaxhimin e materieve të rrezikshme.

Për të përmirësuar sistemin e emergjencave në tërësinë e tij kërkohet që:  
i) institucionet e emergjencave të kenë pajisjet e nevojshme për përballimin e situatave emergjente; ii) të themelohet komponenta e Kërkimit dhe Shpëtimit Urban (KSHU) që kërkohet edhe sipas standardeve ndërkombëtare dhe e cila do të ndihmonte në kërkim dhe shpëtim në rrënoja, përmbajtje, zjarre dhe fatkeqësi tjera natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri; iii) AME duhet ngritur kapacitetet operacionale për të marrë rolin udhëheqës në menaxhimin me materie të rrezikshme (ky funksion për momentin është në kuadër të FAK-ut).

Ndërkohë që, Agjencia për Menaxhimin e Rrezatimit dhe Sigurisë Bërthamore (AMRSB) që është në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), do të duhej të shërbente për çështje të politikave dhe strategjive ndaj rrezatimit dhe sigurisë bërthamore dhe jo për misione operacionale pasi këto të fundit do të duhej sipërmarrur nga AME, e cila është në kuadër të MPB-së.

Efektet e përmirësimit dhe avancimit të sistemit të emergjencave do të rritnin sigurinë në kontrollin, menaxhimin e turmave, mundësitë për ruajtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve dhe atë publike. Për më tepër, do të ofrohen shërbime shumë më cilësore, profesionale dhe të avancuara për tu përgatitur, mbrojtur, reaguar dhe rimëkëmbur në mënyrë sa më profesionale nga rreziqet e të gjitha llojeve përfshirë materiet e rrezikshme, etj. E gjithë kjo do të kontribuonte në përforsimin e mekanizmave që sigurojnë zbatim eficient dhe efektiv të ligjit, përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionim efektiv dhe

	të koordinuar të agjencioneve, dhe zhvillim të resurseve të nevojshme njerëzore në sektorin e sigurisë publike.
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.11 Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR (faza I) 1 MEUR (faza II)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017 (faza I) Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza II)
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, MPB, KGJK, KPK, IGJK, AKSP, PK, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit duke mbështetur institucionet e drejtësisë dhe zbatimit të ligjit në të qenurit sa më eficient dhe efektiv në aktivitetet e tyre
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore.
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që ta parandalojnë dhe luftojnë trafikimin me qenie njerëzore, në mënyrë që Kosova të mos jetë as burim e as vend transit ose destinim i mundshëm i trafikimit me qenie njerëzore. Deri tani Kosova ka zhvilluar një bazë ligjore dhe dokumente strategjike e operative për ta përmbushur këtë qëllim. Kodi i ri penal cakton masa edhe më të ashpëra ndëshkuese për trafikim, janë përmirësuar procedurat standarde për identifikimin dhe asistencën e viktimave të trafikimit dhe ka patur edhe fushata të vedijësimit për parandalimin e trafikimit. Megjithatë mbesin ende sfida.</p> <p>Në këtë drejtim, nevojitet asistencë për institucionet relevante që Kosova t'i përmbush të gjitha standardet për eliminimin e trafikimit. Asistenca në këtë fushë do të ndihmonte në: përforcimin e ndjekjes dhe dënimit e trafikuesëve; trajnimet e avansuara kundër trafikimit për gjyqtarë, prokurorë dhe policë e zyrtarë të tjerë; rishikimin e planit kombëtar dhe rishikimin e mënyrës se si delegohen përgjegjësitë; ngritjen e kapaciteteve administrative për t'u përballur me përafrimin e legjislacionit të BE-së; përmirësimin e asistencës për viktimat e trafikimit, sidomos sa i përket rehabilitimit të viktimave përmes përmirësimit të funksionimit dhe qasjes në strehimore; avancimin e teknikave të hetimit të trafikimit të qenieve njerëzore; koordinimin më të mirë në mes të policisë, prokurorisë,</p>

	<p>gykatave, doganës, administratës tatimore dhe Inspektoriateve përkatëse etj.</p> <p>Përforcimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore është qenësor për përforcimin e sundit të ligjit në Kosovë, për përmirësimin e qasjes në drejtësi, dhe për integrimin e Kosovës në BE. Sikur edhe projekt-ideja për forcimin e inteligjencës financiare dhe luftës kundër krimit kibernetik, apo ajo për avancimin e shërbimeve forenzike, edhe kjo projekt-ide prekë një fushë të rëndësishme të krimeve që po sfidojnë sektorët e sigursë të të gjitha vendeve, dhe ku Kosova ka nevojë për zhvillim të mëtutjeshëm të kapaciteteve. Ndër të tjera, kjo projekt-ide komplementon edhe projekt-idenë për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda, atë të avancimit të arsimimit ligjor dhe të sigurisë, qasjes në drejtësi etj.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.12 Përmirësimi i infrastrukturës së IT-së në Policinë e Kosovës</b>
<b>Vlera:</b>	3 MEUR (faza I) 4 MEUR (faza II) 5 MEUR (faza III)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza I)  Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza II)  Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2017-2018 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2019-2020 (faza II)
<b>Përfituesit direkt:</b>	PK, sektori i Emergjencave, DK, SHKK, Njësia e Zjarrfikësve, Forenzika, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për përforcimin e sundimit të ligjit në Kosovë duke mbështetur institucionet e zbatimit të ligjit në përmirësimin e efijencës dhe efektivitetit të tyre
<b>Qëllimi:</b>	Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të Kosovës në fushën e sigurisë si dhe rritja e efijencës dhe efektivitetit të agjencioneve të zbatimit të ligjit në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit
<b>Përshkrimi:</b>	Zhvillimi i një komunikimi të integruar, të sigurtë dhe të enkriptuar të sistemeve të radios dhe telefonisë, me mundësi të ndërlihdjes në mes agjencioneve të ndryshme mbarëkombëtare, është jetik për policinë, e cila për momentin është duke përdorur sistemin analog të komunikimit, i cili është i pasigurt nga nderhyrjet e ndryshme gjatë komunikimit përmes radiove. Ndryshimi nga transmetimet analoge konvencionale në sistemet

inteligjente të radiokomunikimit digjital është një hap i madh për të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit, dhe në veçanti për Policinë e Kosovës si bartëse kryesore e ofrimit të sigurisë për qytetaret e vendit.

Mungesa e Sistemit Informativ Gjeografik (GIS) i krijon vështirësi policisë në mbledhjen, krijimin, përpunimin, ruajtjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave me komponentë hapësinore në formë dixhitale. Aplikimi i GIS do të mundësonte identifikimin dhe analizimin e problemeve në aspektin gjeografik, dhe njëkohësisht do të ndihmonte në paraqitjen e problemeve në mënyrë vizuale si dhe krijimin e sistemit informativ që nevojitet për analiza hapësinore të aktiviteteve policore.

Poashtu, policia ka mungesë të: i) pajisjeve për përgjime të internetit dhe telefonisë fikse; ii) pajisjeve për gjurmim dhe hetime të krimeve kibernetike; iii) vetura speciale për vëzhgim dhe operacione të fshehta; iv) pajisje forenzike për marrjen e dëshmive shkencore në vend të ngjarjes, etj.

Policisë poashtu i mungon një qendër e dytë mobile për të dhëna. Krijimi i kësaj qendre do të ruante të dhënat e policisë në raste të fatkeqësive të ndryshme madhore. Pra, me rastin e ekzistimit të kësaj qendre do të vazhdonte funksionimi i sistemeve dhe shërbimeve të policisë në rast të dështimit të Qendrës Kryesore për të Dhëna.

Sistemi i integruar i komunikimit do të siguronte zbatimin e ligjit nga të gjitha agjencionet e zbatimit të ligjit, vecanërisht nga policia dhe doganat, duke penguar kështu aktivitetet kriminale jo vetëm përgjatë vijës kufitare me shtetet fqinje por edhe në brendi të vendit.

Krijimi i GIS do të mundësonte ngritjen e një niveli të lartë të gatishmërisë për menaxhimin dhe monitorimin e detyrave të policisë, prandaj për këtë është e nevojshme baza vektoriale e shenimeve të cilat mund të kthehen në 3D dhe, bazuar në sistemin e koordinatave, të mundësohet analizë dhe planifikim shumë më i shpejtë dhe i saktë para intervenimeve në situata të ndryshme.

Në përgjithësi, pajisja e policisë me sistemet dhe pajisjet e sipërpërmendura do të rriste dukshëm eficienten dhe efektivitetin e policisë dhe agjencioneve tjera të zbatimit të ligjit në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kjo poashtu do të rriste nivelin e bashkëpunimit dixhital me vendet e rajonit, në përputhje me standardet e BE-së. Njëkohësisht, kjo projekt-ide do të ishte në përputhje me përpjekjet e tjera të avancimit të përdorimit të IT-së në sektorin e ligjit, si dhe me zhvillimin e resurseve njerëzore dhe teknike në parandalimin e krimit dhe korrupsionit.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.13 Përmirësimi i infrastrukturës fizike të Policisë së Kosovës</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Perfituesit direkt:</b>	Policia e Kosovës (PK)
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për përforcimin e sundimit të ligjit duke mbështetur institucionet e zbatimit të ligjit në të qenurit sa më eficient dhe efektiv në aktivitetet e tyre
<b>Qëllimi:</b>	Përmirësimi i mjedisit të punës në agjencitë e zbatimit të ligjit duke përmirësuar infrastrukturën fizike të tyre
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Përkundër përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës fizike, Policia e Kosovës ende ka vështirësi në këtë drejtim. P.sh. Drejtoria e re e themeluar në veri operon në objektet e Stacionit Policor Veriu. Duke pasur parasysh shtimin e njësiteve dhe personelit në këtë Drejtori, është i nevojshëm ndërtimi i një objekti të ri, i cili do t'i plotësonte më mirë nevojat e Drejtorisë Rajonale në Veri. Në Zubin Potok Policia e Kosovës, që nga viti 2005, është duke e shfrytëzuar me qira një objekt privat. Stacioni policor në Zveçan funksionon në një objekt të kompleksit "Trepca".</p> <p>Duke parë kushtet jo të favorshme për punë të këtyre tri stacioneve policore është më se i nevojshëm ndërtimi i objekteve të reja, për të përmirësuar kështu kushtet për punë në Policinë e Kosovës. Për më tepër, ndërtimi i stacioneve të reja policore, në aspektin ekonomik, do të sillte përfitime sepse do të eliminonte shpenzimet e qirasë për objektet ekzistuese policore.</p> <p>Realizimi i këtij projekti do të ndihmonte në përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme fizike për një funksionim efektiv dhe të koordinuar mirë të agjencioneve të zbatimit të ligjit. Si i tillë, ky projekt është në përputhje dhe komplementon projektet dhe përpjekjet tjera për të modernizuar infrastrukturën e nevojshme fizike dhe teknologjike në gjithë sektorin e sundimit të ligjit.</p>

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.14 Avancimi i shërbimeve doganore</b>
<b>Vlera:</b>	9 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019

<b>implementimit:</b>	
<b>Përfituesit direkt:</b>	Doganat e Kosoves (DK)
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit lidhur me avancimin e shërbimeve doganore
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i shërbimit doganor sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Në kuadër të krijimit të një mjedisi më të mirë për punë Dogana e Kosovës (DK) ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të përmirësuar infrastrukturën fizike. Për arsye të mundësive të kufizuara buxhetore zyra qendrore e doganës në Prishtinë vazhdon të funksionojë nëpër objekte të marra me qira. Kjo përpos që ka një kosto vjetore prej afërsisht gjysmë milioni Euro, krijon vështirësi komunikimi brenda për brenda doganës si dhe mes doganës e institucioneve tjera.</p> <p>Prandaj, për zyrën qendrore në Prishtinë kërkohet urgjentisht ndërtimi i një objekti të ri sipas standardeve ndërkombëtare. Sipas një përlllogaritje të bërë nga DK, ky objekt pritet të kushtojë rreth <b>7.5 milion Euro</b>. Qëllimi i këtij objekti është krijimi i kushteve më të mira të punës duke harmonizuar standardet e punës dhe arritjen e objektivave. Përmes këtij projekti synohet përmirësimi i kushteve të punës, përmirësimi i mëtejshëm i performancës (përmes koordinimit brenda të të gjitha strukturave të të dyja Administratave); të shfrytëzimit të shërbimeve qendrore dhe zvogëlimin e të gjitha shpenzimeve të organizatave përfituese si dhe komunitetit të biznesit.</p> <p>Në kuadër të plotësimit të standardeve të BE-së, DK është duke përdorur sisteme softwerike të avancuara të cilat lehtësojnë punën e doganës para se gjithash ashtu siç lehtësojnë dhe bashkëpunimin brenda dhe ndërinstitucional si dhe rajonal. Sa u përket çështjeve të tranzitit, DK ende nuk e ka të instaluar New Computerized Transit System (<b>NCTS</b>). Qëllimi i këtij projekti është plotësimi i kushtit thelbësor të Doganës për anëtarësim në BE. NCTS është një sistem evropian i cili përfshin të gjitha shtetet anëtare të BE-së. NCTS në çdo vend është i lidhur përmes një domaini qendror në Bruksel, për të komunikuar me të gjitha vendet tjera. Ky sistem siguron lidhje mes rreth 3000 zyreve evropiane doganore si dhe zëvendëson sistemin <i>Paper-less</i>.</p> <p>Anëtarësimi dhe zbatimi i Konventës për Tranzit të Përbashkët (CTC) dhe pajisja me NCTS nënkupton zbatimin e përbashkët të tranzitit, që mundëson shkëmbimin e mesazheve mes shteteve anëtare të BE-së dhe palëve kontraktuese. CCN/CSI është platformë komunikimi që siguron këtë rrjet midis palëve. Kosova ka mungesë të rrjetit për të shkëmbyer të</p>



	<p>dhënave në mes palëve kontraktuese dhe vendeve të BE-së. Për më tepër, përmes zhvillimit të këtij sistemi do të mund të zhvillohen edhe sistemet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Tarifa e Integruar e Komunitetit (TARIC)</li> <li>2. Kuotat tarifore dhe Mbikqyrja/Mbikqyrja II (TQS)</li> <li>3. Lidhja Evropiane për Informatat mbi Tarifën (EBTI).</li> </ol> <p>Ky projekt pritet të kushtojë afërsisht 1.5 milion Euro.</p> <p>Projekt-ideja për avancimin e shërbimeve doganore ndikon drejtëpërsëdrejti në realizimin e njërit prej rezultateve kryesore të pritura të kësaj strategjie, që është përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme fizike dhe IT për një funksionim efektiv dhe të koordinuar mirë të agjencioneve të zbatimit të ligjit. Njëkohësisht, kjo projekt-ide ndërton mbi të arriturat e deritanishme të DK-së dhe është në përpuethshmëri edhe me projektet e tjera për përmirësimin e përdorimit të sistemeve IT në sektorin e sundimit të ligjit.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>2.15. Avancimi i sigurisë së dokumenteve personale dhe mbrojtjes së të dhënave personale</b>
<b>Vlera:</b>	2 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2014-2015 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2016-2017
<b>Përfituesit direkt:</b>	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AShMDP), Agjencia e Regjistrat Civil (ARC)
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përmirësimi i Sundimit të Ligjit në Kosovë duke avancuar sigurinë e dokumenteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas standardeve të BE-së
<b>Qëllimi:</b>	Ngritja e kapaciteteve të AShMDP-së dhe ARC-së si dhe institucioneve tjera publike në mënyrë që këto institucione brena përgjegjësive të tyre të performojnë në mënyrë efçente dhe efektive implementim dhe standarde mbi sigurinë e dokumenteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas EU acquis
<b>Përshkrimi:</b>	Siguria e dokumenteve personale si dhe mbrojtja e të dhënave personale janë komponentë kyçe për një bashkëpunim në zbatimin efektiv të ligjit në BE. Kosova ka miratuar legjislacionin primar si dhe ka themeluar ARC-në në kuadër të MPB-së dhe AShMDP-në si një institucion i pavarur që i

raporton Parlamentit.

Përkundër, arritjeve të gjertanishme siguria e dokumenteve dhe mbrojtja e të dhënave personale mbetet një nga fushat ku asistenca ndërkombëtare është e nevojshme. Kur flitet për kapacitetet profesionale për zbatimin e legjislacionit për sigurinë e dokumenteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ka nevojë për përmirësim dhe avancim të ekspertizës vendase në këtë fushë. Këtu përpos ARC-së dhe AShMDP-së hyjnë dhe institucione tjera që lidhen me këtë fushë.

Pavarësisht nga garancat që ofron Kushtetuta si dhe legjislacionet përkatëse në këtë fushë shumica e qytetarëve të Kosovës vazhdojnë të mos jenë të informuar për këto të drejta themelore civile, cenimi i të cilave prek integritetin e tyre personal. Pjesa më e madhe e qytetarëve vazhdojnë të mos jenë të informuar për ekzistimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për rëndësinë që ka implementimi i këtij ligji. Ekspozimi i qytetarëve ndaj cenimit të privatësisë në Kosovë mbetet i lartë. Deri më tani nuk ka pasur as një kriter për verifikimin e rasteve të grumbullimit të të dhënave personale në mënyrë të paautorizuar, sikurse edhe nuk ka pasur ndonjë kontroll adekuat për mënyrat se si procedohen të dhënat e grumbulluara në rastet kur ekziston një autorizim i tillë.

Në këtë drejtim mugesë vetëdijësimi në lidhje me këtë fushë ka si nga ana e akterëve në sektorin publik apo privat që bëjnë grumbullimin e të dhënave personale në mënyrë të autorizuar ashtu edhe nga qytetarë të zakonshëm. Andaj në këtë kontekst AShMDP duhet të marrë përsipër sa më parë që të informojë dhe këshillojë sektorin publik dhe privat për rëndësinë që paraqet mbrojtja e të dhënave dhe gjithashtu për të vetëdijësuar publikun e gjerë në lidhje me këtë fushë.

Kosova tashmë ka themeluar Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC). Themelimi i ARC-së është i bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës i cili vendim i përcakton detyrat e saj për të “ofruar të gjitha shërbimet për qytetarët dhe banorët të cilët aplikojnë për karta identiteti, pasaporta, nënshtetësi, dokumente të gjendjes civile, patentë shofer dhe dokumente për regjistrimin e automjeteve.”

Sa i përket regjistrimit civil Kosova duhet të miratojë dhe zbatojë masa për të siguruar integritetin dhe sigurinë e statusit civil dhe procesit të regjistrimit civil, përfshirë integritetin dhe lidhjen e databazave relevante dhe verifikimin e të dhënave të skanuara sipas databases së statusit civil, duke i kushtuar vëmendje të theksuar ndryshimit të të dhënave bazike të individëve. Pastaj, aspekte tjera që do të duhej marrë parasysh janë: miratimi dhe zbatimi i masave që do të siguronin integritetin dhe sigurinë

e aplikacionit për dokumente, për çertifikatat e gjendjes civile, letërnjoftimet, përfshirë letërnjoftimet biometrike si dhe të definohen dhe implementohen procedura strikte për lëshimin e këtyre dokumenteve, bashkëpunimi me INTERPOL dhe institucione tjera relevante ndërkombëtare sa i përket dokumenteve personale.

Pra, në përgjithësi asistenca për këtë fushë do të duhej përqendruar në rishikimin dhe harmonizimin e legjislacionit primar e sekondar/procedurave (nëse e nevojshme), ngritjen e kapaciteteve institucionale të ARC-së dhe AShMDP-së, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, vetëdijësimin sektorit publik dhe privat për rëndësinë, obligimet dhe të drejtat që dalin nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale, forcimin dhe unifikimin e kriterëve për aplikimin dhe lëshimin e dokumenteve personale, etj. Mbështetja e donatorëve për mbrojtjen e të dhënave duhet të vazhdojë derisa të kemi një sistem të avancuar për këtë fushë në përputhje me standardet evropiane.

### 16.2.3 Përshkrimi i projekt-ideve të Objektivit Strategjik 3: Përmirësimi i qasjes në drejtësi

Lista e projekt-ideve të mëposhtme paraqet nevojat për asistencë në realizimin e prioritetit strategjik 3, ku projekt-idetë janë të renditura sipas prioritetit që kanë. Realizimi i këtyre projekt-ideve do të duhej t'i paraprinte dhe njëkohësisht do të kontribuonte në krijimin e kushteve më të përshtatshme për implementimin e plotë të projekt-ideve tjera të përmendura, të cilat komplementojnë mirë njëra tjetrën. Projektet-idetë në këtë strategji janë gjithëpërfshirëse, duke lënë mundësinë e hapur që disa, ose shumica e këtyre projekt-ideve, të mund të realizohen përmes një apo më shumë projekteve më specifike dhe në disa faza.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>3.1 Ngritja e kapaciteteve monitoruese dhe avokuese të shoqërisë civile</b>
<b>Vlera:</b>	0.8 MEUR (faza I) 0.8 MEUR (faza II) 0.8 MEUR (faza III)
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018 (faza I)  Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019 (faza II)  Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2017-2018 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2019-2020 (faza III)
<b>Përfituesit direkt:</b>	OJQ-të si dhe të gjitha institucionet e tjera në sektorin e sundimit të ligjit.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i shoqërisë civile si bashkëpjesëmarrëse në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit për sektorin e sundimit të ligjit
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i shoqërisë civile si bashkëpjesëmarrëse në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit për sektorin e sundimit të ligjit
<b>Përshkrimi:</b>	Kur është fjala te forcimi i sundimit të ligjit në Kosovë në përgjithësi dhe ngritjes së efikasitetit, llogaridhënies dhe efijencës së institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë në veçanti, rol të rëndësishëm luan edhe shoqëria civile, e cila, përmes analizave, presionit publik, monitorimit dhe avokimit kryen një shërbim të rëndësishëm në mbikqyrjen e punës së institucioneve në këtë sektor, në kërkesën për llogaridhënie etj. Edhe pse OJQ-të në Kosovë, në dekadën e fundit, kanë ngritur kapacitete njerëzore dhe ka të tilla që janë profilizuar ekskluzivisht në sektorin e sundimit të ligjit, qëndrueshmëria e tyre financiare, dhe nevoja për të ngritur dhe ndihmuar kapacitetet e tyre avokuese dhe monitoruese mbetet një sfidë.  Andaj, është parë si nevojë që, në kuadër të përmirësimit të sundimit të

	<p>ligjit në Kosovë, të kërkohet edhe asistencë e veçantë për aktivitetet e OJQ-ve në këtë fushë në përgjithësi dhe forcimin e kapaciteteve avokuese dhe monitoruese të tyre në vecanti.</p> <p>Monitorimi dhe avokimi i suksesshëm nga ana e OJQ-ve është zakonisht rezultat jo vetëm i bashkëpunimit të mirë me institucionet përkatëse por edhe analizave të vazhdueshme, hulumtimit serioz, ngritjes së vetëdijes/ndërgjegjësimit të opinionit etj. Mbështetja e hulumtimeve serioze, në këtë drejtim është shumë e rëndësishme si për profesionalizimin e punës së OJQ-ve ashtu edhe për përfitimin sa më të madh prej punës së tyre nga institucionet e vendit.</p> <p>Edhe pse një strategji për bashkëpunim me shoqërinë civile ekziston, kjo projekt-ide ka të bëjë më shumë me përmirësimin e kapaciteteve avokuese dhe monitoruese të shoqërisë civile, gjë që do të kontribuonte jo vetëm në përmirësimin e llogaridhënies së institucioneve të sektorit të sundimit të ligjit dhe përmirësimin të efikasitetit dhe efikasitetit të punës së tyre, por edhe në përmirësimin e qasjes në drejtësi në përgjithësi dhe përforcimit të bashkëpunimit të institucioneve të Kosovës me shoqërinë civile në veçanti. Rrjedhimisht, asistencë për punën avokuese dhe monitoruese të OJQ-ve visa-vis sektorit të sundimit të ligjit do të ndikonte pozitivisht si në përmirësimin e llogaridhënies së institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë ashtu edhe në përforcimin e kapaciteteve të tyre.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>3.2. Përmirësimi i komunikimit brenda-institucional, ndër-institucional, dhe atij me shoqërinë civile dhe mediat</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfituesit direkt:</b>	Gjykatat, Prokuroritë, OJQ-të, KGJK, KPK, Asociacioni Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Agjencioni i Ndhmës Juridike Falas, etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit duke mundësuar qasje të njëjtë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës
<b>Qëllimi:</b>	Përmirësimi i qasjes në drejtësi
<b>Përshkrimi:</b>	Struktura e re gjykatave dhe prokurive ka nevojë për avancimin e bashkëpunimit brenda-institucional, ndër-institucional dhe bashkëpunimit me qytetarët për të lehtësuar qasjen në drejtësi në përgjithësi. Vijat e komunikimit brenda për brenda gjykatave sipas sistemit të ri nuk duken të

	<p>jenë të lehta për stafin e gjykatave dhe qasjen e qytetarëve në to.</p> <p>E njëjta gjë ndodh edhe me prokuroritë. Zyra e Prokurorit Disiplinor është poashtu një institucion që merret me rastet e shkeljeve ligjore nga ana e prokurorëve dhe gjyqtarëve, gjë për të cilën qytetarët e Kosovës nuk janë mirë të informuar. Edhe komunikimi i gjykatave dhe prokurorive me Zyrën e Prokurorit Disiplinor nuk duket të jetë shumë i qartë.</p> <p>Edhe komuniteti i mediave në Kosovë nuk rezulton të jetë mjaftueshëm i informuar sa i përket mënyrës së funksionimit të strukturës së re të gjykatave e prokurorive. Si pasojë e kësaj informatat që i plasohen publikut për çështje të ndryshme të drejtësisë do të duhej rafinuar më tepër në mënyrë që publiku të jetë më mirë i informuar.</p> <p>Duke patur parasysh sistemin e ri të drejtësisë, hartimi i një strategjie të komunikimit që do të kishte për bazë përmirësimin e bashkëpunimit brenda-institucional, ndërinstinucional dhe lehtësimin e qasjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë do të ndihmonte shumë në qartësimin dhe avancimin e vijave të komunikimit vertikal dhe horizontal si dhe do të lehtësonte dukshëm qasjen e qytetarëve, shoqërisë civile dhe mediave në sistemin e drejtësisë.</p> <p>Kjo strategji e komunikimit natyrisht që do të rriste edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Strategjia e komunikimit do të rriste poashtu nivelin e bashkëpunimit brenda-institucional dhe në të njëjtën kohë do të ndihmonte në përfundimin e kapaciteteve menaxhuese, mbikqyrëse dhe vlerësuese brenda për brenda prokurorive e gjykatave.</p> <p>Përmirësimi i komunikimit brenda-institucional dhe ndërinstinucional, rrjedhimisht, shihet si një prioritet i cili, përveq tjerash, do t'u paraprijë dhe do të komplementojë edhe projekt-idetë e tjera në këtë strategji, duke përfshirë sidomos projekt-idetë që kanë të bëjnë me teknologji informative, parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe ato që kanë të bëjnë me qasjen në drejtësi.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>3.3 Implementim i plotë i Konventës për të Drejtat e Njeriut për interesin më të mirë të fëmijëve</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfunduesit direkt:</b>	Fëmijët dhe famljet e tyre, drejtësia, institucionet e mirëqenies sociale dhe

	ato të zbatimit të ligjit
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit në Kosovë duke përmirësuar qasjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i institucioneve përgjegjëse për promovimin e implementimit dhe koordinimit të mirëfilltë mes sektorëve dhe niveleve të qeverisë, shoqërisë civile, fëmijëve dhe të tjerëve
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Fëmijët, të përkufizuar si çdo njeri nën moshën 18 vjeç, janë persona të plotë, të barabartë në vlerë dhe meritojnë të njëjtin respekt si të rriturit, të përkufizuar si të gjithë mbi moshën 18 vjeç. Moshë dhe faza e zhvillimit i dallon fëmijët nga të rriturit, duke i lënë ata më të rrezikuar dhe të varur prej të rriturve. Kjo krijon nevojë për të drejta juridike të veçanta të fëmijëve, politika publike të veçanta, kufizime të justifikuar të lirisë së tyre, si dhe detyrime për të rriturit për ofrimin e mbështetjes dhe ofrimin e një ambienti të favorshëm për zhvillimin e plotë të fëmijëve. Ky koncept është theksuar në parimin e Interesit më të Lartë të Fëmijës (ILF), një nga katër parimet bazë të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF)</p> <p>Përderisa ky parim është kryesisht i përfshirë në legjislacionin kombëtar dhe instrumentet e saj, ai nuk zbatohet dhe merret në konsideratë plotësisht gjatë implementimit praktik nga ana e institucioneve të ndryshme. Ky parim si dhe nene të tjera të KDF, sidomos ato që kanë të bëjnë me një gamë të çështjeve në jetën e fëmijëve, shkelen herë pas here:</p> <p>Në nenin 9, ILF (Interesi më i Lartë i Fëmijës) është e vetmja arsye për ndarje nga prindërit (Neni 9.1) dhe arsyeja e vetme për mohimin e kontaktit me prindin që nuk e ka fëmijën nën kujdestari (neni 9.3) . Neni 18, një nga nenet mbi përgjegjësinë prindërore, thotë se "interesi më i lartë i fëmijës do të jenë shqetësimi i tyre themelor." Neni 20 lidh ILF me të drejtën e identitetit kulturor duke deklaruar në mënyrë eksplicite se ILF për reparte të shtetit përfshin "dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore." Neni 21 bën ILF parimin suprem për birësim. Nenet 37 dhe 40 përdorin ILF si një faktor pragu brenda drejtësisë penale. Neni 37 thotë se "çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget" Neni 40 garanton të drejtën e fëmijëve për një gjykim të drejtë, përveç nëse kjo nuk është në interesin e tyre më të mirë për shkak të moshës apo rrethanave.</p> <p>Konventa është e pandashme dhe artikujt e saj të ndërvarura. Aplikimi i ILF pritet të ndikojnë në interpretimin dhe zbatimin e të gjitha neneve të Konventës dhe për të bashkëvepruar me parimet e tjera, sidomos të</p>

	<p>drejtën për mosdiskriminim, mbijetesë, dhe respektim të mendimit të fëmijës (nenet 2, 6 dhe 12).</p> <p>Parimi i 'interetit më të lartë' ndikon dhe udhëzon qeveritë ose aktorët e tjerë relevantë të shqyrtojnë ndikimin e të gjitha veprimeve e tyre mbi fëmijët. Ky parim ka provuar të jetë një ndikim jetik në legjislacionin, strategjitë, politikat dhe programet në mbështetje të të drejtave të fëmijës. Ai ka qenë veçanërisht i dobishëm në procedurat ligjore dhe në mesin e institucioneve të mirëqenies sociale të cilat janë të nevojshme për të balancuar shqetësimet kundërthënëse.</p> <p>Zbatimi i plotë dhe marrja në konsideratë e interesit më të lartë të fëmijës nga institucione të ndryshme është një prioritet i rëndësishëm për përmirësimin e qasjes në drejtësi në Kosovë. Si i tillë, ky propozim është i një rëndësie të veçantë dhe i sinkronizuar mirë me propozimet e tjera për përmirësimin e qasjes në drejtësi të përshkruara më poshtë, të tilla si mbrojtja e fëmijëve nga shfrytësimi seksual dhe abuzimi seksual, mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, etj.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>3.4 Parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfituesit direkt:</b>	PK, MD, MPMS, Agjencia për ndihmë juridike falas, Institucionet Shëndetësore, Avokati i Popullit etj.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Mbështetje për Institucionet e Kosovës në përforcimin e sundimit të ligjit duke mbështetur institucionet e drejtësisë dhe zbatimit të ligjit në të qenurit sa më eficient dhe efektiv në aktivitetet e tyre
<b>Qëllimi:</b>	Përforcimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje.
<b>Përshkrimi:</b>	Fatkeqësisht, fenomeni i dhunës në familje ka marrë përmasa shqetësuese në shoqërinë e Kosovës dhe, përkundër avancimeve të deritanishme në luftimin e këtij fenomeni, përfshirë këtu krijimin e Programit Nacional Kundër Dhunës në Familje, Hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit për viktimat e dhunës në familje, si dhe një sërë ligjesh që kanë të bëjnë me këtë ceshtje, ka nevojë për asistencë në mënyrë që të tejkalohen sfidat me të vilat përballet Kosova në këtë fushë. Miratimi i Ligjit për Mbrojtje Kundër Dhunës në Familje në Kosovë në 2010 dhe i Programit të Kosovës



	<p>Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit në Kosovë për periudhën 2011-2014, natyrisht, nuk siguron domosdoshmërisht zbatimin automatik të tyre.</p> <p>Ka nevojë për analizë të ariturave deri më tani dhe sidomos në përfundimin e masave parandaluese si dhe në fuqizimin e mbrojtjes dhe rehabilitimit të viktimave të dhunës në familje. Infrastruktura ligjore e deritanishme dhe dokumentet e ndryshme përbëjnë të aritura të rëndësishme në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje.</p> <p>Por, ka nevojë për asistencë në implementimin e ligjeve dhe realizimin praktik të objektivave të dala nga dokumentet e ndryshme strategjike. Ka nevojë, në mes tjerash, edhe për financim të mëtutjeshëm të strehimoreve aktive, përmirësim të inventarit të tyre, dhe sigurim të objekteve më të mira, sigurimi i stafit përkatës, sidomos psikologëve, për fushata të mëtutjeshme të vetëdijësimit etj.</p> <p>Përfundimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje është qenësor për përfundimin e sundimit të ligjit në Kosovë, për përmirësimin e qasjes në drejtësi, dhe për mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve të saj.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>3.5 Parandalimi i Dhunës në Shkolla</b>
<b>Vlera:</b>	0.8 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfunduesit direkt:</b>	Fëmijët dhe familjet e tyre arsimit (shkollat), shëndetësia, shoqëria civile, udhëheqës komunitetesh, komuniteti fetar, agjencitë e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përfundimi i sundimit të ligjit në Kosovë duke përmirësuar qasjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë
<b>Qëllimi:</b>	Krijimi dhe përfundimi i një sistemi parandalues dhe përgjegjës për të siguruar zbatim të plotë të ligjeve, politikave, strukturave qeveritare, programeve dhe shërbimeve të cilat ekzistojnë në sistem
<b>Përshkrimi:</b>	Dhuna është një realitet i përditshëm për miliona vajza dhe djem në mbarë botën. Ajo ndodh në të gjitha mjediset ku fëmijët kalojnë fëmijërinë e tyre, duke përfshirë edhe në shkolla e konvikte dhe mjedis të tjera të arsimit. Ekspozimi ndaj dhunës në një mjedis mund të çojë në dhunë në një mjedis tjetër. Nivelet dhe modelet e dhunës në shkolla shpesh reflektojnë nivelet dhe modelet e dhunës në vend, komunitet dhe familje.

Këta, nga ana tjetër, pasqyrojnë kushtet politike dhe socio-ekonomike, besimet kulturore dhe sociale, vlerat dhe normat, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me autoritet, hierarki dhe gjini.

Në shkolla dhe në mjediset arsimore të tjera, prindërit, mësimmshënësist dhe personeli i shkollës kanë për detyrë t'i mbrojnë fëmijët nga dëmtimi dhe të krijojnë një mjedis që bën të mundur edukimin, rritjen dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës, si dhe të identifikojnë shenjat e dhunës ndaj të cilës fëmijët mund të jenë të ekspozuar në mjedise të tjera, duke përfshirë edhe në shtëpitë e tyre. Megjithatë, realiteti është se shumë fëmijë përjetojnë dhunë në shkolla.

Provat tregojnë se dhuna mund të ketë një ndikim negativ në rezultatet e mësimit të fëmijës pasi që ajo ndikon në aftësinë e tij/saj për të vajtur në shkollë në mënyrë të sigurtë, për të mësuar në mënyrë efektive gjatë qëndrimit në shkollë, dhe për të qëndruar në shkollë aq gjatë sa është e mjaftueshme për të përfituar benefitet e arsimit. Format e dhunës në shkolla janë si fizike ashtu edhe emocionale, dhe zakonisht ndodhin së bashku. Format e kryera nga mësuesit dhe stafi tjetër shkollor përfshijnë abuzim emocional, ndëshkim fizik dhe forma të tjera të disiplinimit të ashpër, si dhe dhunën seksuale dhe atë të bazuar në gjini. Format e dhunës të kryera nga fëmijët përfshijnë ngacmimin, rrahjen në shkollë, abuzimin dhe dhunën seksuale, dhunën e bandave, dhe sulmet me armë. Teknologjia tani ka prezantuar edhe cyber-ngacmimin dhe ngacmimin nëpërmjet përdorimit të internetit dhe telefonave celularë.

Përpjekjet për ndryshimin e normave të dëmshme shoqërore dhe forcimin e rolit mbrojtës të prindërve, stafit të shkollës, drejtësisë dhe mirëqenies sociale, dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit, duke përforcuar kulturën e tolerancës, respektit të ndërsjellë dhe paqes, mosdiskriminimit, barazisë gjinore dhe disiplinës pozitive nëpërmjet trajnimit të aftësive, ngritjes së vetëdijes, mobilizimit të komunitetit, dhe programeve prindërore janë të nevojshme për të shmangur këtë problem. Ashtu si projekti për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, edhe ky do të kërkojë një përfshirje substanciale të sektorit të shoqërisë civile, me qëllim të përmirësimit të qasjes në drejtësi dhe mbrojtjes së fëmijëve nga shkeljen e të drejtave të tyre.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>3.6 Mbështetje për fëmijët viktima dhe dëshmitarë<sup>3</sup> të krimit</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfituesit direkt:</b>	Fëmijët dhe familjet e tyre, Qendra për Punë Sociale, Avokati I Popullit, PK, Avokatët, Njësia për Mbrojtjen e Viktimave, Shërbimet Juridike Falas, Prokurorët, Gjykatësit, Shoqëria Civile.
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit në Kosovë duke përmirësuar qasjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë
<b>Qëllimi:</b>	Krijimi i procedurave sensitive për fëmijët në përputhje me Udhëzimet për Drejtësi të Kombeve të Bashkuara që përfshijnë fëmijët viktima dhe dëshmitarë të krimit, si dhe zhvillimi i shërbimeve përfshirëse dhe shumëdisiplinare për mbështetje të fëmijëve dhe familjeve të tyre duke kërkuar dëmshpërblim për cenimet e të drejtave në nivel lokal dhe qendror
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Trajtimi i mirë i fëmijëve nga institucionet e drejtësisë, ato të mirëqënies sociale, dhe ato të sigurisë është qenësor për sundim të ligjit. Përkundër progresit të deritanishëm, fëmijët vazhdojnë të mos shikohen si palë të rëndësishme në iniciativat e ndryshme për sundim të ligjit.</p> <p>Puna për të përmirësuar standardet e drejtësisë për fëmijë shpesh bëhet ndaras nga reformat e përgjithshme të sektoreve të drejtësisë dhe sigurisë. Kjo punë poashtu shpesh bëhet përmes qasjeve vertikale, të fokusuara ose në përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të mitur ose në mbrojtjen e fëmijëve viktima dhe dëshmitarë të krimit, por pa e theksuar ndërlidhjen në mes të këtyre kategorive dhe profesionistëve dhe institucioneve që kanë përgjegjësi për ta. Qasja në drejtësi, edhe pse e potencuar shpesh në strategjitë për mbrojtjen e të drejtave të grupeve të caktuara, rrallëherë i përfshin fëmijët.</p> <p>Fëmijët viktima dhe dëshmitarë do të përfitonin nga njohja dhe implementimi më i mirë i të drejtave të tyre në mënyrë që të përfitojnë më shumë nga sistemi i drejtësisë. Ata duhet të vetëdijësohen dhe informohen më mirë se cilët mekanizma dhe institucioneve mund tu drejtohen për të kërkuar ekzekutimin e kërkesave dhe të drejtave të tyre të cilat janë të garantuara me ligj dhe me standarde ndërkombëtare, t'i kuptojnë procedurat ligjore dhe procedurat e tjera relevante, kostot dhe mundësitë</p>

<sup>3</sup> “Viktimë fëmijë apo dëshmitar” do të thotë një person nën moshën 18 vjeçare që është viktimë apo dëshmitar i krimit, pa marrë parasysh rolin e tij/saj në vepër apo në ndjekjen e kryesit të dyshuar apo grupit të kryesve të veprave.

	<p>e shfrytëzimit të shërbimeve dhe asistencës profesionale falas.</p> <p>Fëmijët viktima dhe dëshmitarë kanë qasje në sistemin e drejtësisë dhe janë më të mbrojtur nga ky system përmes aplikimit sa më të mirë të normave dhe standardeve lokale dhe ndërkombëtare. Kjo projekt-ide, rrjedhimisht, është e një rëndësie të veçantë në arritjen e përmirësimit të qasjes në drejtësi dhe, sikur edhe implementimi i plotë i Konventës për të Drejtat e Njeriut për interesin më të mirë të fëmijëve, ndikon në përmirësimin e qasjes në drejtësi të shtresës më të rëndësishme të shoqërisë.</p>
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>3.7 Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe keqpërdorimi seksual</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfituesit direkt:</b>	Drejtësia, mirëqenie sociale, arsimi, shëndetësia, sektori i turizmit, kuvendi, shoqëria civile, udhëheqës komunitetesh, komuniteti fetar, sektori privat, mediat, familjet dhe vetë fëmijët
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit në Kosovë duke përmirësuar qasjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë
<b>Qëllimi:</b>	Krijimi i një mjedisi për parandalimin dhe luftimin e shfrytëzimit dhe keqpërdorimit seksual të fëmijëve
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF) - Neni 34 - mbron fëmijët nga të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual. Kjo përfshin nxitjen ose të detyrimin e një fëmije për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijëve në prostitucion ose praktika të tjera seksuale të paligjshme, dhe shfrytëzimin e fëmijëve në shfaqje ose materiale pornografike.</p> <p>Protokolli Opsional i KDF mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve (OPSC)<sup>1</sup> përpunon më tej mbrojtjet e ofruara nën KDF dhe jep përkufizime të hollësishme mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve. Ajo kërkon që Shtetet Palë të kriminalizojnë këto shkelje të të drejtave të fëmijëve si vepra penale dhe për të siguruar mbështetjen e duhur për fëmijët viktima</p> <p>Shfrytëzimi seksual dhe abuzimi i fëmijëve (SEA) është një realitet global. Ajo mund të marrë formën e ngacmimit, prekjes, incestit, dhunimit ose</p>

	<p>shfrytëzimit në prostitucion ose pornografi. Kjo ndodh në shtëpi, shkolla, institucionet e kujdesit dhe drejtësisë, në vende pune, në objekte të udhëtimit dhe turizmit, dhe përbrenda komuniteteve në përgjithësi. Kjo ndodh në kontekstet e zhvillimit ashtu edhe ato të emergjencës.</p> <p>Gjithnjë e më shumë, interneti dhe telefonat celularë po vënë fëmijët në rrezik të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit. Në vitet e fundit ka dëshmi të rritjes së numrit dhe qarkullimit të imazheve të abuzimit të fëmijëve në internet dhe madje edhe të abuzimit live-stream të fëmijëve. Disa të rritur kontaktojnë fëmijët në internet për të kërkuar marrëdhënie seksuale me fëmijët. Vetë fëmijët dergojnë mesazhe ose imazhe seksuale në telefonat e tyre mobil (zakonisht të referuara si "sekstim"), gjë që i vë ata në rrezik për abuzime të tjera</p> <p>Për të kuptuar më mirë marrëdhënien mes mjediseve online dhe offline dhe rreziqet dhe potencialin për dhunë dhe abuzim seksual dhe shfrytëzim si pasojë e kësaj nevojitet parandalimi dhe ndryshimi i sjelljes në raport me shfrytëzimin seksual dhe abuzimit të fëmijëve në mjedisin online/offline.</p> <p>Vendosja dhe definimi i masave të ndërhyrjes për mbrojtjen nga sjelljet dhe rreziqet nga dëmet dhe dokumentimi i masave ekzistuese parandaluese dhe mbrojtëse për të luftuar abuzimin e fëmijëve në internet dhe të shfrytëzimit, është një prioritet i rëndësishëm. Së bashku me projekt-idetë e tjera, të tilla si zbatimi i interesit më të mirë të fëmijës, dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, kjo përmirëson qasjen në drejtësi për fëmijët dhe përforcon përpjekjet për të mbrojtur këtë segment të shoqërisë.</p>
--	---

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>3.8 Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna</b>
<b>Vlera:</b>	1.5 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2016-2017 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2018-2019
<b>Përfituesit direkt:</b>	Fëmijët, familjet, drejtësia, mirëqenie sociale, arsimi, shëndetësia, shoqëria civile, udhëheqës komunitetesh, komuniteti fetar, sektori privat, mediat
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i sundimit të ligjit në Kosovë duke përmirësuar qasjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë

<b>Qëllimi:</b>	Sigurimi i një mjedisi parandalues e mbrojtës pa dhunë për të gjitha kategoritë e fëmijëve përfshirë ata që janë më të cenueshëm
<b>Përshkrimi</b>	<p>Dhuna ndaj fëmijëve përfshin abuzim emocional dhe fizik, neglizhencën ose trajtimin neglizhent, shfrytëzimin seksual dhe abuzimin. Kjo ndodh në shtëpi dhe në familje, shkolla, sisteme të kujdesit dhe drejtësisë, në vende të punës dhe komunitete. Kriminelët mund të përfshijnë prindërit, anëtarët e familjes, mësuesit, kujdestarët, autoritetet e zbatimit të ligjit dhe fëmijët e tjerë. Ekzistojnë dëshmi të qarta se dhuna mund të ndikojë në shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve, të pengojë aftësinë e tyre për të mësuar dhe të socializohen, dhe minojë zhvillimin e tyre në të rritur funksionale dhe prindër të mirë më vonë në jetë. Në rastet më të rënda, dhuna ndaj fëmijëve çon në vdekje.</p> <p>Efektet do të fokusohen në dhënien fund të dhunës me ndryshimin e legjislacionit dhe sigurimin e zbatimit të tij. Projekti do të trajtojë normat shoqërore të heshtjes/pranimit mbi dhunën ndaj fëmijëve, përmes përfshirjes pjesëmarrëse të bazuar në komunitet, dhe me mbështetjen e OJQ-ve, në një bashkëpunim të ngushtë dhe pronësi të të gjitha institucioneve relevante dhe palët e interesuara.</p> <p>Përpjekje të tjera do të fokusohen në: i) institucionalizimin e mekanizmave të nivelit lokal dhe qendror për Dhunën ndaj Fëmijëve, dhe mbështetje për një koordinim më të mirë të këtyre mekanizmave për trajtimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve viktimë të dhunës, ii) forcimin e ofrimit të shërbimeve për fëmijët-viktima të dhunës dhe familjeve të tyre, duke përfshirë ato të parandalimit, mbrojtjes dhe riintegrit me pjesëmarrjen e plotë të sektoreve përkatëse të drejtësisë, arsimit dhe mirëqënies; iii) forcimin dhe ndarjen e qëndrueshme të shërbimeve nga institucionet relevante vendore përmes planifikimit të duhur të kostove dhe buxhetimit të Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel të dy qendror dhe lokal; iv) mbështetjen për forcimin e sistemit të raportimit dhe monitorimit dhe për rastet e dhunës ndaj fëmijëve nëpërmjet punës së ngushtë me sektorë të ndryshëm, duke përfshirë atyre të drejtësisë, arsimit dhe mirëqënies sociale.</p> <p>Kjo projekt-ide do të përmirësojë qasjen në drejtësi në Kosovë në përgjithësi, dhe qasjen në drejtësi për fëmijët në veçanti. Në përputhje me projekt-idetë e tjera të fokusuar në përmirësimin e trajtimit të këtij grupi vulnerabël të shoqërisë, përkatësisht fëmijëve, nga sektori i sundimit të ligjit, kjo projekt-ide gjithashtu kontribuon në përmirësimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Si e tillë, ajo plotëson edhe projektet tjera që kanë të bëjnë me çështjet e ndërlidhura me qasjen në drejtësi për fëmijët dhe mundësinë e fëmijëve për të marrë një trajtim të drejtë dhe në kohë për shkeljet e të</p>

	drejtave të tyre. Përveç kësaj, komponenti i projekt-idesë që ka për qëllim të përfshijë OJQ-të përshtatet mirë edhe me atë për përmirësimin e monitorimit të shoqërisë civile dhe kapacitetet avokuese vis-à-vis sundimit të ligjit në përgjithësi dhe qasjen në drejtësi në veçanti.
--	--

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>3.9 Mbështetje për përkthyesit, interpretët dhe gjuhëtarët ligjorë</b>
<b>Vlera:</b>	1 MEUR
<b>Afati tentativ i programimit dhe implementimit:</b>	Viti i fillimit e mbarimit të programimit: 2015-2016 Viti i fillimit e mbarimit të implementimit: 2017-2018
<b>Përfituesit direkt:</b>	MD, KGJK
<b>Objektiva e përgjithshme</b>	Përforcimi i Sundimit të Ligjit me reformim të mëtejshëm të institucioneve respektive si dhe përafrimi e implementimi i legjislacionit të BE-së në drejtësi, siguri dhe çështje të brendshme
<b>Qëllimi:</b>	Rritja e efikasitetit dhe besueshmërisë së administratës, sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të zbatimit të ligjit duke krijuar standarde për përkthim dhe interpretim ligjor sipas praktikave më të mira të BE-së
<b>Përshkrimi:</b>	<p>Siguria ligjore në Kosovë nuk është në nivelin e duhur nga fakti se si qeveria ashtu edhe gjyqësori mbështeten në përkthim dhe interpretim (hartimi i ligjeve, seancat gjyqësore të drejtuara nga gjyqtarët ndërkombëtarë, etj). Shumica e përkthyesve dhe interpretëve nuk i janë nënshtruar ndonjë trajnimit formal dhe si të tillë kanë shumë pak përvojë me të kuptuarit e koncepteve ligjore. Prandaj, krijimi i një institucioni trajnues, zhvillimi i planprogrameve dhe mekanizmave certifikues e akreditues për përkthyesit, interpretët dhe gjuhëtarët ligjorë do të ngriste efikasitetin dhe besueshmërinë e administratës shtetërore dhe sistemit gjyqësor.</p> <p>Megjithatë, duhet patur kujdes në këtë aspekt, sepse krijimi i një sistemi të përgjithshëm cilësor (certifikim) për shërbime përkthimi dhe interpretimi nuk do të jetë i lehtë, në mos i pamundur. Kjo sepse shumë vende evropiane janë marrë me këtë aspekt, por asnjë vend nuk ja ka dalur të ndërmerr masa konkrete sa i përket certifikimit të përgjithshëm, i cili do të merr kohë të konsiderueshme. Prandaj, hap i parë për të ndërtuar një sistem të tillë do të ishte njohja e përkthimit/interpretimit si disiplinë akademike e vecantë. Për të shpejtuar në këtë proces do të duhej që së pari të iniciohet sistemi i certifikimit për përkthyesit dhe interpretët e betuar gjyqësor, praktikë kjo që veç ekziston në vende tjera.</p> <p>Bazuar në përvojat e vendeve tjera mund të llogaritet në krijimin e një</p>

asociacioni profesional për përkthim dhe interpretim. Krijimi i një asociacioni të tillë do të kishte ndikim pozitiv në tregun e punës sepse përkthyesit dhe interpretët do të kalonin nëpër një process certifikimi. Para se të fillohet me hapa të tillë do të duhej rregulluar baza ligjore për krijimin e mekanizmit për certifikimin e përkthyesve dhe interpretëve duke përcaktuar dhe institucionin që do të menaxhonte këtë process.

Krijimi i sistemit për përkthyesit dhe interpretët do të kontribuonte dukshëm në evitimin e keqkuptimeve sa u përket seancave gjyqësore të drejtuara nga ndërkombëtares, do të rriste konsistencën mes ligjeve në aspektin gjuhësor, do të përgatiste gjuhëtarët ligjorë dhe në përgjithësi do të kontribuonte në rritjen e sigurisë ligjore dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë si dhe në përforcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.



## 16.3 Matrica e Kornizës Logjike

Matrica e Kornizës Logjike			
Logjika e intervenimit	Indikatorët	Burimet e Verifikimit	Supozimet
<p><b>Objektiva e përgjithshme:</b></p> <p>Krijimi i kushteve për një Sundim të ligjit të qendrueshëm dhe rrjedhimisht avancimin në procesin e Integritetit Evropian përmes planifikimit, programimit dhe përmirësimit të efektivitetit të asistencës së donatorëve në përputhje me prioritetet strategjike nacionale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i rangimit të Kosovës në Indeksin e Përceptimit të Korrupsionit në Transparency International</li> <li>- Përmirësimi rezultatit aktual të Kosovës në Global Integrity Report</li> <li>- Progresi në sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë sipas BE-së</li> <li>- Përmirësimi i notës për Sundim të Ligjit (perceptimi për zbatimin e kontratave, të drejtat pronësore, polici, gjykata, dhe probabiliteti për krim dhe dhunë) – the World Bank Institute.</li> <li>- Përmirësimi i indikatorit për nivel të qasjes dhe përballueshmërisë financiare të drejtësisë (World Justice Project – nëse Kosova përfshihet në këtë Index në vitet në vijim)</li> </ul>	<p>Raportet ndërkombetare: Transparency International, Global Integrity Report, Raportet e Progresit të Komisionit Evropian dhe Raportet e Implementimit të Marreveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Raporte te USAID, UNDP, UNICEF, Bankës Botërore, etj.</p>	
Objektivat Strategjike:	Indikatorët	Burimet e Verifikimit	Supozimet
<p>1. Përmirësimi i pavarësisë, efijences, efektivitetit, llogaridhënies dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë</p> <p>2. Përmirësimi i parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë trafikimin me qenie njerëzore dhe narkotikë, krimin ekonomik dhe shpërlarjes së parave, kontrabandës me armë, krimin kibernetik dhe terrorizmit,</p> <p>3. Përmirësimi i qasjes në drejtësi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e deklarimeve të pasurisë nga zyrtarët publik</li> <li>- Rastet e pazgjidhura për më shumë se një vit për kokë banori</li> <li>- Rastet e trajtuara nga institucionet e auditimit dhe ato kundër korrupsionit.</li> <li>- Numri i rasteve të regjistruara dhe procesurara në sistemin e menaxhimit të lëndëve për vit</li> <li>- Numri i emigrantëve ilegal të kapur si përqindje e popullsisë (nga të dhënat administrative).</li> <li>- Numri i tentimeve për kalim ilegal të kufirit për popullsi.</li> <li>- Përqindja e pranimit të aplikacioneve për azil (awards/applications - %) – UNHCR.</li> <li>- Rritja e pasurisë së konfiskuar, sekuestruar dhe ngrirë në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar/ për kokë banori – GRECO dhe Eurostat</li> <li>- Numri i rasteve të pazgjidhura të gjyqësorit, si përqindje e numrit total të rasteve në sistemin gjyqësor (%) CEPEJ të Këshillit të Evropë</li> </ul>	<p>Raportet e Progresit të Komisionit Evropian dhe Raportet e Implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA),</p> <p>Raporte të institucioneve të drejtësisë dhe çështjeve të brendshme</p>	<p>Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të mbështesë reformat në sistemin e drejtësisë në tërësinë e tij</p> <p>Vullneti politik për të forcuar sektorin e Sundimit të Ligjit</p>

Rezultatet e pritura:	Indikatorët	Burimet e Verifikimit	Supozimet
<p><b>Objektivi strategjik 1:</b>  1.Korniza ligjore e sistemit gjyqësor dhe prokurorial e përmirësuar, avancuar dhe harmonizuar sipas praktikave më të mira të BE-së  2.Mekanizmat që sigurojnë zbatimin e një sistemi të drejtësisë të paanshëm, efektiv, transparent, dhe llogaridhënës të përforcuara  3.Kapacitetet e burimeve njerëzore për përmirësimin e performancës së përgjithshme të sistemit të drejtësisë të ngritura.  4.Infrastruktura fizike dhe të IT-së e përmirësuar duke kontribuar kështu, ndër të tjera, në bashkëpunim efektiv mes institucioneve të drejtësisë.  5.Veprimet e profesioneve të lira ligjore të harmonizuara dhe mekanizmat për mbikqyrjen e tyre të përforcuara.</p> <p><b>Objektivi strategjik 2:</b>  1.Korniza ligjore për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit e përmirësuar, avancuar dhe harmonizuar sipas praktikave më të mira të BE-së.  2.Mekanizmat që sigurojnë zbatim eficient dhe efektiv të ligjit për të rritur sigurinë e përgjithshme të vendit ndaj dukurive negative të përforcuar.  3.Infrastruktura e nevojshme (fizike, IT, pajisje) për një funksionim efektiv dhe të koordinuar mirë të agjencioneve të zbatimit të ligjit e përmirësuar.  4.Kapacitetet e resurseve të nevojshme njerëzore për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar (përfshirë krimet e luftës), korrupsionit të nivelit të lartë etj, të ngritura.  5.Anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat rajonal dhe ndërkombëtarë në fushën e zbatimit të ligjit i avancuar.</p> <p><b>Objektivi strategjik 3:</b>  1.Korniza ligjore për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës e përmirësuar, avancuar dhe harmonizuar sipas praktikave më të mira të BE-së  2.Mekanizmat ligjorë për qasje në drejtësi në tërë territorin e Kosovës të përforcuar.  3.Qasja e fëmijëve dhe femrave në drejtësi e përmirësuar. Sistemit i drejtësisë në tërë territorin e Kosovës i integruar, unifikuar dhe konsoliduar.  4.Bashkëpunimi i institucioneve të Kosovës me shoqërinë civile dhe mediat i përforcuar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Legjislacioni i përmirësuar, avancuar dhe harmonizuar me praktikën më të mirë të BE-së.</li> <li>- Përqindja e stafit të institucioneve të drejtësisë dhe atyre për zbatimin e ligjit që janë zgjedhur, emëruar dhe promovuar në funksionet të Sundimit të Ligjit bazuar në kriteret objektive dhe transparente</li> <li>- Përqindja e rasteve të caktuara përmes sistemit elektronik për ndarjen e lëndëve.</li> <li>- Satisfaksioni i institucioneve të drejtësisë dhe atyre të zbatimit të ligjit lidhur me përmbajtjen e programeve për zhvillim të stafit dhe cilësinë e trajnimeve.</li> <li>- Ndarja e kërkesave për ndihmë juridike falas të ofruar nga autoritetet publike</li> <li>- Programet e ndryshme për ngritje të kapaciteteve të hartuara dhe në përdorim</li> <li>- Sistemi i sundimit të ligjit në Veri të Kosovës i konsoliduar dhe funksional</li> <li>- Numri i projekteve suksesshëm të implementuara për asistencë teknike, infrastrukturë fizike dhe IT</li> <li>- Misionet Vlerësuese të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore për fusha specifike të Sundimit të Ligjit</li> <li>- Strategjitë për fusha specifike të hartuara dhe në zbatim.</li> <li>- Mekanizma çertifikimi (p.sh. çertifikimi i përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor)</li> </ul>	<p>Raportet për numrin e ligjeve të miratuara (Gazeta Zyrtare e Kosovës), infrastrukturën e përmirësuar dhe programet e ndryshme për ngritje të kapaciteteve</p> <p>Raportet vendore e ndërkombëtare për gjendjen e Sundimit të Ligjit në Veriun e Kosovës</p> <p>Raportet mbi implementimin e strategjisë për asistencë</p> <p>Raportet të Misioneve të ndryshme Vlerësuese</p> <p>Strategjitë e ndryshme</p>	<p>Institucionet e Kosovës kanë kapacitetet të sipërmarrin përgjegjësitë e EULEX-it deri në fund të vitit 2016.</p> <p>Kapacitetet e limituara teknologjike dhe</p> <p>Kapacitetet e limituara të burimeve njerëzore adekuate nëpër institucionet e sundimit të ligjit.</p>

Aktivitete/Komponentet (të përmbledhura)	Instrumentet implementuese	Kosto	Supozimet
1.Politikat dhe legjislacioni 2.Mekanizmat institucional 3.Kapacitetet institucionale 4.Infrastruktura fizike, IT-se, etj.  <i>(Më shumë për aktivitetet shih Planin e Veprimit të kësaj strategjie)</i>	1) Kontrata shërbimi 2) Kontrata binjakëzimi (twinning contracts) 3) Kontrata furnizimi 4) Kontrata kornizë 5) Kontrata të punimeve (Works Contract). 6) Kontrata mbikëqyrjeje, etj.	Kostoja e përafërt për implementimin e kësaj strategjie është 108.2 MEUR (milion EUR)	Institucionet e Sundimit të Ligjit janë të përkushtuara për të marrë pjesë në mënyrë proaktive në implementimin e kësaj strategjie
			<b>Parakushtet:</b>  Institucionet e Sundimit të ligjit në Kosovë realizojnë me sukses planet dhe objektivat e tyre për periudhën 2014-2016 si parakusht për fillimin e implementimit të projekteve pasuese 2016-2019.  Qeveria e Kosovës të sigurojë bashkëfinancimin për projekte/programet e te donatorëve nëse kjo shihet si e nevojshme  Korniza legjislative e adoptuar dhe e qartë  Te projektet infrastrukturorë kërkohen të rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me çështje pronësore, p.sh. evitimi i konstestave pronësore, sigurimi i lejes ndërtimore, etj.

#### **16.4 DOKUMENTET E KONSULTUARA**

1. Analizë e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, Mars 2014
2. Biznes Plani i Agjencisë së Pronave të Kosovës 2013
3. Country Strategy Paper for Kosovo (2014-2020)
4. Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme (DPPA) 2014-2016
5. Dokument i Bankës Botërore: Indikatorë të Rekomanduar për Drejtësinë në Kosovë – Monitorimi dhe Vlerësimi i Zhvillimit të Kapaciteteve për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë
6. Dokument Punues i Stafit të Komisionit Evropian: Komunikata e Komisionit Evropian për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian – 10 tetor 2012
7. IPA II Regulation
8. Komunikatë e Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Bashkimit Evropian mbi Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian - 10 tetor 2012
9. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2015-2017
10. Kosovo Center for Security Studies (KCSS): Llogaridhënie apo Jo? Menaxhimi i Parasë Publike në Sektorin e Sigurisë në Kosovë.
11. Multy Country Strategic Paper (2014-2020)
12. Plani i Dokumenteve Strategjike të Kosovës për vitin 2014
13. Plani i Veprimit për Negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për Kosovën
14. Plani i Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit 2013
15. Plani i Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyeist për Liberalizimin e Vizave
16. Plani Strategjik i Doganave të Kosovës 2013-2015
17. Plani Vjetor i Punës së Akademisë për Siguri Publike të Kosovës 2014
18. Plani Vjetor i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2014
19. Plani Zhvillimor Strategjik i Institutit Kosovar për Administratë Publike 2011-2014
20. Plani Zhvillimor Strategjik i Ministrisë së Drejtësisë 2012-2016
21. Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014
22. Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2014
23. Raport i BIRN-it për ftesat gjyqësore, Nëntor 2012
24. Raport i BIRN-it për monitorimin e gjykatave, Prill 2010-Shkurt 2011
25. Raport i Gjykatës së Auditorëve 2012 lidhur me Asistencën e BE-së në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë
26. Raport vjetor i BIRN-it për monitorimin e gjykatave, Qershor 2012

27. Raporti i Monitorimit të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014, Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014 dhe Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje nga Shoqëria Civile
28. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën 2013
29. Raporti Vjetor 2011 i Doganave të Kosovës
30. Raporti Vjetor i Punës i Organit Shqyrtues të Prokurimit 2013
31. Raport Vlerësues mbi Përputhshmërinë me Standarde Ndërkombëtare në Fushën Kundër Korrupsionit, përpiluar nga “Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë”, implementuar nga Këshilli i Evropës (*Project against Economic Crime in Kosovo- Assessment Report on the Compliance with International Standards and in the Anticorruption Area*), 10 qershor 2013
32. SIDA Strategy for Development Cooperation ëith Kosovo 2009-2012
33. Strategjia e BE-së për zgjerim dhe sfidat kryesore 2012-2013
34. Strategjia për kontrollimin dhe mbledhjen e armëve të vogla dhe të lehta 2013 – 2017
35. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2012- 2017
36. Strategjia Kombëtare Kundër Drogave 2012-2017
37. Strategjia Kombëtare kundër Falsifikimeve 2012-2017
38. Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014
39. Strategjia Kombëtare për Migracionin 2012-2017
40. Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit, dhe Krimeve Financiare 2014-2018
41. Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Krimit dhe Plani i Veprimit 2013 – 2017
42. Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra 2013- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
43. Strategjia Kundër Narkotikëve 2012- 2017
44. Strategjia Kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2012- 2017
45. Strategjia Nacionale dhe Planit të Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014
46. Strategjia për Integrim Evropian –Kosova 2020
47. Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2013-2018
48. Swis Cooperaton Strategy for Kosovo 2013-2016
49. The Global Fund Strategy 2012-2016 –Investing for Impact
50. USAID Country Development Cooperation Strategy for Kosovo 2014-2018
51. World Bank Country Partnership Strategy for Kosovo 2012-2015

## 16.5 WEBFAQET E KONSULTUARA

1. Webfaqja e Agjencisë Kadastrale të Kosovës: <http://www.kca-ks.org>
2. Webfaqja e Agjencisë Kundër Korrupsionit: <http://www.akk-ks.org>
3. Webfaqja e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas: <http://www.knj-rks.org/index.php?lang=sq>
4. Webfaqja e Agjencisë së Privatizimit të Kosovës: <http://www.pak-ks.org>
5. Webfaqja e Agjencisë së Pronave të Kosovës: <http://www.kpaonline.org>
6. Webfaqja e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë: <http://www.auv-ks.net>
7. Webfaqja e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës: <http://oag-rks.org>
8. Webfaqja e Bankës Botërore në Kosovë:  
<http://www.worldbank.org/en/country/kosovo>
9. Webfaqja e Bankës Botërore për të Bërit Biznes: <http://www.doingbusiness.org>
10. Webfaqja e Departmentit të Drejtësisë të SHBA-së: <http://www.justice.gov>
11. Webfaqja e Doganave të Kosovës: <http://dogana.rks-gov.net>
12. Webfaqja e Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerim të Komisionit Evropian:  
[http://ec.europa.eu/enlargement/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/index_en.htm)
13. Webfaqja e EULEX-it: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/front/>
14. Webfaqja e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS): <http://kfos.org>
15. Webfaqja e Fondit Monetar Ndërkombëtar: <http://www.transparency.org/country>
16. Webfaqja e GIZ-it në Kosovë: <http://www.giz.de/en/ëorldëide/298.html>
17. Webfaqja e Global Integrity Report: <https://www.globalintegrity.org/global/report-2011>
18. Webfaqja e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS):  
<http://legalpoliticalstudies.org>
19. Webfaqja e Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit në Kuadër të Këshillit të Evropës: [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/default\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/default_en.asp)
20. Webfaqja e ICITAP-it: <http://www.justice.gov/criminal/icitap>
21. Webfaqja e Inspektoratit Policor të Kosovës: <http://ipk.rks-gov.net>
22. Webfaqja e Institutit Gjyqësor të Kosovës: <http://igjk.rks-gov.net>
23. Webfaqja e Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED):  
<http://www.kipred.org>
24. Webfaqja e Institutit të Bankës Botërore: <http://wbi.worldbank.org/wbi>
25. Webfaqja e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD): <http://www.kli-ks.org>
26. Webfaqja e Jeta në Kosovë: <http://www.jetanekosove.com>
27. Webfaqja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës: <http://www.kgjk-ks.org>
28. Webfaqja e Këshillit Prokurorial të Kosovës: <http://www.kpk-rks.org>
29. Webfaqja e KFOR-it: <http://www.aco.nato.int/kfor.aspx>
30. Webfaqja e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë:  
<http://www.unhcr.org/412b5f904.html>

31. Webfaqja e Komisionit Evropian për Eficiencën në Drejtësi në Kuadër të Këshillit të Evropës: [http://www.coe.int/T/dghl/cooperation/cepej/default\\_en.asp](http://www.coe.int/T/dghl/cooperation/cepej/default_en.asp)
32. Webfaqja e Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë: <http://www.drejtesia.gov.al>
33. Webfaqja e Ministrisë së Drejtësisë: <http://www.md-ks.org>
34. Webfaqja e Ministrisë së Integritimit Evropian të Shqipërisë: <http://integrimi.gov.al>
35. Webfaqja e Ministrisë së Integritimit Evropian: <http://www.mei-ks.net>
36. Webfaqja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor: <http://mmp-hks.org>
37. Webfaqja e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë: <http://www.moi.gov.al>
38. Webfaqja e Ministrisë së Punëve të Brendshme: <http://www.mpb-ks.org>
39. Webfaqja e Odës së Avokatëve të Kosovës: <http://www.oak-ks.org>
40. Webfaqja e Odës së Noterëve të Kosovës: <http://noteria-ks.org/per-ne>
41. Webfaqja e Organit Shqyrtues të Prokurimit : <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,84>
42. Webfaqja e Organizatës Qohu: <http://www.cohu.org>
43. Webfaqja e OSBE-së: <http://www.osce.org/kosovo>
44. Webfaqja e Platformës së CIVIKOS-it: <http://www.civikos.net>
45. Webfaqja e Policisë së Kosovës: <http://www.kosovopolice.com>
46. Webfaqja e Prokurorit të Shtetit: <http://psh-ks.net>
47. Webfaqja e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS): <http://www.qkss.org/en-us/Home>
48. Webfaqja e Qeverisë Shqiptare: <http://www.kryeministria.al>
49. Webfaqja e Swiss Development Cooperation në Kosovë: <http://www.swiss-cooperation.admin.ch/kosovo>
50. Webfaqja e Transparency International: <http://www.transparency.org/country>
51. Webfaqja e Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit në Kosovë: <http://www.kosovo-arbitration.com>
52. Webfaqja e UNDP-së në Kosovë: <http://www.ks.undp.org/kosovo/en/home.html>
53. Webfaqja e UNICEF-it në Kosovë: <http://www.unicef.org/kosovoprogramme>
54. Webfaqja e UNICEF-it: <http://www.unicef.org/kosovoprogramme>
55. Webfaqja e UNOPS-it: <http://www.unops.org/english/whatwedo/Locations/Europe/Pages/PristinaOperationsCentre%28PROC%29.aspx>
56. Webfaqja e USAID-it në Kosovë: <http://www.usaid.gov/ehere-ee-eork/europe-and-eurasia/kosovo>
57. Webfaqja e Zyrës së BE-së në Kosovë: [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/index\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/index_en.htm)
58. Webfaqja e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës: <http://www.kryeministri-ks.net>
59. Webfaqja: <http://worldjusticeproject.org>
60. Webfaqja e Ministrisë së Punëve të Jashtme: <http://www.mfa-ks.net>
61. Webfaqja e Akademisë e Kosovës për Siguri Publike: <http://aksp.rks-gov.net>